

ere HËNA

www.bim.org.mk
www.henaere.bim.org.mk

Revistë kulturore informative islame



**Veprat që pretendojnë
të kenë influencë
për ndryshime globale**
Faqe 2



**Thirrja “Eja në
shpëtim” po frustron
evropianët** Faqe 15



**Problemi I të
ashtuqajturve të
pandryshuara (konstante)
dhe të ndryshuara
(jokonstante) në Islam**
Faqe 41



VEPRAT QË PRETENDOJNË TË KENË INFLUENCË PËR NDRYSHIME GLOBALE

“Edhe pse është shpallur para shumë shekuj ndikimi i tij akoma është i fuqishëm dhe veprues, nga i cili libër udhëheqës politikë dhe fetarë huazojnë shumë gjër, gjë e cila është dëshmuar pas gjithë asaj që bëri shoqëria Islame duke vepruar në bazë të këtij libri të shquar.”

Abaz Islami

Periudhën që po jetojmë nga dita në ditë aq sa janë shoqëritë optimiste për ndryshime pozitive globale po aq janë edhe pesimiste. Shpesh herë po paraqiten figura ku shoqëritë po bëjnë përpjekje përmes dhënies së legjitimitetit të gjejnë individ me kredibilitet që besimin i dhënë atyre të jetë pikënisje për një botë më të qetë, sigurtë dhe stabile. Në tërësi popujt janë duke shijuar kriza të natyrave të ndryshme si sociale, ekonomike, fetare, mjeksore, kulturore dhe morale. Ky pesimizëm po shtohet gjithnjë e më shumë tek shoqëritë kur po i shohin pamundësitë për një jetë më ndryshe që po u ofrojnë tani liderët. Pas gjithë këtyre përpjekjeve në mesin e atyre që po kontribuojnë rreth këtyre ndryshimeve janë edhe figurat tjera nga jeta politike dhe publike të cilët nëpërmjet formave të ndryshme duan të ofrojnë mundësi të reja rreth zhvillimit në aspektin pozitiv.

VEPRA: “SEKRETI MË I MADH”- AUTOR DAVID ICKE

Në fund të shekullit të kaluar dhe në fillim të mijëvjeçarit të ri para auditoriumit u prezentuan botime të shumtë që pretendojnë të kenë influencë për ndryshime globale. Në mesin e tyre janë veprat si: “Diplomacia” e Henry Kissinger, “Përplasja e Qytetërimeve” nga Samuel Hantigton, “Fundit i Historisë dhe njeriu i fundit” nga Fransis Fukujama, etj. Si duket të gjithë këta dështuan pasi që nuk arritën në realitet të jetësojnë pretendimet e tyre. Pas perëndimit të tyre, shpresën e ringjalli një tjetër autorë i cili nxjerri në pah një botim me pretendencë se do të ketë influencë për të ndryshuar çështjet shoqërore në mbarë universin, ai është David ICKE, një intelektual i shquar dhe i njohur në botën

bashkëkohore. Me librin e tij: “Sekreti më i madh”, mjaft lexues dhe analist e përshkruajn se ky do të jetë libri që do të bëjë ndryshime rrënjësore në shekullin që jemi duke jetuar. Mjaft ideologë, filozofë, intelektualë botëror e llogarisin humultim e D. Icke të stërm bushur me ndodhi, ngjarje dhe fakte të rralla. Vepra e tij sipas tyre është kapital i papërshkruar për botën aktuale moderne. Pas gjith ndodhive në shekullin që lamë pas dhe asaj që aktualisht po shfaqet na bënë të ditur se bota ende është duke shkuar shtigjeve të disfatës dhe zhdukjes, ngase lufta me vetveten për interese individuale është edhe një fakt se nuk kemi menaxhues racional dhe të drejt.

Duhet të jetë e qartë se gjithnjë kanë ekzistuar manipulime mbi shoqëritë në të gjitha dimensionet duke filluar nga luftërat, politika, biznesi, historia e popujve të vegjël, feja, etj. Manipulime kanë ekzistuar dhe do të ketë me shoqëritë e varfëra dhe të klasës së tretë, të pazhvilluara, paarsimiuara, të natyrës rreth një botë që tani po artificializohet dhe po e humb natyrshmërinë e saj që i ka dhënë Zoti. Botimet e tilla janë ngajshëm sikur sistemet politike, me çka njëra është e dobishme për një periudhë, ndërsa tjetra për një periudhë krejtësisht tjetër, të parën e favorizojn një gjeneratë e llojit njerëzor ndërsa tjetrën një gjeneratë tjetër. Për njerëz thërret një grup i fuqishëm që të respektohet, ndërsa të njejtën e urrejnë ata që janë të dobët dhe jasht pushtetit. Sigurisht se pakënaqësitë janë reale kur shprehen nga individë, grupe dhe shoqëri në përgjithësi, ngase gjithçka kontrollon nga forcat vendosëse dhe të njejtat definojnë pikërisht nga forca. Të gjitha komplotet shoqërore dhe manipulimet grupe, racore janë skenare të përgatitura nga ata që duan të udhëheqin me popujt, këtë e mësojmë nga motoja masonike “Ordo ab chao”- rregulli nga kaosi,

të prezentuar në veprën e David Icke. Me këtë rast krijohet kaos në shoqëri që është mënyrë më e lehtë që të arrihet deri tek kontrollimi i shoqërisë dhe popujve në aspektet globale. Përmes këtyre krijimeve të kaoseve të skenuara nga pretendues për udhëheqje, të njejtët pastaj tregojnë rrugën për rivendosjen e rregullave që d.t.th. se këta krijojnë probleme, pastaj ofrojnë mundësi për zgjidhjen e tyre dhe në fund krejtë këtë e realizojnë që të rivendosin rregulla. Klane të tilla gjithnjë bëjnë plane si dhe në çfarë mënyre të sundojnë mendjet e njerëzve gjegjësisht si të dhunojnë që pastaj të jenë të kërkuar dhe të mvarrur nga klasat e dobëta! Me të arritur këta vendosin rregull përmes së cilave do të kenë pushtetin dhe kontrollin mbi klasat shoqërore. Pas gjithë këtyre ndodhive dhe ngjarjeve të padëshiruara ftojnë për ndryshime globale përmes përcjelljes së mesazheve dhe motove të ndryshme të përgatitura përmes ideologëve dhe mendimtarëve të mëdhej. Të tillët në bashkëpunim me shtëpit shtypëse përmes punës së tyre dhe gazetarëve duke trilluar ngjarje të ndryshme dhe ndodhi ata frustronjë mendjet e qytetarëve që më lehtë të kontrollojnë në tërësi. Sado që të veprojnë autorë të ndryshëm të shtypin tituj të tillë për të ndryshuar botën dhe më gjërë, ato janë të cekët ngase gjithnjë janë angazhuar shumë individ që të shkruajn dhe përmes veprave të tyre të ofrojnë mundësi dhe opione të reja ideologjike për një botë pozitive dhe me kushte të reja për zhvillim.

KUR'ANI, LIBRI I CILI BËNI RIKTHESA DHE NDRYSHIME UNIVERSALE

Pas gjithë asja që po shpalos bota e ngritur, zhvilluar, edukuar dhe industrializuar përmes botimeve nga autorë të ndryshëm për ndryshime shoqërore dhe për

një botë të drejtë ka dështuar. Jemi dëshmitarë të asaj deri më tani, ngase asnjë botim i tillë nuk ka pasur aq shumë influencë të fuqishme që në të vërtetë të bënë ndryshime të duhura. Jo vetëm bota islame por e gjithë universi para tyre kanë Kur'anin, libër që është shpallur Muhamedit a.s para katërbëdhjetë shekuj për mbarë shoqëritë pa dallim, racën, gjuhën, etnitetit dhe kulturën. Mbi këtë libër kanë folur mjaftë sociologë, mendimtarë, filozofë, lider politikë dhe fetarë, se me të vërtetë ka pasur ndikim të madhë në ndryshimin e çështjeve shoqërore. Nuk është sikur librat tjerë që pretendojnë vetëm në aspektin politik të bëjnë ndryshime por pikat që i prek Kurani rreth shoqërisë janë të përkryera që tani edhe shtete më të zhvilluara veprojnë me këtë libër. Kemi raste ku gjykata të larta të shteteve të fuqishme sjellin konkluzat dhe vendime mbi raste të ndryshme shoqërore në bazë të normave dhe hukmeve (dispozitave) që burojnë nga Kurani. Në bazë të këtij libri janë ngritur edhe koncepte të shumtë shoqërore mbi të drejtat dhe liritë e njeriut, barazinë gjinore, të drejtat e gruas, statusin e individëve të klasëve të ulta, koncepte mbi kombin, shtetin, politikën, kulturën, sistemet politike dhe juridike, mbi dukuritë negative dhe pozitive shoqërore, tolerancën, dialogun, civilizimin etj.

Edhe pse është shpallur para shumë shekuj ndikimi i tij akoma është i fuqishëm dhe veprues, nga i cili libër udhëheqës politikë dhe fetarë huazojnë shumë gjëra, gjë e cila është dëshmuar pas gjithë asaj që bëri shoqëria Islame duke vepruar në bazë të këtij libri të shquar. Ndikimi i këtij libri është hetuar ndërsheku dhe ndër gjenerata i cili pati ndikim në të gjitha kohërat. Sigurisht se ky nuk është i njejtë në bazë të natyrës me librat tjerë, kjo është fjalë hyjnore e Allahut, Krijuesit, ndërsa librat e njerëzve janë botime të krijësave të Tij.



PËRVJETORI I ZILËS SË PARË

Para njëzetë e pesë vjetësh, përkatësisht më 15 tetor të viti 1984, në vitin shkollor 1984/1985, ra zilja e parë në Shkollën e Mesme Islame “Medreseja Isa Beu” në Shkup.

Kjo zile dallon nga zilet e shkollave tjera, sepse ajo nuk ishte, thjeshtë vetëm një zile që thërriste nxënësit për të filluar orën e mësimit, por zëri i saj lajmëroi një ngjarje shumë të rëndësishme në historinë e myslimanëve të këtij nënqielli. E kjo është fillimi, respektivisht rifillimi i procesit mësimor të Medresesë Isa Beu, e cila u themelua në shekullin pesëmbëdhjetë dhe e cila ka pasur disa ndërprerje në punën e saj.

Zilja e parë shënoi fundin e orës së errësirës që zgjati rreth katër dekada si rezultat i ndërprerjes së punës së kësaj Medreseje nga pushtetmbajtësit komunistë.

Zëri i kësaj zile i ngjasonte zërit të sirenës e cila bie në përfundimin e suksesshëm të një pune apo projekti të madh. Pra, kjo zile ishte zilja e punës së kryer me sukses nga ana e organeve të Bashkësisë Islame, të cilat pas shumë peripecive të burokracisë dhe politikës së ish-sistemit, e bënë të mundur të pamundshmen duke kompletuar dokumentacionin e duhur dhe duke e ndër-tuar godinën bashkëkohore të kësaj vatre të dijes islame.

Me siguri sepër këtë më meritor janë besimtarët e këtij nënqielli të cilët nuk kursyen asgjë për të ndihmuar ndërtimin e Medresesë dhe për ta mirëmbajtur atë që nga fillimi i saj.

Andaj, zilja e parë e Medresesë Isa Beu kënaqi veshin e çdo një xhemati duke u pëshpëritur se frytin e mundit tuaj së shpejti do ta shijoni. Dhe, kështu ndodhi. Medreseja hapi dyert e saja në kohën kur arsimimi shqip tek ne merrej nëpër këmbë.

Përmes bankave të saja, ajo arriti të kualifikojë një numër të madh kuadrosh fetarë, të cilët me sukses janë kyçur në detyra të ndryshme duke dhënë kontribut në zhvillimin e jetës fetaro-islame në vend dhe më gjerë në rajon, sepse jehona e kësaj zileje u dëgjua përtej kufijve të vendit, duke pranuar në gjirin e saj nxënës gjithandej rajonit.

Sot, kjo zile bie e akorduar me zilet e degëve të shtrira të kësaj Medreseje. Këto degë të shtrira edhe më shumë atë e mishërojnë me besimtarët të cilët krenohen me Medresenë e tyre.

Pra, kjo zile ra për të shënuar fundin e orës së errësirës dhe në të njëjtën kohë shënon fillimin e orës së mësimit dhe arsimit islam në këto troje, orë e cila nuk përfundon derisa të jetë jeta.



REVISTË MUJORE
INFORMATIVE
KULTURORE ISLAME



Botues:
Rijaseti i BFI në RM



Redaksia:
Abaz Islami
Abaz Jahja
Skender Buzaku
Ibrahim Idrizi
Qufli Osmani
Shaban Sulejmani
Ismet Osmani
Driton Dikena
Agron Vojnika



Bashkëpunëtor:
Agim Mehmeti
Valbona Zunçe
Rejhan Neziri



Redaktori teknik:
Halil Berisha



Telefonat e redaksisë:
02 3117 410; 02 3117 412



www.bim.org.mk
e-mail: bim@bim.org.mk
www.henaere.bim.org.mk
e-mail: hena@bim.org.mk



Dorëshkrimet dhe fotografitë
nuk kthehen



17

ENSARËT,
SHOQËRIA QË
NDIHMUI
MBIJETESËN E
FESË ISLAME

ZVICRA -
KJO ÇOKOLLATË
E HIDHUR!



23



MODELI I
KULTIVIMIT TË
VLERAVE FETARO
ISLAME

31



MBULESA (HIXHABI) VESHJE E ARDHMËRISË

34

“ANONIMËT” E BE-SË DHE FRIKA E TURQISË



37



SI T'I DALLOJMË NARKOMANËT?

49

TË FRYMËZOHEMI
NGA POROSITË E
MUAHMEDIT A.S ... 6

TAKVIMI 2010 /
1431-1432 H. ... 8

INAUGURIM XHAMIE NË
STRIMNICË TË TETOVËS ... 9

25 VJET NGA RIPËRTRIRJA E
TRADITËS SHEKULLORE ... 10

"DORA QË PËRKUND DJEPIN
ARSIMON DHE KOMBIN" ... 12
MYFTIU I KOSOVËS, NAIM EF.
TËRNAVA ... 13

ALI EF. HALLAÇI, MYFTI I
KUKËSIT- SHQIPËRI ... 14

REFERENDUMI U PËRKRAH
NGA SHUMICA E VOTUESVE,
E JO NGA SHUMICA E
POPULLATËS ... 19

MOS E SHANI KOHËN ... 25

KEQINTERPRETIMI I
HADITHIT SHKAK I
PËRÇARJES SË MUSLIMANËVE
(2) ... 28

EDUKIMI MORAL I
GJENERATAVE TË REJA
DOMOSDOSHMËRI ... 36

FORMAT E MUZIKËS
FETARE (3) ... 39

PARA NJË PUNE TË
RËNDË (ZEJD IBN THABIT,
AS'HAB) ... 45

NJERËZORJA E JEZUS
KRISHTIT (ISAUT A.S.) ... 47

Të frymëzohemi nga porositë e Muahmedit a.s

Driton Dikena

“Veprimi i Muhamedit a.s. gjatë hixhretit në Medine, ashtu siç ishte frymëzim gjatë historisë, mund të shërbejë edhe në jetën tonë aktuale si motivacion për t'i tejkaluar vështirësitë me të cilat po ndeshemi, udhërrëfyes për njeriun e sotëm që ka filluar ta humb veten pas gjërave të kësaj bote”. Ishte ky mesazhi që doli nga Akademia solemne më rastin e Vitit të Ri islam – Hixhri 1431, si dhe me rastin e njëzet e pesë vjetorit të ripërtëritjes së Medresesë “Isa Beu”, që u mbajt në Shkup në organizim të Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë.

Personalitete të jetës fetare dhe publike, ambasadorë të përfaqësive diplomatike në Shkup, përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe pushtetit lokal, anëtarë të ekzekutivit të shtetit, ishin një pjesë e mysafirëve që i dhanë sharmin këtij manifestimi, i cili është shndërruar në një manifestim tradicional, ku bashkërisht po përkujtohet emigrimi i Profetit të Islamit, Muhamedit a.s., ngjarje kjo, që paraqet një rën nga datat më të dalluara në kalendarin islamik dhe, njëkohësisht shënon fillimin e vitit të ri Hixhri.

Organizatorin e këtij manifestimi Kryetarin e Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë Reis ul Ulema Haxhi Sulejman Efendi Rexhepi, me ardhjen e tyre e kishin respektuar edhe dy homologët e tij shqiptar nga dy shtetet shqiptare, kryetari i Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës, Myftiu Naim Efendi Tërnavë dhe përfaqësuesi i kryetarit të Komunitetit Mysliman të Republikës së Shqipërisë, Myftiu Ali Hallaçi.

Akademia solemne me rastin e Vitit të Ri Hixhri 1431, nuk u mor vetëm si një natë kur akrepat e orës tregojnë ndërrimin e moteve! Por,



“

Viti i ri Islam- Hixhri 1431 dhe njëzet e pesë vjetori i ripërtëritjes së Medresesë “Isa Beu” në Shkup, ishin dy arsye për të cilat Bashkësia fetare Islame e Maqedonisë organizoi të enjten në Shkup, Akademi Solemne.

komuniteti mysliman këtu në Maqedoni, në po këtë Akademi shënoi edhe njëzet e pesë vjetorin e ripërtëritjes së Medresesë “Isa Beu” në Shkup.

Gjatë urimit të tij për Vitin e Ri Islam- Hixhri 1431, kryetari i Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës, Myftiu Naim Efendi Tërnavë, tha se rruga drejt pavarësisë së Republikës së Kosovës i ngjan shumë rrugës së hixhretit të profetit të fundit në Islam Muhamedit a.s.

“ Dhe derisa Muhamedi a.s. për 10 vjet me radhë ishte i shtypur dhe i diskriminuar nga populli jobesimtarë, të njëjtën gjë e përjetoi edhe populli i Kosovës, ku dekada me radhë ishte i shtypur. Dhe derisa emigrimi i Muhamedit a.s., ndriçoi mendjen e njerëzve të asaj kohe dhe mundësoi që Islami të përhapet me tërë fuqinë e vetë, po ashtu edhe lufta jone për liri ndriçoi mendjet e komunitetit ndërkombëtarë dhe lejoi që Kosova të shkojë drejt pavarësisë së saj, që ne sot me

plot të drejtë të themi se jemi shteti më i ri në botë, dhe të quhemi Republika e Kosovës”, theksoi Tërnavë.

Ai më pas shtoi se Zoti na ka lënë këtu dhe ne këtu do të mbesim deri në ditën e kiametit, që të madhërojmë Zotin dhe të dërguarin e tij Muhamed Mustafanë.

Edhe Myfti, Ali Hallaçi përsëriti të pranishmit në emër të komunitetit mysliman të Republikës së Shqipërisë dhe uroi që Zoti të bekoj shqiptarët kudo që janë.

Me rastin e Vitit të Ri Islam-Hixhri 1431, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë, Reis ul Ulema, Haxhi Sulejman Efendi Rexhepi tha se Hixhreti, pra shpërngulja e Muhamedit a.s. nga Meka në Medine paraqet ndarjen e të vërtetës nga e pavërteta, të drejtën nga padrejtësia dhe dritën nga errësira.

VENDOSMËRIA DHE ARSIMIMI JANË VLERAT E NJËMENDTA TË NJË SHOQËRIE.

“Hixhreti dhe qëndrimi i Muhamedit a.s. në Medine paraqet momentin, kur porosia fetare e gjeti mishërimin e vetë të parë, kur Pejgamberi praktikisht e dëshmoi madhësinë e të Dërguarit të Zotit që e bartë Shpalljen dhe autoritetin e udhëheqësit, i cili zgjidhte konflikte dhe udhëhiqte bashkësinë e besimtarëve. Me rastin e hixhretit në Medine, u formua bashkësia e parë administrativo-politike e myslimanëve, ku vlen të theksohet se për një periudhë të shkurtër u ngrit vetëdija kolektive, Medina la pas vete

përçarjen, dhe u bë shembulli më i mirë i vendosjes dhe praktikimit të ligjit të Allahut. Allahu xh.sh. në Kur’anin Famëlartë thotë: ”Ata që besuan, migruan dhe luftuan me pasurinë dhe me veten e tyre në rrugën e Allahut, ata kanë pozitën më të lartë te Allahu dhe vetëm ata janë fatlum”, pra për këto shkaqe Viti i Ri Hixhri, përherë do të ketë vlerë shumë më të madhe sesa ndërrimi simbolik i moteve. Fillim viti sipas kalendarit hixhri do të jetë përkujtim për të gjitha gjeneratat, se besimi i sinqertë dhe mbështetja te Krijuesi, flijimi, guximi, urtia, uniteti, vendosmëria dhe arsimimi janë vlerat e njëmendta të një shoqërie”, theksoi Reis ul Ulema Haxhi Sulejman Efendi Rexhepi.

Sipas tij, veprimi i Muhamedit a.s. gjatë hixhretit në Medine, ashtu siç ishte frymëzim gjatë historisë, mund të shërbejë edhe në jetën tonë aktuale si motivacion për të tejkaluar vështirësitë me cilat po ndeshemi, udhërrëfyes për njeriun e sotëm që ka filluar të humb veten pas gjërave të kësaj bote. “Besimtari i devotshëm është i obliguar të ndjek traditën e Muhamedit a.s, të frymëzohet nga porosinë që ai ia ka lënë në trashëgim mbarë njerëzimit, me të cilat mësohet se Islami është fe e mirëkuptimit dhe dialogut pa marrë parasysh dallimet për nga feja, kombi, raca dhe kultura”, tha Haxhi Sulejman Efendi Rexhepi.

PESË SHEKUJ MEDRESE

Me këtë rast, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë uroi të pranishmit



edhe për njëzet e pesë vjetorin e ripërtëritjes së Medresesë Isa Beu në Shkup.


“Duke u nisur nga këto baza, ne për 25 vjet me radhë arritëm që në këtë frymë, në Medresenë Isa Beu në Shkup të shkollojmë gjenerata të reja intelektualësh dhe imamësh. Prandaj, falë besimit të palëkundur në Allahun Fuqplotë dhe sakrificave e angazhimeve të brezave tanë, ne po krijojmë hapësirë dhe mundësi që kjo dituri të përçohet nga brezi në brez dhe sot, krenohemi që kemi mbi 1300 studentë të diplomuar dhe mbi 600 të tjerë që shkojnë kësaj rruge. Me këto që ne kemi arritur, kemi të drejtë të besojmë dhe shpresojmë se në dyert tona po troket një vit tjetër islam i madh dhe i bardhë; vit me më shumë shpresë, mirëkuptim, dashuri, punësim dhe begati”, theksoi Haxhi Sulejman Efendi Rexhepi.

Duke dhënë urimin me rastin e Vitit të Ri Islam- Hixhri 1431, lideri i institucionit më të lartë fetar në vend, tha që viti që vjen le të jetë vit plot gëzime, shëndet, mbarësi dhe suksese për ju, familjet tuaja, dhe për të gjithë atë që ua do zemra.

Me rastin e 25 vjetorit të ripërtëritjes së Medresesë “Isa Beu” në

Shkup, Agron Vojnika kishte përgatitur një dokumentarë “5 shekuj medrese”, nga i cili, shumë lehtë kuptohej roli i rëndësishëm i këtij institucioni fetar gjatë shekujve për emancipimin e gjeneratave ndër shekuj.

“Medreseja Isa Beu” vazhdon traditën e medresesë se dikurshme me të njëjtin emër, e themeluar në shekullin XV nga Isa Beu, një ndër mbrojtësit më të njohur të Shkupit. Kjo Medrese, në të kaluarën ka prezantuar institucionin më të lartë arsimor dhe njëhej si shkollë më me famë në Rumeli. Ndërsa pas ndërprerjes së kohëpaskohshme të punës së saj nga faktori luftë në Ballkan, Bashkësia Islame solli vendimin për fillimin e vitit të ri shkollor më 1984. Prej atëherë, e deri më sot BFI krenohet me numrin prej 1300 të diplomuarve, duke përfshirë një gjeografi të gjerë myslimane në Ballkan. “Dora që përkund djepin, arsimon dhe kombin” ishte porosia që dha Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë, Reis ul Ulema Haxhi Sulejman Efendi Rexhepi gjatë shfaqjes së filmit dokumentar “5 shekuj medrese” të përgatitur nga Agron Vojnika.



TAKVIMI

2010 /

1431-1432 H.

Në botim të Bashkësisë Fetare Islame - Shoqata “ILMIJE” këto ditë nga shtypi doli Takvimi për vitin 2010, respektivisht për vitin Hixhri 1431-1432. Përmbajtja e Takvimit është e ndarë në dy pjesë. Pjesa Kalendarike që vjenë pas parathënies, e përgatitur nga Sekretari i Shoqatës “Ilmije”, Rexhep Ziberi. Si zakonisht në pjesën kalendarike jepen të dhëna për festat fetare dhe shoqërore si dhe të dhënat për kohët e namazëve gjatë tërë vitit 2010.

Pjesa e dytë e cila që fillon nga faqja 35, përfshihen tema të ndryshme duke filluar me Kumtesë e Reisul Ulemasë të BFI-së, H. Sulejman ef. Rexhepi, lexuar në Konferencën Botërore islame për dialog në Mekë, me titull “Dialogu në mes muslimanëve dhe jomuslimanëve”. Në vijim vjen punimi “Islami Ruajt identitetin tonë kombëtar” nga Rexhep Ziberi; “Një Evropë që po ndryshon” nga Abaz Islami; “Odgvoorot na Muhamed alejhiselam”, përkthyer nga Afrim Tairi; “Allah için sevmek” nga prof. Dr. M. Jashar Kandemir; “Modernleşme ve Sila-i Rahim” nga Nizam Resit dhe “Falja e namazeve ditore në praktikë” nga Qufli Osmani.

Bazuar në të folmen e besimtarëve të vendit tonë, Takvimi botohet në tri gjuhë, shqip, turqisht dhe maqedonisht në mënyrë paralele. Që takvimi të jetë më i përpiktë dhe më me pak lëshime, për përgatitjen e tij u kujdesën Afrim Tairi, Rexhep Ziberi dhe Abaz Jahja.

Q. Osmani

Inaugurim xhamie në Strimnicë të Tetovës

Më 27 Dhjetor 2009 në fshatin Strimnicë të Tetovës u bë inaugurim i xhamisë, gurthemeli i së cilës u hodh më 03 Janar 2009. Në këtë solemnitet morri pjesë përfaqësuesi i Reis ul Ulemasë, H. Sulejman ef. Rexhepi, Sekretari i përgjithshëm i BFI, H. Afrim ef. Tahiri. Në mesin e të pranishmëve pjesëmarrës ishin Myftiu i Myftinisë së Tetovës, h. Alifikri ef. Esati, referentët e Myftinisë në fjalë dhe qytetarë të shumtë. Fillimisht fjalë përshëndetëse kishte këshilli iniciativ për ndërtimin e xhamisë, pastaj të pranishmëve iu drejtua imami i xhamisë dhe Myftiu i Tetovës, H. Alifikri ef. Esati.

Myftiu i Tetovës lavdëroi qytetarët për këtë kontribut të dhënë për përfundimin e kësaj xhamie dhe lëshimin e shpejt të saj në përdorim, mes tjerash apeloj që edhe më tej të kontribuojnë në ruajtjen dhe mbrojtjen e vlerave fetare Islame.

Me rastin e inaugurimit të kësaj xhamie fjalë rasti mbajti Sekretari i përgjithshëm i BFI, H. Afrim ef. Tahiri i cili para të pranishmëve shpalosi një ajet Kur'anor ku Allahu Fuqiplotë thotë: "E drejtë e përkujdesjes së xhamive të All-llahut është vetëm e atij që i ka besuar All-llahut dhe ditës së mbramë e që



Pamje nga gurthemeli i xhamisë (03 Janar 2009)

e falë namazin, jep zeqatin e nuk i frikësohet askujt pos All-llahut. Të tillët do të jenë të udhëzuarit (në rrugën e drejtë)." (Teube: 18). Përmes kësaj fjale Hyjnore të All-llahut xh.sh, Sekretari i përgjithshëm shpalosi urtësitë që burojnë se: "Besimtarët që kanë besim të shëndosh dhe të fuqishëm në All-llahun xh.sh, në fjalën e Tij, në botën tjetër, dhe se në vazhdimësi respektojnë çdo parim dhe normë fetare

Islame janë ata që përkujdesen gjithmonë për ngritjen e shtëpive të All-llahut. Këta janë figurat dhe personalitetet më të lavdëruar dhe më të ngritur në mesin tonë, ndërsa përjetësisht të gjallë në kujtesat e njerëzve. Ai shtoi se: "Në vitin 2009 përkundër shumë vështirësive për BFI ka qenë një vit me shumë të arritura në sfera të ndryshme, janë hedhur dhjetëra gurthemele të xhamive dhe të njejtat janë lëshuar në

përdorim. Është investuar në institucionet edukativo-arsimore siç është Medreseja Isa-Beu. Viti 2009 BFI e filloi pikërisht këtu tek ju me rastin e gurthemelit të kësaj xhamie dhe po e përmbyll këtu me rastin e inaugurimit të xhamisë. Më lejoni që para jush të shpreh edhe porosinë e Reis ul Ulema që publikisht të falënderoj Myftiun e juaj për sukseset e arritura gjatë këtij viti. Sukseset më të mëdha të BFI gjatë vitit që po lëmë kanë qenë pikërisht në Myftininë e Tetovës, me çrast para disa muajve u lëshua në përdorim godina e re e paraleles së vajzave të Medresesë Isa-Beu."

"Të mendohet për ndërtimin e xhamive është sepas, të ndihmohet në ndërtimin e tyre është sepas, të marrësh pjesë në ngritjen e tyre është sepas, të vizitosh xhami është sepas, të nisësh për në xhami është sepas, të qendrosh brenda saj është sepas, të përkujtosh All-llahun, të adhurosh Atë gjithashtu është sepas, por edhe të dalësh nga ajo për të shkruar e kërkuar rizkun gjithashtu është sepas."- theksoi Sekretari i përgjithshëm i BFI-së. Në fund duanë e këtij inaugurimi të xhamisë së re e bëri kryeimami i Myftinisë së Tetovës, Ejup ef. Selmani



Pamje nga inaugurimi i xhamisë (27 Dhjetor 2009)



Pamje nga brendia e xhamisë me rastin e inaugurimit të saj (27 Dhjetor 2009)

25 VJET NGA RIPËRTRIRJA E TRADITËS SHEKULLLORE

“Duke u nisur nga këto baza ne për 25 vite me radhë në Medresenë Isa Beu në Shkup arritëm që në këtë frymë të shkollojmë gjenerata të reja intelektualësh dhe imamësh. Prandaj falë besimit të palëkundur në Allahun Fuqiptotë dhe sakrificave e angazhimeve të brezave tanë, ne po krijojmë hapësirë dhe mundësi që kjo dituri të përçohet nga brezi në brez dhe sot krenohemi që kemi mbi 1300 studentë të diplomuar dhe mbi 600 të tjerë që shkojnë asaj rruge.” Haxhi Sulejman ef. Rexhepi

Festa e vitit të ri Hixhrij 1431, nuk ishte si vitet tjera, dallonte nga të gjithë vitet e më parshme pasi ne sivjet nuk festonim vetëm festën e vitit të rij Hixhrij me gjithë multidimensionalitetin e saj, por tani ne festonim edhe diçka shumë të madhe, shënonim 25 vjetorin e rilindjes së Medresesë Isa Beu, kësaj vatre shekullore të arsimit.

Të mërkurën, në mbrëmjen e 16 dhjetorit, besimtarët e këtij nënqielli u mbledhën të gjithë në thirrje të Bashkësisë Fetare Islame, në hapësirat e hotelit “Alexander Palace”, ku u mbajt akademia solemne për shënimin e kësaj date historike.

Akademia në fjalë siç cekëm edhe më lartë krahas shënimit tradicional të vitit të ri të Hixhretit, që është shumë më shumë se vetëm festë e ndërrimit të moteve, shënonte 25 vjetorin e ripërtrirjes së Medresesë Isa Beu, këtij tempulli të shenjtë të ditorisë, me çka dëshmohet se ky brez së paku si gjeneratë është përpjekur që Islamin ta ngris,

ta ruaj dhe të kultivojë vlerat e tij në formë të rrugës institucionale, të kapshme për të gjithë dhe të pranishme në mënyrën më të mirë për njerëzit.

Historikisht janë të njohura të gjitha peripecitë, pengesat dhe të arriturat e fesë Islame në trojet e Ballkanit. Historia është dëshmitare e gjithë asaj shtypje që i është ushtruar dhe i ushtrohet këtij trupi të shëndoshë nga armiqtë e shumtë të tij, por sot e 25 vjet historia është bërë dhëshmitare e faktit që ne dimë ta mbrojmë, ta ruajmë po edhe ta kultivojmë kulturën islame duke ruajtur në të njejtën kohë shenjtërinë e përmbajtjes së saj me format më të spikatura, me çka ne dëshmojmë se do të qëndrojmë dhe do të ecim ashtu siç na mëson Kur’ani dhe tradita e ndritur e Muhammedit a.s.

Këtë eveniment me prezencën e tyre e nderuan personalitete të jetës fetare dhe publike, ambasadorë të përfaqësive diplomatike në Shkup, përfaqësues të

institucioneve shtetërore dhe pushtetit lokal, anëtarë të ekzekutivit të shtetit dhe një numër boll i madh i të pranishmëve që iu përgjigjën thirrjes së Bashkësisë Fetare Islame dhe Kreut të saj Reis ul Ulemasë H. Sulejman ef. Rexhepit. Gjithashtu me prezencën e tyre nderuan kreun e BFI-së, dy homologët e tij nga dy shtetet shqiptare, Myftiu i Kosovës Naim ef. Tërnavë dhe i deleguari i Kryetarit të Komunitetit Musliman të Shqipërisë, Myfti Ali Hallaçi.

Akademia u hap me shfaqjen e një dokumentari dhjetëminutësh të përgatitur nga Agron Vojnika, të titulluar “5 shekuj Medrese” që në pika të shkurtra rrëfente mbi historikun pesë shekullor të kësaj kalaje të dijes. Në këtë dokumentar të përgatitur aq mirë, në përcjellje të sekuencave të rrjedhojës së procesit edukativo-arsimor të qendrës si dhe degëve për femra të Medresesë, mes tjerash u potencua se: Medreseja Isa Beu në Shkup, që

në të kaluarën ka prezantuar institucionin më të lartë arsimor dhe njihej si shkollë më me famë në Rumeli, sot paraqet institucionin kryesor në fushën e edukimit dhe arsimit të gjeneratave të reja në frymën e vlerave dhe ditorisë islame. Kjo kala e dijes dhe e shkencës qëndron në këmbët e saja që nga shekulli i XV, ndonëse me ndërprerje të kohëpaskohshme të punës së saj nga faktori luftë në Ballkan. Kështu duke parë nevojën e patjetërsueshme të punës dhe ekzistimit të Islamit dhe vlerave të tij në vendin tonë, Bashkësia Islame e Maqedonisë aprovoi vendimin

“Kjo kala e dijes dhe e shkencës qëndron në këmbët e saja që nga shekulli i XV, ndonëse me ndërprerje të kohëpaskohshme të punës së saj nga faktori luftë në Ballkan. Kështu duke parë nevojën e patjetërsueshme të punës dhe ekzistimit të Islamit dhe vlerave të tij në vendin tonë, Bashkësia Islame e Maqedonisë aprovoi vendimin për ndërtimin e Medresesë Isa Beu në Shkup, e cila në vitin shkollor 1984/85 do të fillojë procesin edukativo-arsimor, i cili që atëherë 25 vjet me radhë pa ndërprerë vazhdon punën e vet deri në ditët e sodit.”



për ndërtimin e Medresesë Isa Beu në Shkup, e cila në vitin shkollor 1984/85 do të fillojë procesin edukativo-arsimor, i cili që atëherë 25 vjet me radhë pa ndërprerë vazhdon punën e vet deri në ditët e sodit.

Tendenca për të kontribuar në edukimin dhe mbjelljen e vlerave të gjëra të Islamit në masat e gjëra të popullatës e ka shoqëruar vazhdimisht punën e kësaj vatre, duke u paraqitur si premisa e pashkruar që drejtonte kahjen e aktivitetit të këtij institucioni. Kështu si rezultat i gjithë kësaj na paraqitet edhe hapja e degës për meshkuj në Shtip, që synon brezave të rinj të musimanëve të Maqedonisë lindore t'u ofrojë mundësinë e shkollimit dhe arsimimit në frymën islame si dhe krijimin e kuadrove të reja që do t'u shërbejnë qëllimeve të lartpërmendura.

Ky institucion preokupim permanent të vetin gjatë tërë kohës së ekzistimit e ka pasur edhe çështjen e edukimit dhe arsimimit të femrës myslimane, duke ia ofruar këtë asaj në fillim përmes mësimit me korrespondencë e më pas me krijimin e kushteve dhe rrethanave të përshtatshme edhe përmes degëve të veçanta për femra, që sot funksionojnë në Tetovë, Shkup dhe Gostivar, pasi siç na bën me dije Reisul Ulema H. Sulejman ef. Rexhepi, me fjalët e tija gjatë hapjes solemne të Paraleles së Shtrirë të Vajzave në Tetovë: "Dora që përkund djepin arsimon dhe kombin".

Sot kjo Medrese gjithashtu krenohet me një numër prej



3350 nxënësish të regjistruar, nga të cilët kanë diplomuar mbi 1330, përfshirë këtu edhe numrin prej 330 vajzash të diplomuara. Numra këto, që ne vete përfshijnë një gjeografi të gjerë myslimane në Ballkan, e cila ngërthen: Shqipërinë, Bullgarinë, Kosovën, Luginën e Preshevës, Sanxhakun etj. Vise të gjitha këto nga të cilat ka pasur nxënës në bankat e kësaj medreseje.

Pastaj pas shfaqjes së këtij dokumentari fjalën e rasti e mori Myftiu i Kosovës Naim ef. Tërnavi, i cili uroi Medresenë dhe BFI-në për këtë jubile, duke i uruar jetë të gjatë këtij institucioni që ka luajtur rol të rëndësishëm në edukimin islam të brezave.

Pas tij manifestimin e përshëndeti edhe i deleguari i Kryetarit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, Myfti Ali Hallaçi, që përgëzoi Bashkësinë Fetare Islame dhe të gjithë myslimanët e

Maqedonisë për shënimin e këtyre dy datave të rëndësishme historike.

Me rastin e shënimit të festës së vitit të rij hixhrij 1431 dhe 25 vjetorit të Medresesë, të pranishmëve iu drejtua edhe Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të R.M, Reis ul Ulema H. Sulejman ef. Rexhepi, i cili pasi foli për rëndësinë e Hixhretit si ngjarje me rëndësi shumë dimensionale, uroi të pranishmit edhe për njëzet e pesë vjetorin e ripërtëritjes së Medresesë Isa Beu në Shkup. "Duke u nisur nga këto baza ne për 25 vite me radhë në Medresenë Isa Beu në Shkup arritëm që në këtë frymë të shkollojmë gjenerata të reja intelektualësh dhe imamësh. Prandaj falë besimit të palëkundur në Allahun Fuqiptotë dhe sakrificave e angazhimeve të brezave tanë, ne po krijojmë hapësirë dhe mundësi që kjo dituri të

përçohet nga brezi në brez dhe sot krenohemi që kemi mbi 1300 studentë të diplomuar dhe mbi 600 të tjerë që shkojnë asaj rruge. Me këto që ne kemi arritur, kemi të drejtë të besojmë dhe shpresojmë se në dyert tona po troket një vit tjetër islam i madh dhe i bardhë; vit me më shumë shpresë, mirëkuptim, dashuri, punësim dhe begati", theksoi Haxhi Sulejman Efendi Rexhepi.

Më pas vijoi një program i begatshëm kulturor - artistik i përgatitur nga Mr. Abas Jahja dhe Korri i SHMI "Medreseja Isa Beu", që njëherit paraqet edhe kurorëzimin e kësaj Akademie solemne të organizuar me rastin e shënimit të vitit të ri hixhrij 1431 dhe 25 vjetorit të ripërtëritjes së Medresesë së Isa Beut.

Me minutat e kaluara në shoqërim të ilahive dhe kasideve të interpretuara nën dirigjim të Mr. Abas Jahjas, u kompletua programi i përgatitur për të shënuar, në veçanti këtë datë tejet të rëndësishme islame, pra 25 vjetorin e rifillimit të procesit edukativo-arsimor të Medresesë legjendare të Isa Beut.

Me falënderime ndaj Allahut xhsh. në radhë të parë dhe më pas duke falënderuar edhe të gjithë të pranishmit për prezencën e tyre si dhe duke uruar që ky trend i bëmave të mëdha të jetë sa më jetëgjatë u përmyll akademia në fjalë.

**Ensar Sinani, IV-a,
"Medreseja Isa Beu" –
Shkup**



"Sot kjo Medrese gjithashtu krenohet me një numër prej 3350 nxënësish të regjistruar, nga të cilët kanë diplomuar mbi 1330, përfshirë këtu edhe numrin prej 330 vajzash të diplomuara. Numra këto, që ne vete përfshijnë një gjeografi të gjerë myslimane në Ballkan, e cila ngërthen: Shqipërinë, Bullgarinë, Kosovën, Luginën e Preshevës, Sanxhakun etj. Vise të gjitha këto nga të cilat ka pasur nxënës në bankat e kësaj medreseje."

"Dora që përkund djepin arsimon dhe kombin"

Intervistoi: Valbona Zunçe

Reis ul Ulema i BFI

I nderuar Reis ul Ulema, H. Sulejma e f. Rexhepi, për shumë vjet Viti i Ri Islam, Hixhri 1431!

Reis ul Ulema: Ju falënderit, gjithashtu juve dhe gjithë myslimanëve anekënd botës, me dëshirë që të gjithë të kenë shëndet të mirë, suksese, përjetime të veçanta, punësime dhe një vit të begatshëm.

- Me rastin e vitit të ri Islam - Hixhri 1431, shënuat edhe 25 vjetorin e ripërtirjes së Medresesë "Isa beu" –Shkup. Cilat ishin organizimet me të cilat shënuat këto data?

Reis ul Ulema: Sigurisht që manifetsimi i ndrimit të motmoteve sipas kalendarit Islam është tradicional nga Bashkësisa Fetare Islame me shekuj, njëherit ketij manifestimi ia bashkangjitem edhe një datë të rëndësishme që ka të bëjë me myslimanët e maqedonisë ngase po kremtojmë 25 vjetorin e ripërtirjes së Medresesë Isa Beu, Shkup. Vatër e arsimit për shoqërinë tonë dhe më gjërë, roli i së cilës ka qenë i theksuar që nga themelimi i saj e deri më tani, por gjithashtu mbetemi me shpres dhe me bindje se kjo shkollë do të ketë jehonë gjithmonë deri sa të jetë jeta mbi dhe! Medrseja Isa Beu është histori në vete, ndërsa Ne tani vetëm shënuam një të dhënë në një nga kapituj e shumtë të saj dhe me të cilën mbetemi histori e saj, përmes së cilës edhe i dham emër periudhës në të



cilen po jetojmë.

Si e shihni zhvillimin e fesë Islame në shoqërinë e sotme?

Reis ul Ulema: Islami ka perspektivë në vend dhe më gjërë, BFI kurrënjëherë nuk ka qenë më aktive se tani! Të gjitha shërbimet i ka të sistematizuara- kemi rregullore, akte normative, prandaj zhvillimi i jetës fetare është në drejtim pozitiv ngase kohëve të fundit kemi renovime dhe ripërtirje të xhamive, objekteve fetare, zgjerimin e shkollës së mesme teologjike islame, Medresesë Isa Beu në disa qytete të vendit, ripërtirjen e objekteve fetare. Institucionet edukativo- arsimore janë në shërbim dhe po ecin në rrugë të mbarë në të gjitha drejtimet, me çrast prodhojmë dhe do të jemi në shërbim të shoqërisë. Tani kemi

mbi 1300 nxënës të diplomuar dhe mbi 600 nxënës të tjerë që shkojnë asaj rruge, shifër e cila fletë mjaft qartë për perspektivën e kësaj shoqërie. BFI njëherit merr edhe pozicion të ruajtjes së tendencave devijuese dhe paraqitjeve të grupeve devijuese, ky institucion i lartë fetarë mbron Islamin, nuk ka interpretim të islamit arab, iranian, turk, por predikim autokton të vendeve të Evropës. Ne gjithmonë angazhohemi që t'u kundërvihemi atyre të cilët bëjnë përpjekje për të dëmtuar Islamin dhe shoqërinë!

H. Sulejman ef. Rexhepi, si qëndron bashkëpunimi mes BFI me shtetet fqinje Kosovë e Shqipëri?

Reis ul Ulema: Brengë

permanente ka qenë e të gjitha bashkësive që të kemi një bashkëpunim edhe më të fuqishëm ndërinstitucional. Në mandatin Tim të dytë në periudhën kur Hafiz Sabri Koçi ishte në krye të Komunitetit Mysliman Shqiptarë dhe në bashkëpunim me Bashkësinë Islame të Kosovës, ngrita iniciativë dhe si bartës i projektit, BIK pa rezerv e pranoi dhe iu bashkëngjiti që të formojmë këshillin koordinativ për bashkëpunim të qendrave Tiranë, Shkup, Prishtinë dhe i njejtë u themelua. Kryetari i këshillit u caktua të jetë kryetari i KMSH, Hfz. Sabri Koçi, nënkryetarë H. Sulejman ef. Rexhepi dhe D-r. Rexhep ef. Boja. Anëtarë të saj kryesie nga Kosova ishin: H. Naim Tërnavë dhe H. Sabri Bajgora, ndërsa nga Maqedonia ishin H. Bahri Aliu dhe H. Ruzhdi Lata. Sekretar i përgjithshëm ka qenë tani më i ndjeri H. Sali Tivari. Por për fat të keq nuk patëm veprime të përbashkëta, ku fajtorë kryesorë ka qenë Tirana, ndoshta edhe sot e kësaj dite neglizhohet nga ajo qendër, por shpresojmë se përsëri do të ringjallet. Preokupim i ynë është riaktivizimi i këshillit ngase ekziston gatishmëri nga të gjitha palët, ngase nuk ka çfarë na ndanë pasi që jemi një popull, një kulturë, traditë dhe një gjuhë.

Në Medresenë "Isa Beu" keni studentë nga Kosova, Shqipëria dhe vende tjera. Sa jeni të kënaqur në këtë drejtim me kuadrot që nxjerrni?

Reis ul Ulema: Kuadrot tona që mbarojnë Medresenë Isa Beu dhe regjistrohen në Fakultetin e Shkencave Islame dhe qendrat tjera Universitare

me shumicë jemi të kënaqur, ndërsa nga FSHI të stërkënaqur me interpretimin e Islamit autokton, por gjithashtu edhe nga të tjera qendra si p.sh El Ez-heri etj.

- Doni të hapni edhe paralele të tjera, ose të zgjeroni rrjetin e shkollave për mësimfetar. Në cilat vende parashihni të bëhen këto paralele?

Reis ul Ulema: Jemi të kënaqur me atë që kemi arritur deri më tani me zgjerimin e Medresesë Isa Beu në disa qytete në Maqedoni, ndërsa në të ardhmen kemi nevojë të shtrihemi në Lindje dhe në Perëndimin e skajshëm. Kënaqësia ynë më e madhe është se jemi në shërbim të edukimit dhe arsimimit të femrës dhe shpresojmë që në të ardhmen të kemi nëna dhe edukatore të mirëfillta të gjeneratave të reja.

Keni shumë dokumente në Arkivin shtetëror, për denacionalizimin e tokave që e ka pasur dikur BFI. Deri ku kanë arritur këto gjurmime, dhe çfarë dokumente me fakte keni marrur deri tani në dorë?

Reis ul Ulema: Megjithëse BFI është tejet aktive në këtë drejtim që nga fillimi ka arritur të jetë e përgatitur dhe siguron dokumentacionet e duhura, për

fat të keq nuk jemi të kënaqur me çështjen e denacionalizimit. Dallimi është i madh mes Kishës Ortodokse Maqedone (KOM) dhe Ne, arsyet janë se qeveria e ndihmon me të madhe KOM dhe e favorizon në të gjitha aspektet, përveç që ia ka kthyer pronën në tërësi e ka favorizuar me pronë të re, siç është rasti me Hotel "IZGREV" në Ohër dhe kazermën në Maqedoninë Lindore për shërbim 99 vjetë. Ngecja e rezultateve konkrete favoritetë BFI janë bindjet tona se kjo ndodh për shkak të faktorit tonë pjesëmarrës në Qeveri të cilët luajn një rol tejet pasiv dhe të pa interesuar dhe nuk kemi pasur kurrëfar ndihme konkrete deri më tani. Historia do t'i dënon. BFI edhe më tutje do të jetë tejet transparente dhe në kohën parazgjedhore do të del me qëndrim publike duke ftuar popullin, duke apeluar popullit që të jenë më të matur kujt ia japin besimin. Kur dihet se mbi 83% popullin mysliman e përbëjnë shqiptarët në Maqedoni.

-Ku kanë arritur punët me Burmali xhaminë?

Reis ul Ulema: BFI definitivisht nuk hjek dorë kurrë një herë nga iniciativa për marrjen e lejes për rindërtim. Nëse u ndërpritet iniciativa për rindërtimin e kishës në shesh të Shkupit për shkaqe politike, duheshte dhe duhet qeveria e

R.M të matë me të njetin arshin konform Kushtetutës së R.M e cila Kushtetutë garanton barabarësi të gjitha bashkësive fetare para ligjit. Kurse rasti konkret flet se nuk trajtohem të barabartë me KOM-in. Nëse do të kishte probleme për rindërtimin e xhamisë atëher për çfar arsye nuk na u dorëzua lokacion siç u dorëzua KOM, por edhe sikur të kishte nevojë me para?! Edhe këtu fajtorë është subjekti politik që participon në pushtet i cili si duket është permanent inferior dhe i pavlerë në ushtrimin e pushtetit. Vlenë të përmendim këtu deklaratën e Bujar Osmanit, Ministrit të Shëndetësisë i cili e gënjen popullin me atë që çka do të ndodh me kishën do të ndodh edhe me xhaminë, në fund doli diçka tjetër me kishën, ndërsa krejtësisht tjetër me xhaminë.

-Cilat janë aktivitetet dhe projektet më të rëndësishme që i realizuat këtë vitë në BFI?

Reis ul Ulema: BFI pas vete la një vitë të suksesshëm, me plotë të arritura! Gjatë këtij viti kemi miratuar disa rregullore në përputhshmëri me Kushtetutën e BFI, janë bërë disa gurthemele të xhamive, disa prej tyre janë lëshuar në përdorim, në renovim e sipër janë disa xhami, është bërë intervenim në Fakultetin e Shkencave Islame duke përsh-

tatur për punë kabinete të ndryshëm, biblioteka, etj., është shtuar kapaciteti i Medresesë Isa Beu, pika më e rëndësishme që ndodhi gjatë vitit 2009 është lëshimi apo inaugurimi i godinës së re të paraleles së vajzave të Medresesë Isa Beu në Tetovë, paralelja e vajzave të Medresesë Isa Beu në Shkup u vendos në kompleksin Kapan An, kemi punuar në sigurimin e vendit dhe plotësimin e dokumentacioneve për ngritjen e Qendrës Islame në Shkup, etj.

-Viti 1431 ose 2010, me cilat projekte BFI do ta nis punën?

Reis ul Ulema: Vazhdojmë me projektet e hapura në favor të BFI që janë në proces dhe do t'i rrekemi punëve që kanë vlerën e vetë historike, siç është ngritja e një Qendre Islame në nivel të R.M në Shkup, vitin e ardhshëm, është edhe 1400 vjetori i fillimit të zbritjes të Kur'anit Famëlartë. Me çrast planifikojmë nxitjen e hafizëve për të vazhduar nxënien e Kuranit përmendësh; organizimin e garave Kura'nore në hifz dhe lexim të Kuranit famëlartë; Botimin dhe ribotimin e disa titujve, dhe do të angazhohemi edhe më tutje të zhvillojmë në mënyrë të mirëfilltë jetën fetare këtu në Maqedoni dhe në mesin e xhemateve tona në diasporë etj.

Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavava

- I nderuari Myfti i Republikës së Kosovës, ef. Tërnavava, për shumë vjet Viti i Ri Islam Hixhri 1431!

Myftiu Tërnavava - Esselamu alejkum, për shumë vjet juve, dhe gjithë popujve që i përkasin kësaj feje të pastër, me dëshirë që paqja, bereqeti e mirësia përherë të jenë mbret nëpër shtëpitë dhe shpirtin tonë.

-Si e shënuat në

Kosovë Vitin e Ri, Islam - Hixhri 1431?

Myftiu Tërnavava - Ashtu si gjithë myslimanët, edhe ne në Kosovë, këtë vit e kemi pritur me aktivitete të ndryshme kulturore dhe artistike, duke bërë organizime nëpër myftini dhe nëpër shkollat fetare. Më vjen mirë që në prag të kësaj nate të madhe gjendem në Shkup me vëllezërit dhe miqtë nga BFI në RM që shënuam këtë natë të madhe, duke përkujtuar



dhe folur gjithashtu edhe për rëndësinë dhe kontributin 25-vjeçar që ka dhënë dhe vazhdon të jep Medreseja "Isa beu" në Shkup, me degët e saj nëpër qytete të ndryshme të Maqedonisë. Shfrytëzoj rastin t'ju uroj shëndet, dhe suksese. Kemi mision të shenjtë...

- Si e shihni zhvillimin e fesë Islame në shoqërinë e sotme?

Myftiu Tërnavë – Shqiptarët si komb, më shumë i përkasim fesë islame. Ne kemi potencial, vullnet dhe elan që t'i tregojmë BE dhe botës se ne jemi fe e dashurisë dhe e paqes. Jemi duke punuar sipas kushtetutës së fesë Islame KUR'AN-it, dhe sipas rregullave të tij do të ushqejmë brezat që vijnë për zhvillim të drejtë dhe të mirëfilltë të Islamit.

- z.Tërnavë, si qëndron

bashkëpunimi mes bashkësive islame të Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë?

Myftiu Tërnavë – Ne kemi bashkëpunim të mirë, por mundemi edhe më mirë. Ne duhet ta dijmë dhe ndjejmë në shpirt se neve na takon përgjegjësia në Ballkan, Evropë e më gjërë për vlerat reale të Islamit. Neve na duhet edhe një bashkëpunim dhe angazhim më i madhë dhe më i ngushtë mes tre vendeve dhe duhet të reagojmë në situata të ndryshme si një trup, me zë të përbashkët për të pasur edhe një forum të lartë të cilin e kemi themeluar bashkërisht para shumë vitesh, por që fatkeqësisht tani ka stagnuar punën, nga shkaqet e ndryshme që kemi pasur. Ne kemi tentativa të keqsimi të gjendjes islame që vijnë nga perëndimi nga misionarë të ndryshëm që flasin për konvertim nga feja

islame në fe tjera, por dhe shoqata tjera që vijnë nga perëndimi që nuk kanë program por që punojnë kundër Bashkësisë Islame, por me angazhimin dhe kontributin tonë ne, ja kemi dalë të ruajnë stabilitetin dhe tentativat e kishës ortodokse serbe se Kosova do jetë një shtet fundamentalist radikal kanë rënë në ujë sepse BIK me punën e tij sistematike ka bërë që të rrezojë mendimin negative që ka mbretëruar nëpër vende të ndryshme të botës, sepse ne nëpërmjet konferencave të ndryshme, seminareve, tribunave etj, kemi treguar se jemi për bashkëpunim, respektim ndëretnik e ndërfehtar, dhe për paqe.

-Ka mjaft studentë edhe nga Kosovë e Shqipëria në Maqedoni e anasjelltas. Sa jeni të kënaqur në këtë drejtim?

Myftiu Tërnavë – Me

përgjegjësi them se jemi të kënaqur me punën tonë sepse punojmë me të njëjtin program, kemi të njëjtin fe, gjuhë dhe kulturë. Angazhimi ynë për brezat që vijnë do të jetë i pakursyer që edhe ata, edhe ne të ngelim të kënaqur me punën tonë, me qëllim që dhe brezat që vijnë të kemi me çka t'i ushqejmë.

Mesazhi që do t'ju jepni lexuesve të revistës "Hëna e re".

Myftiu Tërnavë – Jam lexues i rregullt i Hënës së re, më pëlqen, dhe uroj që të punohet më tepër për vlerat e fesë sonë të shenjtë islame. Gjithashtu porosis që të duhe mi, të punojmë me qëllim që harmonia, sinqeriteti dhe respekti reciprok të dominojë mes nesh në çdo lëmi. Pra Urime dhe suksese redaksisë së Hënës së re, për punën e tyre të vyer dhe fisnike.

Ali ef. Hallaçi, Myfti i Kukësit- Shqipëri

I nderuar Myfti, ef. Ali, për shumë vjet Viti i Ri Islam Hixhri 1431!

Myftiu Hallaçi - Esselamu alejkum, për shumë vjet juve, dhe gjithë botës Islame, me dëshirë që paqja, e mirësia përherë të jenë mbret nëpër vatrat dhe shpirtin tonë.

Nata e Hixhrit është natë e madhe për gjithë popullin Islam. Në këtë natë të madhe të Hixhrit, ne nga Komuniteti Mysliman jemi të nderuar për fetsën që i është bërë kryetarit H. Selim Muça dhe ndjehem gjithashtu i nderuar që sot këtu jam në emrin e tij dhe në mesin tuaj me rastin e këtij manifestimi madhështor i organizuar nga BFI. Shpresojmë që ky vit të jetë i mbarë për të gjithë shqiptarët, dhe lusim Zotin që Viti i Ri të na sjellë sa më shumë mbarësi në të gjithë sferat e jetës shoqërore, politike, kulturore e më gjërë.



- Si qëndron bashkëpunimi mes treshes Shqipëri – Kosovë dhe Maqedoni?

Myftiu Hallaçi - Bashkëpunimi ec mirë, dhe si përfaqësues të fesë insistojmë që qetësia të mbizotërojë gjithmonë, të jemi unik në qël-

limet tona, dhe shpresojmë që Zoti i madhë të na jep mirësi sa më shumë.

Me strukturat e punës nëpër shkollat fetare mes tre vendeve, jemi të kënaqur nga puna dhe bashkëpunimi, me ç'rast përfitojmë dhe këmbëjmë përvoja nga njëra-tjetra,

dhe gjithmonë mundohemi që në qëllimet tona të dalim Unik.

- Si e shihni zhvillimin e fesë Islame në shoqërinë e sotme?

Myftiu Hallaçi -Shoqëria islame është në zhvillim e sipër. Të gjithë të rinjtë po e kuptojnë se Islami është kulturë, zhvillim, qytetërim, dashuri e paqe. Tani më mirë se kur e shohin se islami i ofron drejt të vërtetës, paqes shpirtërore e më gjërë.

- Mesazhi që do t'ju jepni lexuesve të revistës "Hëna e re"!

Myftiu Hallaçi - Revistës Hëna e re, i urojmë suksese dhe të rinjtë i porosis që të lexojnë sa më shumë që të përfitojnë sa më shumë njohuri të reja nga feja, shkenca, dhe jeta shoqërore që ju sjell kjo revistë.

SHKAK, REFERENDUMI PËR MINARET NË ZVICËR

Thirrja “Eja në shpëtim” po frustron evropianët

Do të ishte një gabim i madh nëse do t'u lejohej populistëve të krahut të djathtë që t'i marrin në kontroll frenat e debatit.

Përndryshe nuk do të duhet të çuditëshim nëse do të merreshin masa të tilla si ajo e referendimit të fundit në Zvicër, dhe këtë herë edhe në vende të tjera të Evropës. Atëherë çfarë do të ndodhte? A do të fillonte teza e shumëpërfolur se konfliktet e ardhshme do jenë të përmasave civilizuese, që nis në verën 1993, kur Samuel P. Huntington shtron pikëpamjet për të ardhmen e konflikteve në botë, që sipas tij do të jenë pikërisht në ndeshjen e civilizimeve...

Driton Dikena

Dy vite më parë Vatikani lëshoi alarmin: Po islamizohet Evropa! Vetë Papa Benedikti i XVI gjatë qëndrimit në Ratisbona të Gjermanisë, në një intervistë të gjatë dhënë agjencisë gjermane “Sueddeutsche Zeitung” tha se “Nuk mund të mohojmë një ekspansion të fuqishëm të fesë Islame në Perëndim, sikurse nuk mund të mohojmë rrezikun që sjell ky ekspansion për identitetin e Evropës”

Alarmi mbi islamizimin e Evropës është koincidence, e jo rastësi. Referendumi kundërthënës në Zvicër kundër minareve i shoqëruar nga fushata, e cila është cilësuar si raciste dhe shkelje e të drejtave të njeriut, është grindja më e re e radhës në Evropë në lidhje me kufijtë e multikulturalizmit dhe stilin jetësor të myslimanëve.

Edhe kësaj herë Evropa u mbulua me posterë, në të cilin mbi flamurin e Zvicrës ishin vendosur minare në formë të raketave, ndërsa pranë tyre qëndron një femër e veshur me perçe.

Pas dy vitesh islamofobia është rritur shumë. Frytet japin rezultat. Presidenti i Zvicrës, Hans Rudolf Merc arriti t'i bind bashkëkombësit

se nuk do të dëgjohej thirrje për lutje islame në vend. Ezani i frikëson. Thirrja “Eja në namaz” dhe “Eja në shpëtim” po i frustron evropianët.

“Thirrja për lutje nuk do të dëgjohej në Zvicër”, bind Merc në videomesazhin për popullin, ku kërkoi që t'i thonë “JO” kërkesës për ndalesë të ndërtimit të minareve në Zvicër. Dhe zviceranët iu bindën. Pesëdhjeteshtatë për qind e votuesve zviceranë kanë votuar pro ndalimit të ndërtimit të minareve.

Pas Zvicrës, edhe Holanda e ka nxjerr në shesh islamofobinë. Partia djathtë e Lirisë në Holandë, njoftoi se do të kërkojë nga Qeveria, që të mbajë referendum për ndalimin e ndërtimit të minareve, sipas shembullit të Zvicrës.

Lideri i Partisë së Lirisë së Holandës, Gert Vilders, i tha gazetës Volkskrant se partia i tij “do ta ftojë qeverinë, që të mundësojë mbajtjen e një referendumi të ngjashëm edhe në Holandë”.

Edhe në Gjermani janë duke u bërë debate të ashpra mbi ndërtimin e një xhamie të madhe në qytetin e Kolonjesa, qytet simbol i katolicizmit gjerman.

Vajin këtij zjarri ia shton edhe Olivia Sarfy, eksperte e statistikës dhe e çështjeve sociale në Belgjikë, e cila thotë



se nëse “nataliteti i myslimanëve do të vazhdojë me shifra të njëjta, kryeqyteti belg, që njëkohësisht është edhe kryeqyteti i Evropës, brenda 20 vjetësh do të jetë një qytet me banorë shumicë myslimane”. Evropianët frikësohen për Brukselin që konsiderohet kryeqyteti i Unionit Evropian, ngase institucionet themelore të BE-së gjenden në Bruksel. Në pom këtë qytet gjenden edhe qendra e NATO-s dhe e Mbretërisë Belge.

FRIKA NGA THIRRJA “EJA NË SHPËTIM”

Frikësohet nga ndërtimi i një xhamie më shumë minare pranë qendrave të botës, e më tepër nga Ezani dhe thirrja “Eja në shpëtim” që do të shkonte shumë lehtë në veshët e euro-parlamentarëve.

Të dhënat e tilla dhe anketat e ndryshme që dëshmojnë për rritjen numrit të myslimanëve në Evropë, po propagandohen nga shumë organizata djathtiste që promovojnë Islamofobinë dhe politikën antimuslimane.

Ndërkaq, sipas një studimi të bërë nga një institut hebre në Amerikë, theksohet se është shqetësuese rritja e numrit të popullsisë në Evropë. Kjo cilësohet si “kërcënim ndaj Amerikës” duke shtuar se kjo paraqet shqetësim se do të humbet Evropa e krishterë, e cila do të shndërrohet në një kontinent mysliman.

Këto ditë në Evropë një aleancë njerëzish janë mbledhur së bashku me të vetmin qëllim, që ta pengojnë Islamin të mos bëhet një forcë politike dominuese në Evropë, dhe kanë formuar një lëvizje që mëton të bëhet gjithë-evropiane e gjithëbotërore për të luftuar kundër islamizimit të Evropës, në fakt kundër Islamit e myslimanëve kudo që janë. “Stop islamizimit të Evropës”, “Mjaft është mjaft!” janë parullat e para të shprehura prej tyre, që kanë siguruar se “ekzistojnë për ta luftuar ligjërisht ekspansionin e dukshëm e të padukshëm të Islamit në Evropë”.

Në këtë mish-mash evropian janë vetë ata që mbyten në helmin e përgatitur për të helmuar islamin. T’ia bësh vetes varrin, kështu e kemi një fjalë në shqiptarët.

Referendumi zviceran ndau në disa taborë Evropën. Ata që e përkrahin në mënyrë absurde e arsyetojnë. Julia Onken, gjoja një ekspertë zvicerane arsyeton se “Xhamitë janë objekte të meshkujve, minaret janë simbol i pushtetit të meshkujve. Ndërtimi i minareve, gjithashtu nënkupton se shteti e pranon shtypjen e femrave”. Por, arsyetimi i saj bie ndesh me ekspertët e OKB-së për të drejta të njeriut, të cilët kanë theksuar se kjo ndalesë është cenim i lirisë së religjionit dhe i lirisë. Ministrja zvicerane e

Drejtesisë, Eveline Schlumpf, është pajtuar me këtë qëndrim, duke theksuar se ndalesa është shkelje e ligjeve kundër diskriminimit dhe e së drejtës për ushtrim të lirë të religjionit, me ç’rast ajo, madje ka theksuar se kjo fushatë nuk është dashur të lejohet fare.

Vendimi i Zvicrës që të ndalojë ndërtimin e minareve është shprehje e jotolerancës, pohon shefi i diplomacisë franceze Bernar Kushner.

“Nga pak jam i skandalizuar nga vendimi i cili është negativ sa u përket vetë zviceranëve, meqë nëse nuk mund të

ndërtohen minaret, atëherë kjo do të thotë se ngulfatet një besim”, deklaroi Kushneri.

DIALOG APO KON- FLIKT MES CIVILIZ- IMEVE ?

Zvicra është një vend demokratik, tolerant dhe kozmopoliten, por me votën e fundit kanë dalë në pah tipare të tjera të vendit që dëshmojnë frikë, fanatizëm dhe dëshirë për t’u vetizoluar. Vota do të dëmtojë kredibilitetin e Zvicrës, si ndërmjetës në sytë e vendeve myslimane dhe, mbi të gjitha do të shkaktojë një dëm të madh në marrëdhëniet e Zvicrës me myslimanët që jetojnë në këtë vend, pasi ky amendament promovon izolimin nga pjesa tjetër e shoqërisë. Kjo është një shenjë e shndërrimit të masave në masa autoritare dhe një shembull sesa shpejt një demokraci mund të shndërrohet në autoritarizëm. Vota, pa dyshim do ta ndryshojë imazhin e Zvicrës jashtë vendit. Vendi alpin, që është prezantuar deri më sot si neutral dhe mbrojtës i të drejtave të njeriut, nuk do të krenohet më me këtë cilësi, tashmë të njollosur. Zvicra është vendi i Kryqit të Kuq dhe i Konventës së të Drejtave të Njeriut të Gjenevës, por tanimë modeli i supozuar i demokracisë ka dhunuar të drejtat e njeriut dhe lirinë e fesë dhe ka mbështetur diskriminimin ndaj një grupi të caktuar vetëm mbi bazën e fesë. Vota do të ketë pasoja serioze. Ajo nuk do të frenojë problemet lidhur me emigracionin në Zvicër, por do të sjellë probleme të reja për në sferën e marrëdhënieve ndërkombëtare.

Bankat zvicerane dhe ekonomia e këtij vendi, që kanë lidhje të ngushta me ekonominë e vendeve të ndryshme të botës, përfshirë edhe botën arabe, do t’i vuajnë pasojat.

Fakti që qytetarët zviceranë janë shndërruar në diskriminues të një feje të caktuar, në një mënyrë që dhunon të drejtat e njeriut është një dëm shumë i madh ndaj reputacionit të vendit, por kjo nuk do të thotë se është fundi. Ligji mund të ndryshohet, dhe ka shanse që minaret të vazhdojnë të ndërtohen në Zvicër.



Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, sipas paralajmërimeve do të marrë çështjen në shqyrtim dhe ka të ngjarë që të vërejë një shkelje të të drejtave të njeriut në vendimin e Zvicrës. Por, sido që të shkojë puna e minareve, dëmi tashmë është bërë. Shqetësimi ndaj sjelljeve të caktuara ndaj myslimanëve dhe islamit nuk është një çështje që është kufizuar vetëm në Zvicër. Debatet e minareve janë bërë edhe në Danimarkë dhe Gjermani, ndërsa në Francë janë zhvilluar debate edhe për mbulesën, përkatësisht shamitë e vajzave myslimane. Në Holandë politikanët antimyslimanë janë goxha të suksesshëm. Deri më sot politikanët e qendrës në mbarë Evropën kanë dështuar në gjetjen e përgjigjeve të duhura ndaj këtyre shqetësimeve gjithmonë në rritje. Duke u nisur nga të gjitha këto fakte, nuk do të ishim të saktë nëse do ta kufizonim fenomenin në një vend të vetëm, tek Zvicra, në këtë rast. Ajo që ka ndodhur është edhe shprehje e dështimit të elitës politike liberale që nuk ka mundur të gjejë zgjidhjet e duhura. Kjo, gjithsesi është një çështje që ka të bëjë me një pjesë të madhe të popullsisë zvicerane dhe do të ishte një gabim i madh nëse do t'i lejohej populistëve të krahut të djathtë që t'i marrin nën kontroll frenat e debatit. Përndryshe, nuk do të duhet të çuditëshim, nëse do të merrreshin masa të tilla, si ajo e referendumit të fundit në Zvicër, dhe këtë herë edhe në vende të tjera të Evropës. Atëherë çfarë do të ndodhte? A do të fillonte teza e shumëfolur se konfliktet e ardhshme do jenë të përmasave civilizuese, që u nisën në verën 1993, kur Samuel P. Huntington shtron pikëpamjet për të ardhmen e konflikteve në botë, që sipas tij do të jenë pikërisht në ndeshjen e civilizimeve, teori kjo, që pason me një varg arsyesimesh, po ashtu edhe kundërshtimesh.

Shtegdalja do të mund të gjurmohet në një dialog të ri mes kulturave të ndryshme të vendeve islamike dhe atij perëndimor, në mënyrë që projekti i globalizimit të bëhet më i besueshëm për të gjitha qytetërimet e Huntigtonit. Se a do të mund të arrihet kjo mbetet për t'u parë...

HISTORI ISLAME



Ensarët, shoqëria që ndihmoi mbijetesën e fesë Islame

Nga Mr. Sc. Fahrudin Ebibi

Gjatë jetës së vetë Muhamedi sal-lallahu alejhi veselem kishte përjetuar shumë kthesa siç është shpallja, zbritja e Kur'anit Famëlartë, thirrja në Islam etj. Këto ndryshime kishin bërë që Muhamedi alejhis-salam disa vite të përjetoj mundime dhe padrejtësi nga populli i vet. Padrejtësia, urrejtja dhe armiqësia kurejshite ndaj Muhamedit sal-lallahu alejhi veselem kur arriti kulmin e saj, Allahu i Mëshirshëm e kishte urdhëruar Muhamedin sal-lallahu alejhi veselem të emigroj në Medinë. Populli i Medinës me entuziazëm dhe zemërgjerësi e mirëprititi Muhamedin alejhis-salam dhe i afroi ndihmë për misionin që kishte filluar. Që nga ajo kohë medinasit morën emrin "ensarë – ndihmues" dhe në tokën e tyre e formuan shtetin e parë islam, në të cilin do të mund të realizoheshin dhe zbatoheshin urdhrat e Allahut xh.sh.

Për dashurinë që kishin "ensarët" ndaj Muhamedit alejhis-salam dhe për rolin e tyre në historinë Islame, Buhariu ka veçuar në përmbledhjen e vet "el-Xhamius-sahih" një kapitull të veçantë me emrin "Menakib el-ensar" që në përkthim do të thotë "virtetet e vendasve medinas" dhe ka paraqitur në të mbi 375 hadithe, të shpërndarë në 53 kaptina.

Buhariu gjatë punës së vet në këtë vepër

është bazuar në burime të veçanta dhe, gjithashtu ka ndjekur një metodikë të veçantë të prezantimit të lëndës në mënyrë karakteristike.

VLERAT E KËTIJ UMMETI (POPULLI, SHOQËRIE)

Përmbledhja e Buhariut e vë në pah faktin se myslimanët prej ditës së parë, që kur u shpall Muhamedi alejhis-salam peygamber, me vëmendje i kanë ndjekur fjalët, veprat dhe çdo gjë që ka buruar nga Muhamedi alejhis-salam. Historia njerëzore nuk mban mend ndonjë popull të ketë ruajtur, përkatësisht të ketë studiuar jetën e peygamberit të vet, ashtu siç e kishte ruajtur ummeti i Muhamedit alejhis-salam historinë e peygamberit të tyre.

I pari që ka shkruar për jetën e Peygamberit alejhis-salam është Urve b. Ez-zubejri, i cili e shkroi librin "el-Megazi ves-sijer". Para tij, kishte shkruar Eban b. Othman b. Affan, por vepra e tij nuk ka arritur e kompletuar, me përjashtim disa fragmenteve të shpërndara. Më vonë ka shkruar Ibni Shihab Ez-zuhriu me urdhër të halifit Omer b. Abdu-l-aziz dhe vepra e tij llogaritet ndër të parat në këtë drejtim.

Më pas ka shkruar Muhamed b. Is'haku librin "el-Megazi". Kjo vepër konsiderohet



ndër veprat më të hershme të jetës Pejgamberit sal-lallahu alejhi veselem Pastaj Ibni Hishami ka shkruar librin “Siretun-nebevijje”, vepra e të cilit është version i shkurtuar i veprës “Siretu Ibni Is`hak”. Më vonë kanë pasuar shumë vepra nga autor të ndryshëm, që kanë shtjelluar segmente të ndryshme të jetës së Pejgamberit alejhis-selam.

Historia e Muhamedit alejhis-selam, “es-sire” si lëndë, ka peshë të madhe në Islam, për faktin se ajo është e lidhur ngushtë me lëndën e hadithit. Mu për këtë, në përmbledhjet e sunnetit do të vihet në spikamë diçka nga historia, jeta dhe veprimtaria e Muhamedit alejhis-selam

Është fakt që Buhariu llogaritet ndër autorët e parë që ka bërë grumbullimin e haditheve sahiha. Kjo do të thotë se, në përmbledhjen e vet Buhariu ka paraqitur transmetime më të sakta që kanë të bëjnë me jetën e Muhamedit alejhis-selam. Gjithashtu, bëhet e ditur se Buhariu nuk kishte vepruar si autorët e tjerë që kanë shkruar vepra për jetën e Muhamedit alejhis-selam, ngase në veprat e tyre do të hasim gjëra paargumentuara sa duhet, ngase ishin bazuar në transmetime të shpifura dhe të

trilluara.

Që në fillim të theksoj se kuptimi etimologjik dhe terminologjik i termit “Menakib” dhe “Ensar” është:

1. “Menakib”, në kuptimin gjuhësor do të thotë: “virtyt”, “meritë”, “ndershmëri”, “moral” etj.

2. “Ensar”, në kuptimin linguistik do të thotë: “ndihmues”, “ndihmës”, “tifo” etj.

Sa i përket kuptimit terminologjik të termeve të lartpërmendura është:

1. “Menakib”, në kuptimin terminologjik synohet morali, fisnikëria ose ndihma të cilën ia kishin paraqitur vendasit medinas. Muhamedit sal-lallahu alejhi veselem me rastin e migrimit të tij në Medinë.

2. “Ensar”, janë vendasit medinas, të cilët njiheshin në periudhën para islame Evis dhe Hazrexhi. Më vonë pasi që Pejgamberi alejhis-selam bëri emigrimin, fisin Evis, Hazrexh dhe aleatët e tyre i kishte quajtur me emrin e përbashkët “Ensar”.

Emërtimi i tyre me epitelin “Ensar”, nuk është emër i përfituar në bazë të familjes, por term islam. Këtë emër e kishin fituar ata nga shkaku se i dolën në ndihmë dhe e mbrojtën Muhamedin alejhis-

selam nga idhujtarët kurejsh.

Sa i përket fisit Evis, kanë prejardhjen nga Evis b. Harith, kurse Hazrexhi rrjedh nga Hazrexh b. el-Harith. Evisi dhe Hazrexhi ishin vëllezër. Këta ishin bijtë e Amër b. Amir dhe Kajles ku edhe përfundon prejardhja e Ezdit.

ENSARËT PËR SHOQËRINË ISLAME

Në periudhën mekase Muhamedi alejhis-selam bashkë me të afërmit e tij përjetuan izolim të hekur nga idhujtarët kurejsh. Pas tri vitesh izolimi dhe rrethimi, ia doli disi të dal nga ky bllokim. Mirëpo, nuk kaloi shumë kohë, dy ngjarje shumë të rënda e prekën thellë shpirtin e Muhamedit alejhis-selam, ndodhi vdekja e dy mbrojtësve më fortë, vdiq Ebu Talibi dhe Hadixhja r.a.h. Këta dy kanë vdekur në vitin e dhjetë pas shpalljes së Muhamedit alejhis-selam për pejgamber.

Vdekja e Ebu Talibit dhe e Hadixhës r.a.h. shkaktoi pikëllim të thellë te Pejgamberit alejhis-selam. Roli pozitiv i tyre kishte ndihmuar islamin. Ndonëse Ebu Talibi akoma ishte në fenë e të parëve dhe etërve të tyre, pra ishte idhujtar, por vazhdimisht

angazhohej dhe e mbronte Muhamedin alejhis-selam nga torturat e armiqve. Në një rast Muhamedi alejhis-selam ka thënë: “Kurejshët nuk kanë mund të më diskreditojnë me diçka që unë e urrej, deri atëherë kur vdiq Ebu Talibi”.

Sa i përket Hadixhes ajo ishte një mbështetje e fortë e Pejgamberit alejhis-selam, Pejgamberi gjente prehjet shpirtërore te ajo dhe asaj i ankohej nga padrejtësitë që i bëheshin. Lidhur me Hadixhen, Pejgamberi sal-lallahu alejhi veselem, ka thënë: “Ajo më besoj kur njerëzit nuk më besuan, më vërtetoj kur njerëzit më gënjen, më mbështeti me pasurinë e saj, kur njerëzit pasurin e vet më kishin ndaluar, Allahu më dhuroi nga ajo fëmijë kur gratë (e tjera) më kishin ndaluar”.

Vit i dëshpërimit “Amul huzni” në histori islame është quajtur viti kur ka vdekur Ebu Talibi dhe Hadixheja, për atë se Muhamedi alejhis-selam është shqetësuar thellë dhe është pikëlluar shumë për vdekjen e tyre.

Pasi që mekësit e kishin refuzuar Fenë islame dhe kishin shprehur armiqësi ndaj personalitetit të Muhamedit alejhis-selam dhe thirrjes për në rrugë të Allahut xh.sh., i filluan fyerjet dhe maltretimet

fizike ndaj Pejgamberit alejhis-selam dhe muslimanëve. E gjithë kjo bëhej vetëm e vetëm të pengohej përhapja e fesë Islame në popullatën e Mekës.

Me që kushtet dhe rrethanat ishin tejet të vështira për ardhmërinë e Fesë Islame në Mekë, Pejgamberi alejhis-selam filloi të mendoj për ndonjë vend tjetër më të përshtatshëm për përhapjen e Fesë Islame. Prandaj, në Shevval të vitit të dhjetë pas shpalljes së tij për pejgamber, e lëshoj Mekën dhe shkoi në Taif, bashkë me të ishte edhe Zejd b. Harithi. Gjatë rrugës për në Taif fiset e ndryshme, Pejgamberi alejhis-selam i thirrte në Islam, mirëpo nuk arriti të korr sukses dhe u detyrua të ktheht në Mekë. Dalja e Muhamedit alejhis-selam prej Mekës, kishte shkaktuar që idhujtarët kurejsh të shprehin edhe më tepër armiqësi dhe urrejtje ndaj Muhamedit para se ai të lëshoj Mekën dhe të shkoj në Taif.

Në këtë periudhë kohore, Muhamedi alejhis-selam filloi t'ua paraqes Fenë Islame fiseve, por edhe individëve të cilët ia mësynin Mekës për të kryer haxhin ose që vinin për tregti. Transmetime të llojllojshme me senede të ndryshme, theksojnë se Pejgamberi alejhis-selam kishte shkuar te fisi Kinde, te fisi Beni Ka`b, Beni Hudhejfe, Beni Amir b. Sa`sa`ë etj. Por, asnjë prej tyre nuk ishte përgjigjur ftesës së Pejgamberit alejhis-selam. Pejgamberi alejhis-selam nuk kërkonte diç tjetër nga ata, pos që ta mbronin dhe t'i mundësonin vendstrehim, me qëllim që t'i mundësohej përhapja e dërgesës së Zotit, por asnjë prej tyre një gjë të këtillë nuk e pranonte.

Pejgamberi alejhis-selam kur dëgjonte që dikush ka ardhur në Mekë dhe që kishte famë ose që gëzonte respekt te populli i vet, i paraqitej atij dhe ia afronte Fenë Islame. Siç transmeton Xhabir b. Abdullahu r.a. i Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi veselem në kohën e haxhit kërkonte nga ata që vinin të bëjnë haxhin: "A nuk ka ndonjë njeri, i cili më merr te populli i vet ngase kurejshët më kanë pamundësuar mua të bëj përhapjen e fjalës së Zotit tim".

Vazhdon...

Intervistë me imamin e xhamisë "Hëna e re" në Kreuzlingen të Zvicrës rreth referendumit për ndalimin me kushtetutë të ndërtimit të minareve në Zvicër për portalin www.breziiri.com

Referendumi u përkrah nga shumica e votuesve, e jo nga shumica e popullatës

Intervistoi: Mehas Alija

BREZI I RI: I nderuari imam, Rejhan Neziri, dëshirojmë që në fillim t'ju pyesim se si e pritët referendumin zviceran për ndalimin e ndërtimit të minareve, i cili u iniciua nga Partia popullore zvicerane (SVP), dhe e përkrahur nga shumica e popullatës?

Rejhan Neziri: Rezultati i referendumit të 29 nëntorit 2009 i mbajtur këtu në Zvicër ka shokuar jo vetëm muslimanët, porse edhe ndërgjegjen e shëndoshë. Njerëzit e mençur, objektivë e të sigurt në vlerat e tyre ndjehen të zhgënjyer nga mashtrimi kaq i lehtë i një pjese të konsiderueshme të popullatës zvicerane me parullat ofenduese, diskriminuese e shkelëse të partive iniciatore. Këtu, duhet bërë një korrigjim të vogël: këtë iniciativë, nuk e ka përkrahur shumica e popullatës zvicerane, por shumica e votuesve. Vetëm 53.4 % e popullatës së përgjithshme me të drejtë vote kanë përdorur votat e tyre, 46.6 % nuk kanë votuar fare. Ndërsa, 42.5 % kanë votuar kundër. Këto rezultate i jap për të demantuar pohimin se shumica e popullatës zvicerane paskësh qenë kundër minares. Jo, por shumica e votuesve janë shprehur kundër saj. Këtë e them, për të mos e fajësuar pjesën tjetër të popullatës. Ndërkaq, rezultati real është se me këtë referendum u ndalua ndërtimi i mëtejme i minareve në Zvicër.

BREZI I RI: A konsideroni se referendumi ishte një lojë politike?

Rejhan Neziri: Po, një lojë politike, por me konsekuenca të hidhura si për muslimanët, po ashtu edhe për vlerat me të cilat njihet ky shtet. Me këtë rezultat janë habitur edhe vetë iniciatorët, ata nuk e kanë pritur se loja e tyre duke tallur vlerat e muslimanëve dhe duke barazuar Islamit me mostolerancën do të merret aq serioze sa të krijojë ndjenjën e një mostolerance në vetë radhët e tyre e më gjerë.

BREZI I RI: A mendoni, parapraakisht, se kjo nismë do të rezultonte e suksesshme?

“Duhet pranuar fakti i hidhur se muslimanët u inkuadruan relativisht vonë në mënyrë aktive kundër këtyre fajësimeve e akuzave ndaj Islamit, muslimanëve dhe kulteve fetare islame nëpërmjet diskutimeve publike, artikujve e mjeteve të tjera vizuale e të shkruara, hapjen e dymëve të xhamive për vendasit etj.”



Rejhan Neziri: Po, e suksesshme në kuptimi, se ndalimi i ndërtimit të minareve do të refuzohej nga shumica e njerëzve me të drejtë vote. Këtë e ka kërkuar logjika e shëndoshë, vlerat demokratike të këtij shteti dhe rezultatet paraprake të disa sondazheve të realizuara nga Instituti për hulumtime politike dhe shoqërore GFS.BERN (www.gfsbern.ch),

për çka është dëmtuar shumë rëndë edhe besueshmëria e këtij instituti. Pikërisht mendimi apo ndjenja e besimit se kjo nismë antidemokratike dhe diskriminuuese nuk do të kalonte, nuk do të merrte vizë, sot ka krijuar një zhgënjim të madh gjithandej, për çka në forma të ndryshme dhe me propozime të ndryshme janë prononcuar si qeveria ashtu edhe disa parti politike e organizata të ndryshme joqeveritare, e të mos flasim për komunitetin ndërkombëtar.

BREZI I RI: A kishte lëvizje nga qarqe të tjera zvicerane, qoftë parti politike apo organizata të tjera qeveritare dhe joqeveritare, për ta penguar ose për ta zbehur ndikimin e kësaj nisme dhe, nëse po, sa vërehej ajo?

Rejhan Neziri: Po kishte. Qeveria, organizata të ndryshme qeveritare e joqeveritare, kishat katolike dhe evangjeliste, bashkësia e komunitetit hebraik si dhe një gamë e lidhjeve apo organizatave kulmore islame, Këshilli i Religjioneve në Zvicër etj. dolën me ftesën dhe apelet e tyre për të votuar kundër kësaj ndalesë. Por, siç thash, mbase mund të ketë qenë mendimi se edhe ashtu bëhet fjalë për një lojë, për një diskriminim të qartë ndaj komunitetit musliman që nuk përputhej me mendësinë dhe traditën demokratike të këtij vendi, ajo që ka shkaktuar një zvarritje, mosangazhim më efektiv të partive politike e të organizatave të tjera në këtë "garë".

BREZI I RI: Kur jemi te aktivitetet apo lëvizjet, a mund të na thoni diç

në lidhje me atë se cili ishte roli i muslimanëve apo i organizatave muslimane për ta zbardhur dhe shpjeguar sa më shumë faktin se ç'paraqesin minaret për muslimanët, respektivisht, sa u dëgjua zëri musliman në kuptim të zbutjes së situatës?

Rejhan Neziri: Duhet pranuar fakti i hidhur se muslimanët u inkuadruan relativisht vonë në mënyrë aktive kundër këtyre fajësimeve e akuzave ndaj Islamit, muslimanëve dhe kulteve fetare islame nëpërmjet diskutimeve publike, artikujve e mjeteve të tjera vizuale e të shkruara, hapjen e dyerve të xhamive për vendasit etj. Për këtë mund të ketë disa shkaqe: a) besueshmëria naive se popullata vendase nuk do ta përkrahë këtë nismë për ndalesë, b) leximi jo i drejtë ose mos leximi fare i frikës që te kjo popullatë ishte akumuluar si nga ngjarjet në arenën ndërkombëtare që kishin të bënin me muslimanët ashtu edhe nga ngjarjet jo të hijshme të disa muslimanëve në Zvicër që ishin në fakt individuale por që përgjatë kësaj kampanje nga ana e partive përkrahëse të ndalesës u përgjithësuan dhe iu veshën mbarë komunitetit islam, c) xhamitë dhe qendrat islame druanin të mos etiketoheshin për angazhim aktiv në veprimtari politike, ç) shpresa dhe pritja pasive te ana e muslimanëve se me këtë kampanjë duhej të merreshin vetëm ose më shumë zviceranët dhe partitë e tyre politike, sepse përndryshe rrezikohej imazhi demokratik, barazimtar e neutral i shtetit të tyre dhe se me këtë rast në muslimanët do të ishin viktima, ata që duheshim përkëdhelur për

shkelje të të drejtave tona. Pozita e të qenit viktimë, me ose pa të drejtë, me ose pa vetëdije, sikur ka filluar të na hyjë në qejf.

BREZI I RI: Kush mund të jetë fajtor, sipas jush, për këtë rezultat të referendumit?

Rejhan Neziri: S'ka dyshim se fajtorë kryesorë janë nismëtarët e këtij referendumi, partitë politike të cilat e kanë humbur besimin në fuqinë e vlerave të tyre dhe e shohin veten të kërcënuar nga të huajt në përgjithësi dhe muslimanët në veçanti. Ato ndërtimin e minareve e plasuan si simbol të fuqisë politike, se pas kësaj u fshehka dëshira e muslimanëve për ta kapluar qiellin zviceran me minare, u fshehka islamizimi i heshtur i shtetit helvetik, sjellja e shariatit dhe si rrjedhojë krijimi i një shoqërie paralele, se kjo qenkësh simbol i shtypjes së femrës muslimane... të gjitha këto të portretizuara nga një femër me burkë (mbulim i tërë trupit, madje edhe e fytyrës së saj) dhe disa minareve në formë rakete që e shponin flamurin e Zvicrës. Pjesa tjetër e fajit u takon atyre që votuan pro kësaj ndalesë, pastaj partive politike e organizatave të tjera që nuk bënë më shumë në drejtim të shpalosjes së këtyre trukeve politike të ngritura mbi të pavërtetat ose gjysmë të vërtetat rreth Islamit dhe muslimanëve dhe akoma më pastaj, por jo më pak, edhe organizatave e strukturave muslimane, të cilat, siç thash, në fillim e morën këtë punë siç thotë populli "pa sallamak".

BREZI I RI: Ju në një shkrim tuajin, që patëm fatin ta publikojmë



edhe në ueb faqen tonë, shkruanit se me këtë referendum muslimanët janë diskriminuar njëanshëm. Si e shpjegoni këtë?

Rejhan Neziri: Po, me votimin në këtë referendum është shtuar edhe një paragraf i tretë, që nuk ka qenë më parë, tani 72 i kushtetutës së Zvicrës që ka të bëjë me rregullimin e raportit të kishës dhe shtetit (shih: <http://www.admin.ch/ch/e/rs/101/a72.html>) dhe që do të figurojë kështu: **“3. Ndërtimi i minareve është i ndaluar”**. Pra emërtohet objekti islam (minarja) ai që me aktin më të lartë normativ të një vendi siç është kushtetuta shpallet i ndaluar, çka automatikisht me po të njëjtin dokument shpallet i lejuar ndërtimi i kullave të këtilla apo të ngjashme të bashkësive të tjera fetare. Ky është një diskriminim i qartë... Deri para referendumit, lëshimi i lejes për ndërtimin e minareve, ashtu si edhe te tempujt tjerë, varej nga plani urbanistik i komunës gjegjëse.

BREZI I RI: Ju jeni imam në xhaminë e shqiptarëve në qytetin e Kreuzlingenit. Si i vlerësoni marrëdhëniet mes popullatës lokale dhe muslimanëve para referendumit? Dhe, a mendoni se situata pas referendumit mund të sjellë ndonjë acarim të raporteve dhe marrëdhënieve mes zviceranëve dhe muslimanëve të rrethit ku jetoni ju?

Rejhan Neziri: Para referendumit nuk ka pasur manifestim të ndonjë urrejtjeje a mosdurimi të popullatës vendëse të Kreuzlingenit kundërshtues të muslimanëve të këtushëm. Me ftesë të partive iniciuese të referendumit në një qendër kulturore të qytetit tonë një muaj e gjysmë përpara prezantoi një predikues i urrejtjes së çifutëve dhe krishterëve kundër Islamit dhe muslimanëve Avi Lipkin, i cili e zmadhoi dyshimin dhe urrejtjen ndaj Islamit dhe muslimanëve me blasfemi e gënjeshtër vetëm të llojit të tij duke e identifikuar minaren si predikatore të djallit.

(Shih: www.nzz.ch/nachrichten/schweiz/das_minarett_als_teufelskanzel_1.3879664.html).

Të theksoj se Komuniteti hebraik në Zvicër është distancuar nga ligjëratat e Lipkin... Më pas vijoi një diskutim publik me karakter më tepër informues në Shtëpinë e Këshillit të komunës sonë rreth rëndësisë së minares në Islam, pse kjo iniciativë binte ndesh me të drejtat elementare të lirisë së besimit dhe të ushtrimit të tij, pse binte ndesh me normat juridike që e ndalojnë diskriminimin etj. të mbajtur nga një pedagog i Shkollës së Lartë Pedagogjike në Thurgau, diakoni katolik, i deleguari i komunës për integrim dhe unë

si imam. Këto diskutime publike, intervistat për media të ndryshme, hapja e dyerve të xhamisë për të huajt më 7 nëntor '09 ishin disa përpjekje për ta amortizuar gjithë atë mllef që po e mbillnin partitë përkrahëse të ndalesës.

Pas referendumit vërehet një nervozizëm i muslimanëve si dhe një shtim i dozës së dyshimit ndaj popullatës vendëse për shkak të përkrahjes që votuesit e Kreuzlingenit ia dhanë kësaj ndalesë (62 % e kreuzlingenasve kanë votuar pro ndalesës) nga njëra anë, vërehet një zhgënjim dhe përpjekje për shfaqjesim e distancim nga mesazhi që dha ky rezultat i referendumit nga ana tjetër, si dhe vërehet një vetëkënaqje e gëzim i papërmbajtur i ithtarëve të partive fituese të referendumit nga ana e tretë. Kjo vërehet te disa raste individuale kur muslimanët dhe muslimanet janë ofenduar ose edhe sharë me gjepte të pahijshme nga ana e disa banorëve vendas të qytetit...

Megjithëkëtë ne shpresojmë se si nga ana e muslimanëve ashtu edhe nga ana e vendasve, përkrahës të ndalesës, nuk do të eskalojë ndonjë gjest i pahijshëm e radikal, kërcënues për çrënjosjen e besueshmërisë së gjithëmbarshme të banorëve të këtushëm dhe se do të mbisundojë ndërgjegjia e logjika e shëndoshë. Mesazhet për këtë shpresë ne i kemi dhënë bashkë me përfaqësues të kishave katolike e evangjeliste në një gazetë rajonale të Zvicrës, Thurgauer Zeitung.

(shih: <http://www.thurgauerzeitung.ch/thurgau/kanton/Gemeinsames-Gebet-und-Patenschaften/story/23220403>).

Pamje nga dita e dyerve të hapura të xhamisë në Kreuzlingen

BREZI I RI: Zotëri Neziri, si mund të parashikojmë situatën e pas referendumit? A mund të ketë ndonjë shprehje indinjate dhe revolte më të radikalizuara nga ana e muslimanëve?

Rejhan Neziri: Mbase edhe mund të ketë eksplozim të hidhërimit, zhgënjimit e humbjes së besueshmërisë, por këto shpresoj të jenë raste individuale ndoshta edhe të mos ndodhin fare. Deri më tani muslimanët, më mirë thënë organizatat kulmore të muslimanëve, kanë treguar një maturi e zgjuarsi të plotë rreth qëndrimit të tyre kundruall këtij rezultati të referendumit, duke e pranuar si të ligjshëm atë, sepse kështu e parashih sistemi i demokracisë së drejtpërdrejtë i këtij shteti, por edhe duke shprehur indinjatën për të pavërtetat mbi të cilat u ngrah ajo propagandë a fushatë para votimit dhe duke shprehur gatishmërinë e plotë për të punuar më aktivisht në shembjen e paragjyqimeve e të frikës së pavend që zotëron te populli zviceran.

BREZI I RI: E dimë që në Zvicër ekzistojnë për momentin katër xhami me minare. Ç'mendoni, cili do të jetë, tani e tutje, fati i tyre pas vendimit për ndalimin e ndërtimit të mëtutjeshëm të minareve?

Rejhan Neziri: Minaret e ndërtuara deri para referendumit mbeten të paprekura, kurse kërkesat në pritje për marrje të lejes automatikisht do të shpallen si të pavlefshme ose thjesht do të refuzohen, me arsyetimin se bien ndesh me paragrafin 3 të nenit 72 të kushtetutës.

BREZI I RI: Dhe, çfarë ndalesash të tjera, sa i përket objekteve fetare të muslimanëve, përfshihen me këtë ndalesë?

Rejhan Neziri: Nuk ka ndalesë për diçka tjetër, si për shembull për xhami, kubbe apo kupolë të xhamisë, eventualisht shatërvan etj. Kjo ndalesë ka të bëjë vetëm me ndërtimin e minareve, pa marrë parasysh lartësinë e tyre.

BREZI I RI: Sot dëgjojmë zërat, po ashtu nga e njëjta parti, se mund të iniciojnë edhe një referendum në lidhje me ndalimin e bartjes së mbulesës, gjegjësisht shamisë. Sa është e vërtetë kjo?

Rejhan Neziri: Partitë që e iniciuan referendumin për minaren kohëve të fundit janë shprehur se çështja me minaren është vetëm fillimi, se pas kësaj mund të vijë çështja e burkës, çështja e martesës së dhunshme, e gjymtimit gjenital të femrës etj., tema këto që këto parti politike i kanë plasuar dhe përdorur gjatë gjithë fushatës para referendumit. Dy ditë pas referendumit kryetari i partisë CVP, parti kjo që për këtë referendum u deklarua kundër ndalimit, i motivuar nga rezultati i fundit, doli me deklaratën se duhej iniciuar një referendum tjetër për ndalimin e shamisë nëpër shkolla e varrezave të veçanta për pjesëtarët e feve të tjera. Pas kësaj deklarate lidhur me varrezat reagoi komuniteti hebraik, pas çka kryetari i kësaj partie e tërhoqi mendimin e tij për varrezat, ndërsa për shamitë jo. Të presim e shohim.

BREZI I RI: I nderuari Rejhan Neziri, pasi që u përcaktuan që t'ju intervistojmë kryesisht rreth ngjarjeve të fundit që ndodhën në Zvicër, siç qe referendumi për ndalimin e ndërtimit të mëtutjeshëm të minareve, do të donim t'ju pyesnim edhe diç lidhje me planet e muslimanëve për të ardhmen. Si mendoni se mund të përmirësohet ky vendim, tani më i ndalesës për të

vazhduar ndërtimin e xhamive me minare?

Rejhan Neziri: Për korrigjimin e kësaj që ndodhi flitet të ketë disa mundësi: a) Të lihet si e tillë, sepse vetvetiu pas disa vitesh do ta humbasë efektin real, çka nuk duket dhe aq e pjekur, sepse derisa të ekzistojë ai paragraf i nenit 72, në komunat ku sundojnë përkrahësit e ndalesës, kurrë nuk do të hezitojnë të mos e refuzojnë kërkesën për minare duke iu referuar këtij neni, b) një apo disa xhami duhet të shtrojnë kërkesë për minare dhe pasi ajo të refuzohet nga komuna çështja të bartet në gjykatën kushtetuese. Nëse edhe atje refuzohet, atëherë të bartet në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (European Court of Human Rights), ku pritet, sipas ekspertëve zviceranë të së drejtës ndërkombëtare dhe të disa politikanëve, çështja të zgjidhet në favor të lejimit për ndërtimin e minareve...

Muslimanët apo ndonjë xhami a qendër islame nuk ma merr mendja ta bëjnë këtë, sepse kjo përpos kohës kërkon edhe një shumë të madhe të mjeteve financiare, çka u mungon atyre.

Para dy ditësh është deklaruar Club Helvetique – një grup i intelektualëve të famshëm zviceranë – se do të iniciojë një referendum tjetër për ta shmangur këtë paragraf diskriminues për ndalimin e minares dhe për ta zëvendësuar me një tjetër për tolerancë.

BREZI I RI: Cila, sipas jush, duhet të jetë platforma e muslimanëve në Zvicër për t'i realizuar kërkesat dhe të drejtat e tyre si qytetarë me të drejta të barabarta me të tjerët, mendojmë për ardhmen?

Rejhan Neziri: Njëherë duhet të konstatojmë se shumica e muslimanëve të Zvicrës janë me status të përkohshëm juridik në këtë shtet, janë me vizat B ose C. Një pjesë prej tyre kanë fituar nënshtetësinë e Zvicrës kurse një pjesë akoma më e vogël janë muslimanë të konvertuar. Dua të them se organizimi në formë politike thuajse është i pamundur, qoftë edhe të jetë i mundur nuk do të ketë sukses, ngase numri i votuesve muslimanë s'e arrin dot shifrën prej 50 000 banorëve dhe pikëpyetje nëse të gjithë këta do të organizoheshin rreth kësaj partie politike të muslimanëve.

Ajo çka mbetet si reale për t'u bërë është organizimi nëpër liga ose organizata ombrellë, siç janë disa prej tyre, dhe nëpër komitetet të tjera të përhershme ose të përkohshme, të cilat do të gjenin rrugët për të demantuar fajësimet e pavend, të korrigjimin e të shembnin paragjykimet e frikën rreth Islamit dhe muslimanëve të këtushëm me anë të mjeteve të ndryshme legjitime, të motivonin integrimin (jo asimilimin) e shëndoshë të muslimanëve në shoqërinë zvicerane e të kontribuonin në ndërtimin e mëtejshëm të përbashkët të kësaj shoqërie.

BREZI I RI: Në fund, mesazhi juaj për lexuesit e portalit "Breziiri.com".

Rejhan Neziri: Unë ju uroj juve si portal punë të mbarë në sqarimin e drejtë të Islamit, duke përcjellë porosinë humane të tij te mbarë njerëzia, kurse lexuesve tuaj të jenë konsekuente në ndjekjen e trendëve që u paraprinë ky portal me stafin e tij, duke kontribuar në mënyrë kritike e të shëndoshë në avancimin e mëtejshëm të tij. Ju faleminderit. Ves-selamu alejkum!

BREZI I RI: Ju faleminderit edhe juve që ndatë kohë për intervistën tonë. Ve alejkum selam!



Zvicra - kjo çokollatë e hidhur!

“E vërteta erdhi me referendumin – muslimanët e Zvicrës tani e dinë ku gjenden dhe më kë kanë punë, dhe mu për këtë në të ardhmen do ta kenë shumë lehtë, edhe pse tani, të mos gënjehemi, e kanë shumë të vështirë, sepse më së keqi është të jetosh me dyfytirëshit, kurse Evropa është e mbushur me të tillë.”

Aziz K.

Referendumi zviceran i mbajtur në ditën e tretë të Kurban Bajramit, ku populli zviceran votoi kundër ndërtimit të minareve (57,5 %), ishte shokuese për të gjithë ata që kanë qasje në këtë temë apo në këtë problem, duke filluar nga Unioni Evropian, Turqia vendet arabe, por edhe deri te Vatikani, të cilët, përveç shokut fillestar, treguan edhe brengosjen e thellë për pasojat e këtij akti.

Kurse, të mos flasim për brengosjen dhe dëshpërimin e muslimanëve të këtyre hapësirave, kur dihet se prej 500.000 muslimanëve që jetojnë në Zvicër shumica janë

prej Ballkanit, të cilët kanë shkuar për një jetë më të mirë në këtë “shtet miqësor dhe tolerant”.

Muslimanët tanë në Zvicër si një “vend i premtuar” ikën prej rrënuesve të xhamive dhe minareve (këtu është fjala për rrënuesit e minareve në Kosovë, Bosnjë dhe në Maqedoni. sh.p.), kurse tani ata arritën në një gjendje ku zviceranët tolerantë, duhet ta pranojmë, në mënyrë shumë demokratike (referendumi është shprehja më e madhe e demokracisë) t’u thonë atë që u thonin serbët deri sa i vritnin, i dëbonin dhe ua rrënonin objektet dhe simbolet e fesë së tyre – minaret dhe xhamitë: “Minaret janë hapi i parë drejt Shtetit Islam”, janë fjalët e një

deputeti parlamentar **Ulrich Schuler**, me një sqarim të mëtutjeshëm: “Minaret nuk janë simbole religjioze, por simbol politik me të cilin Zvicrës dëshirojnë t’ia imponojnë shariatit, i cili është në kundërshtim të plotë me ligjet demokratike tradicionale zvicerane.” A thua vallë nuk janë këto fjalë të ngjashme me ato të Miloshoviçit dhe udhëheqësve tjerë jugosllav që në “emër të krishterimit” e “mbrojnë Evropën nga Islami”?!

TË SHIHET REFERENDUMI ME NJË SY TJETËR

Më e keqja është se derisa në rastet e tjera ishin qeveritë

iniciatore apo lëvizëse të ideve raciste dhe ksenofobike, këtu është fjala për popullin! Qeverinë mund ta ndërroni, zgjedhjet janë në çdo katër vjet, por vallë ç’ të bëjmë me popullin?!

Por, derisa nga Evropa vijnë reagime dhe propozime të reja, mes të cilave edhe ajo që vendet arabe dhe islame duhet t’i tërheqin paratë e tyre prej bankave zvicerane dhe të ngrijnë bashkëpunimin ekonomik me këtë shtet, mendimi ynë është që këtë referendum ta shikojmë nga një aspekt tjetër, që ndoshta nëpërmjet kësaj ti hapim sytë, gjë që faktet tregojnë se ndoshta i kemi pasur gjysmë të hapur apo në rastin më të keq kemi mbajtur syze të shëmtuara.



A thua vallë ka dëshpërim më të madh kur ne si individ pas një periudhe të gjatë të vërtetojmë (në lëkurën tonë) se njerëzit të cilët me vite i konsideronim miq, në fakt paskan qenë armiq të fshehur të cilët vetëm kishin pritur rastin të tregojnë se çka dhe kush janë?! A thua vallë gjatë agresionit ndaj muslimanëve në Ballkan nuk kemi parë raste e raste kur miqtë dhe fqinjët e djeshëm me të cilët hanim dhe pinim, për një natë u bënë vrasësit dhe dhunuesit tanë?! Kjo na është përsëritur shumë herë, por ja që nuk po marrim mësim! Në fakt, ç'dëshiroj të them?

Dëshiroj të them se njëherë e përgjithmonë gjërat duhet thënë troç! Mjaft i mbajtëm duart në dorëza. Vite të tëra ballafaqohemi me çështje të ndryshme politike: nga ajo se a ka apo nuk ka islamofobi në Evropë, urrehen muslimanët apo jo, janë terroristë apo nuk janë! Mund të mbulohen apo nuk mund! Të drejtat e njeriut janë kështu apo ashtu, mund të ndërtojmë apo nuk mund të ndërtojmë xhami, Papa është apo nuk është kundër të Dërguarit s.a.v.s, e deri te karikaturat e të Dërguarit, protesta, vrasjet, shkatërrimi i xhamive etj. Kurse muslimanët sikur kuajt e stërvitur: së pari i ofendojnë aq sa mundin, ua ndytin gjëra e shenjtat e tyre, kurse më pas i përkëdhelin me frazat mbi demokracinë, të drejtat e njeriut, të drejtat fetare, liritë... dhe, më në fund, i ftojnë për dialog!

NUK KE ÇKA BËN, DEMOKRACI ËSHTE KJO!

Dhe mu për këtë zviceranët meritojnë vëmendjen, pse jo, edhe përgëzimet: Përfundimisht i thanë mjaftë këtij rrethi të mashtrimeve, gënjeshtreve, aferave, dyfytësive, dhe në mënyrë shumë të qartë dhe demokratike – me referendum thanë: Nuk ju duam, ju urrejmë, nuk ju dëshirojmë. Është e vërtetë se na duheni për hapjen e kanaleve dhe kanalizimeve, për kryerjen e punëve më të pista, kurse në këtë aspekt jeni punëtorë të mirë, por ju dëshironi shumë e më shumë, doni të drejtat tuaja,

fenë tuaj, xhamitë dhe minaret tuaja, kurse kjo sipas ligjeve tradicionale zvicerane nuk mundet!

Deri sa ishit nën tokë, nëpër podrume, kanale, magazinat e hershme, në shoqëri me minjtë, pra deri sa ishit të padukshëm, gjithçka ishte në rregull, por kur dolët prej kanaleve, kur u pasuruan dhe filluat të blini ndërtesa dhe të ndërtoni xhami



dhe mesxhide dhe të fluturonin drejt qiellit, atëherë kjo tejkaloi çdo kufij. A mos ndoshta dëshironi që Zvicra të bëhet xhamihane! Po, është e vërtetë, kjo është ksenofobi, racizëm, fashizëm, por as që jemi të parët dhe gjithsesi nuk jemi as të vetmit që ushqejmë këto ndjenja ndaj islamit dhe muslimanëve. Në Evropë ka shumë, shihni Hollanda përgatitet të shkoj rrugës sonë, Danimarka njëjtë, por ende s'kanë forcë dhe guxim që në

mënyrë të hapur të thon: Evropa është e krishterë. Por goditjet e tyre i japin nëpërmjet terrorizmit dhe izmave të ngjashëm!

Kështu foli Evropa nëpërmjet gojës zvicerane. Gojë e zbukuruar me çokollatë të “ëmbël”. Nëpërmjet vendit ku muslimanët ishin më të integruar, dhe ku në këtë aspekt nuk kishte asnjë

politikanët zviceran e ushqenin një atmosferë të tillë, por kur më e vërteta doli në shesh, goditja sa do qoftë e rëndë dhe sa do paradoksale të duket, duhet të kalohet lehtësisht.

E vërteta erdhi me referendumin – muslimanët e Zvicrës tani e dinë ku gjenden dhe më kë kanë punë, dhe mu për këtë në të ardhmen do ta kenë shumë lehtë, edhe pse tani, të mos gënjelemi, e kanë shumë të vështirë, sepse më së keqi është të jetosh me dyfytësishit, kurse Evropa është e mbushur me të tillë. Gjithsesi, nuk është lehtë një hapje e syve papritmas. Lajmi se shumë të njohur, miq, fqinj të cilët kanë qenë shumë të sjellshëm me ta, atë mëngjes Bajrami shpejtonin që në mënyrë shumë specifike t'iu dërgojnë urimet fqinjëve musliman, që në kuti të vendosin JO-në ndaj minareve dhe kështu këto ditë të bekuara të Bajramit, ditë të gëzimit dhe haresë, të qetësisë dhe harmonisë familjare të errësohen para akshamit.

Edhe pse sot gati nuk ekziston medium në Evropë që nuk e komenton ngjarjen e Bajramit, kryesisht duke e gjykuar, apo duke pasur një qëndrim më të rezervuar, një gjë është e qartë: Frika e zviceranëve nuk vjen nga minaret, prej tyre edhe ashtu nuk dëgjohet ezani, por në pyetje është frika nga **ideja (misioni)**, gjegjësisht nga **Mesazhi Hyjnorë**.

Ndërsa kësaj **idejenë** një rast të këtillë, minaret edhe nuk i duhen, ajo do të gjejë rrugën deri te zemrat e njerëzve, pa marrë parasysh gjithë sfidat e kësaj bote.

P.S. Se zviceranët “dita ditës po përparojnë edhe më shumë” tregon edhe iniciativa më e re e Partisë Popullore Demokristiane. Lideri i saj Cristophe Darbellay kërkoi që të mos ketë varreza të veçanta për muslimanët dhe hebrejtë, edhe atë vetëm disa ditë pas referendumit për të cilin e patëm fjalën! Si duket kryqtarët gjithnjë e më shumë veprojnë në mënyrë demokratike!

Shqipëroi: A.D.

"Zoti ynë bëne të sotmen tone më të mire se të djeshmen, ndërsa të nesërmen tone më të mire se të sotmen".

MBI VLERËN E KOHËS

MOS E SHANI KOHËN

SHABAN TAIRI viti i IV

Në këtë temë do të mundohemi të hedhim pak dritë mbi një hadith të Pejgamberit a.s. në të cilin ndalohen njerëzit që të shajnë kohën, se me sharjen e kohës, njëkohësisht ne shajmë Zotin. Por problematika mbi këtë hadith del kur këtë hadith marrin ta interpretojnë armiqtë e Islamit të cilët duan vetëm t'i ngatërrojnë kuptimet e vërteta, të cilët thonë se hadithi, e sjell në një rang kohën me Allahun xh.sh.! Në fillim të sjellim hadithin, i cili transmetohet nga Ebu Hurejra r.a. se Pejgamberi a.s. ka thënë:

"Mos e shani kohën, se me të vërtetë Allahu është koha";

Ky hadith gjendet në: - Sahih-un e Buhari-ut, kitabu`l Edebi, bab: la tesubbud-dehre, 5713; -Sahihu`l Muslim, kitabu el-Elfadhu mine`l edebi ve gajriha; 4170; -Musnedu`l Imam Ahmed, 9972, 21601; -Sunen ebi Davud, kitabu`l edebi; bab: fi rexlulin je subbu-dehre, 4590.

Ky Hadith shumë është marrë nga armiqtë tanë dhe është interpretuar se Zoti është koha, se koha është e barabartë dhe e vjetër me Zotin, se koha nuk është e krijuar, siç pandehnin natyralistët dhe filozofët.

Por vallë, si duhet muslimani ta kuptoj këtë hadith? Ky hadith bën pjesë

“Nëse fillimi i kohës është në konkurrencë me atë të universit, sipas teoremës së hapësirës, atëherë shkaku i krijimit të universit duhet të jetë ndonjë Qenie që vepron me një dimension kohor plotësisht të pavarur nga dimensionin kohor i kozmosit edhe që ka ekzistuar para tij, ky konkluzion na tregon se Zoti nuk është vetë universi dhe nuk është pjesë përbërëse e tij”. - astrofizikani i njohur Hugh Ross



në hadithet Muteshabiha (të dy kuptimta) dhe nuk lejohet të komentohet, sepse është e pamundshme që të definohet saktësisht qëllimi i tij; pasi hadithi është me kuptim metaforik e nuk mund të kuptohet direkt nga teksti por duhet të shikohet qëllimi. Dhe duhet theksuar se hadithet e Pejgamberit a.s. nuk duhet përkthyer tekstualisht sidomos kur ka të bëjë me tekstet muteshabiha. Pra, përkthimi kuptimor i hadithit është “mos e shani kohën se unë jam Krijuesi i kohës”. Nuk mund të themi se koha është sikur Zoti apo të jetë zot, pasi Zoti është pa fillim dhe pa mbarim, ndërsa koha ka fillimin e vet. Zoti është krijues i kohës, kurse koha është e krijuar dhe nuk është e krijuar vetvetiu. Apo të themi se Zoti është i barabartë me kohën dhe Zotin e përfshin koha, që del se Zoti është i krijuar siç është koha e krijuar, gjë që është e pamundur. Këto komente dhe interpretime janë nga ata që nuk e kanë kuptuar Qenien e Zotit.

Po ashtu, Buhari-u dhe Muslim-i transmetojnë prej Ebu Hurejres se i dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë: *"Allahu i Madhërishtëm thotë: Biri i Ademit më fyen kur e shan kohën, e në fakt Unë jam koha, e ndërroj natën dhe ditën"*. Kuptimi i këtij hadithi është se injorantët në kohën e injorancës thoshin: Qoftë e mbrapshtë koha, na u bë kjo e

SHTOJCË INFORMATIVE DHE KULTURORE E STUDENTËVE TË FAKULTETIT TË SHKENCAVE ISLAME

kjo. Pra, veprat e Allahut të Madhërishëm ia veshin kohës dhe e shajnë atë. Ndërkaq, realisht këto gjëra i bën Allahu xh.sh.. Për këtë, u ndalua sharja e kohës. Kështu e ka komentuar këtë hadith Ibn Kethiri në tefsirin e tij. Kurse sipas imam Nevevi-ut thotë se ky hadith ka kuptim alegorik dhe shkaku i tij është se arabët e kanë pasur shprehi që të fyejnë kohën në raste mjerimi, fatkeqësie dhe nga ndodhitë e këqija që ju kanë ndodhur, si humbja e pasurisë, pleqëria apo vdekja, e në këso raste thoshin: “Oj koha e mjerë!”, e pastaj është thënë ky hadith për tu tërhequr vërejtjen, që mos e shani Krijuesin e fatkeqësive, pra, mos e shani kohën. Sipas Shafii-ut dhe Ebu Ubejdes kur arabët e shanin kohën, ata kanë sharë Krijuesin e asaj kohe, pra nuk janë pajtuar me Kaderin e Zotit, sepse bërësi i fatkeqësisë është Allahu e nuk është koha, e për këtë e ka ndaluar sharjen e kohës.

KUPTIMI I TERMIT “DEHËR-KOHË”

“Ed-dehru” d.m.th. kohë, epokë, periudhë, i përhershëm, i amshuar. Fjala Dehru në Kuran përmendet 2 herë (në suren Xhathije, 24 dhe Insan, 1). Disa komentues kanë deklaruar se emri “dehr” i cekur në hadith është një ndër emrat e Zotit prandaj thotë mos e shani kohën se “ed-Dehru” jam Unë, kurse sipas komentit të imam Muslimit “Dehru” nuk është nga emrat e Zotit. Emrat e Allahut janë të gjithë të bukur, sepse përmbajnë domethënie të përkryera, bëhet e ditur që (□□□□□ – Ed-dehru) “koha”, nuk është prej emrave të Allahut. Kjo fjalë (koha) nuk përmban domethënie të bukur dhe të përkryer që të jetë prej emrave të Allahut dhe sepse “Ed-dehru” është emër i kohës, koha është e krijuar, ajo është – ”kalimi i ditëve dhe i netëve”. Allahu xh.sh. thotë në Kur’an për mohuesit e ringjalljes: **“Ata thanë se kjo nuk është gjë tjetër vetëm se jetë e kësaj bote, vdesim e ngjallemi dhe nuk na shkatërron (zhduk) vetëm se (Ed-dehru) koha.”** Këtu bëhet fjalë se shkatërruese është “ed-dehru” e cila është: “kalimi i ditëve dhe i netëve”. Ndaj –“Ed-dehru” (koha), nuk ka ndonjë domethënie të bukur, të përkryer që të jetë emër prej emrave të bukur të Allahut. Për sa i përket hadithit të Profeti s.a.v.s, ku thuhet se Allahu i Lartësuar ka thënë: **“Më bën keq Mua biri i Ademit (më shan, nuk më lartëson, pastron, dëlirëson nga të metat), ai e shan kohën kur Unë jam koha. Në dorën time është komandimi**

dhe rregullimi i çështjeve. Unë bëj ndryshimin e natës dhe të ditës.”

Ky hadith nuk tregon se koha është prej emrave të Allahut. Ajo që shanin disa nga bijtë e Ademit, është; “koha në të cilën ndodhin ngjarje të ndryshme dhe e cila përbëhet nga kalimi i ditës dhe i natës”. Të gjitha këto janë të krijuara prandaj fjala e Allahut në hadith “...Unë jam koha...” - është shpjeguar me fjalët që kanë ardhur pas saj - **“...në dorën time është komandimi dhe rregullimi i çështjeve, Unë bëj ndryshimin e natës dhe të ditës.”**. Allahu me fjalën “koha ed-dehru” ka pasur për qëllim; “ Unë jam krijuesi i kohës, bëj ndryshimin e ditës dhe të natës.”. Në hadith, koha është përshkruar si diçka që ndryshon dhe rrotullohet. Allahu nuk mund të jetë Ai që ndryshon dhe rrotullohet, por Ai që bën ndryshimin dhe rrotullimin. Të gjitha këto fakte, tregojnë se koha nuk është prej emrave të bukur të Allahut.

KOHA

Allahu xh.sh. është një Qenie që ka krijuar edhe materien edhe kohën, por në të njëjtën kohë është i pavarur prej të dyjave; astrofizikani i njohur Hugh Ross thotë: “Nëse fillimi i kohës është në konkurrencë me atë të universit, sipas teoremës së hapësirës, atëherë shkaku i krijimit të universit duhet të jetë ndonjë Qenie që vepron me një dimension kohor plotësisht të pavarur nga dimension i kohës i kozmosit edhe që ka ekzistuar para tij, ky konkluzion na tregon se Zoti nuk është vetë universi dhe nuk është pjesë përbërëse e tij”.

Por, koha ka një cilësi të ngjashme me Zotin, e ajo është se është e pamundshme të kuptohet se çka është koha, është diçka për të cilën nuk ka vend mendja e njeriut, dhe se në shikim të parë koha duket si pa fillim dhe pa mbarim; Koha është çështje e ndërlikuar për të cilën njeriu nuk ka aftësi të arrin të kuptoj se çka është koha, njeriu të vetmen gjë që ka arrit rreth kohës është matja e saj, pra zbulimi i orës, kurse më andej nuk ka mundur të hulumtojë mendja e njeriut.

Allahu xh.sh. çdo kund në kur’an kur është betuar, është betuar në diçka që ka shumë vlerë, e një ndër ato betime në të cilat betohet Zoti është koha, kjo është sureja el-Asr në ajetin e parë. Koha nuk duhet të shahet nga vlera e madhe që ia ka dhënë Zoti, sepse Zoti nuk toleron asnjë krijesë të shahet, e leje më ato në të cilat është betuar Zoti. Apo është sikur ti betohesh në diçka, e dikush e shanë atë në të cilin betohesh.



SHARJA E KOHËS

Koha është e krijuar nga Allahu, e si krijesë e Zotit, nënkuptohet që nuk duhet të shahet pa marrë parasysh se çfarë krijesë bëhet fjalë, siç thotë një fjalë e urtë: “respektoje krijesën për hir të Krijuesit”, pasi sharja e kohës nënkupton sharje indirekte të Zotit, kur e shan krijesën e Zotit, e shan Krijuesin, nëse dikujt ia ofendon veprën, e ke ofenduar autorin. Allahu xh.sh. e ndaloj sharjen në tërësi, e kur njeriu shahet, ai do të shaj ndonjë krijesë, e Zoti nuk do që ti shahet krijesa, por pasi nuk i cek që të gjitha krijesat mos shahen, e ka zgjedhur kohën për vlerën e madhe që ka dhe Zoti thirret nëpërmes saj se Unë jam Koha.

Pra, nëse shahet koha duke pasur për qëllim sharjen e krijuesit të kohës, është shirk, por nëse e shajmë kohën duke mos pasur qëllim Zotin, edhe kjo është haram pasi besimtari duhet të bëjë durim, e nëse vetëm themi oh, kohë e nxehtë apo kohë shumë ftohtë, me këtë nuk gabojmë asgjë.

Mos e shani kohën, se të shahët koha është sikur të shash kaderin (përcaktimin) e Zotit, pasi njeriu shan diçka apo e shanë kohën kur nuk është i kënaqur nga diçka që e ka goditur, kjo faktikisht është mospajtim me kaderin, pra, ka lidhje të ngushtë me kaderin e Zotit.

DEHRIJUNËT

Sipas disa dijetarëve thuhet se ky hadith aludon në atë që mos shahet koha sepse ka njerëz të cilët e adhurojnë kohën siç janë Dehrijunët apo natyralistët, e nëse ju e shani kohën, atëherë edhe ata do t'ua shajnë juve Zotin tuaj, prandaj nuk lejohet, duke u bazuar në ajetin: **“Ju mos ua shani ata (zota) që u luten (idhujtarët) pos Allahut, e (si hakmarrje) të fyejnë Allahun nga armiqësia, duke mos ditur (për madhërinë e Tij)... (En-am; 108).** Pasi ata e kanë ngritur kohën në nivelin e Zotit, kur ata me gojë e tyre deklarorin se: **“Nuk na shkatërron asgjë pos kohës”** (Xhathije, 24), ata thonë se pasi nuk ka Zot, e koha është zoti i vetëm i cili na zhduk.

KOHA SI KRIJESË E ZOTIT

Allahu xh.sh. kur e krijoi kohën, edhe atë ia atribuoi Vetes, nuk toleroi që dikush ta shajë atë, por assesi nuk nënkuptohet se koha si krijesë është e barabartë me Të, pasi në shumë vende në Kuran, hasim në ajete, që aludojnë në nxitjen e besimtarit për ndonjë vepër, por në fakt jo se Zoti është i varur nga ajo vepër apo krijesë. Siç është p.sh. ajeti: **“O**

besimtarë, nëse ju ndihmoni Allahun, Ai u ndihmon juve...” (Muhamed:7). Këtu jo se Zoti kërkon ndihmë nga besimtarët, por i nxit që ta mbrojnë fenë e Allahut xh.sh. Apo siç është hadithi i Pejgamberit s.a.v.s. ku interpreton fjalët e Zotit: **“Unë isha i uritur e ti nuk më ushqeve!** Njeriu thotë: po si të ushqej kur Ti je Zoti i botërave....**Unë isha i sëmurë e ti nuk më vizitove...”** etj, fjalë të ngjashme me këto, pra, jo se Zoti ka nevojë, por pjesa e cila i referohet diçkaje, tregon Zoti se ai send ka vlerë, si ndihma ndaj besimtarëve, ndihma ndaj fesë, dhënia ujë udhëtarit, vizita e të sëmurëve, të ushqyerit varfanjakët, pra, Zoti i përshkruan sikur njeriu është duke ia bërë të mirën direkt Zotit edhe pse ai ia bën të mirën njerëzve, pra, edhe koha ka një vlerë të veçantë të Allahut, prandaj edhe Zoti thirret me të. Kur te njerëzit e përparuar vlerësohet aq shumë që mos humbin as një sekondë, atëherë edhe ma shumë e vlerësojnë kohën si tërësi e jo më ta shajnë. Raste të tjera në kuran kemi edhe shumë si p.sh. xhamisë apo Qabes i thuhet Bejtullah (shtëpia e Zotit) jo se Zoti ka nevojë për shtëpi, (Haxhxh;26) apo se Ai rri dhe jeton në xhami, por nga vlera që ka, Zoti e ka emërtuar ashtu, po ashtu thotë: **“E Pejgamberi atyre u pat thënë: “Kini kujdes devenë e All-llahut (Nakatallahi)...”** (Shems 13), pra, deveja është deve, por nga vlera që ka, është quajtur Deveja e Zotit, “Ibadallah” (rob të Zotit) (Safat 40); “Resulullah” (I Dërguari i Allahut) (Ahzab 40), apo “Ruhilah” (Jusuf 87), fjala “jukridullahe” në (Bekare 245), ose në “juharibunallahe” (Maide 33); “Ardullah” – toka e Zotit (A`raf, 73), e shumë ajete të tjera, ku në to tregohet vlera e madhe që ka e jo se Zoti ka nevojë për të. Ky hadith i Pejgamberit a.s. është ngushtë i lidhur me besimin e muslimanit, duhet theksuar se kjo ka të bëjë me akiden (me themelet e besimit Islam) dhe assesi nuk guxojmë që Allahun Fuqiptotë ta cilësojmë me atë se është kohë apo se ai është i barabartë me të, se kjo kundërshtohet me fillet dhe normat e pakontestueshme të besimit Islamit. Por njerëzit në bisedat e tyre të përditshme e përdorin një formulim të fjalëve të tilla, ku edhe shpesh thonë se koha e keqe ka ardhur, apo koha është ashtu, do të thotë shumë gjëra që ndodhin nuk ia atribuojnë Allahut por kohës, dhe Allahu i Madhërisëm thotë se nuk ka koha fuqi të bën diçka, por Unë jam Ai që bëjë, pra Unë e kam dhënë kohën, Unë jam koha, nëpërmjet shfrytëzimit të kohës në vepra të mira, arrin tek Unë. Pra, nëse e shfrytëzojmë kohën si duhet, do të arrijmë në mëshirën e Allahut xh.sh.

Keqinterpretimi i hadithit shkak i përçarjes së muslimanëve (2)

“Dhe kush bën shpifje ndaj meje (më bën gënjeshtar) vendqëndrimi i tij nështë zjarri” (Mutefekun Alejhi)

Semi AJETI viti i IV

SHKAQET E KEQINTERPRETIMIT

Shkaqet që kanë ndikuar në keqinterpretimin e haditheve janë të shumta, prandaj disa më të rëndësishmet do t'i theksojmë në vazhdim:

Urrejtja ndaj fesë Islame: Kohëve të fundit urrejtja ndaj Islamit dhe luftimi i saj

është përhapur në çdo skaj të botës. Komentet jo të përshtatshme për të Dërguarin dhe shpifje ndaj tij, nxjerrja e ajeteve dhe haditheve nga konteksti i tyre për të sulmuar Islamit, pohimet se sulmet terroriste nuk janë dukuri të izoluar brenda muslimanëve por janë dukuri që përhapen dhe që arsyetohet me argumente fetare. Pretendimet se Islami është shkak për moszhvillimin e muslimanëve dhe se ai ndeshet me shkencat natyrore dhe teknike, janë vetëm disa nga akuzimet që i bëhen islamit.

Në bazë të kësaj shpifin se islami është përhapur më forcën e shpatës dhe jo me forcën e argumenteve bindëse apo në sajë të mësimave dhe vlerave të tij. Duhet thënë se për fat të keq, ky trillim ka ndikuar shumë te jomuslimanët të cilët në mënyrë naive mendojnë se islami nuk mund të kishte miliona ithtarë nëpër botë sikur mos të ishte përhapur me anë të forcës dhe nën

kërcënimit e dhunës. Por fakti është se arsyeja e vërtetë pse islami u përhap me shpejtësi nëpër botë dhe me ndihmën e Zotit, ende vazhdon të përhapet është forca e së vërtetës dhe logjikës të cilat janë të mishëruara në parimet e tij, siç thotë Ahmed Didad është e vërtetë se islami është përhapur me shpatë, por me shpatën e intelektit. Islami përqafohet nga ithtarë të rinj çdo ditë dhe kryesisht nga radhët e intelektualëve, dhe kjo ndodh përkundër faktit se bota islame ndodhet në një situatë jo të mirë. Çdo musliman e din se fjala islam rrjedh nga rrënja e fjalës salam që në arabisht do të thotë paqë. Islam do të thotë nënshtrim i vetëdijshëm dhe me dëshirë ndaj vullnetit të Zotit.

Islami është fe e paqes, të cilën besimtari e përqafohet vetëm atëherë kur i nënshtrohet ligjeve të Krijuesit të plotfuqishëm. Një analizë: muslimanët sunduan në Spanjë rreth 800 vjet. Gjatë kësaj kohe nuk ka të dhëna për ushtrim dhune ndaj popullsisë vendase në mënyrë që t'i detyrojë ata të konvertojnë në islam. Në islam ekziston parimi i lirisë së fesë e cila është e garantuar. Në Kur'an thuhet: **“Nuk ka dhunë në fe...”** (Bekare 256)

Një tjetër argument i fortë kundër shpifjes se islami u përhap me dhunë, është fakti se pavarësisht se muslimanët sundojnë në Arabi prej 1400 vjetësh, deri më sot ekzistojnë atje komunitete të mëdha krishterësh arabë, si në Siri, Palestinë, Sudan dhe Egjipt.

Nëse muslimanët do ta kishin përhapur islamit me dhunë s'do të kishte ngelur krishteri arab. Muslimanët u përhapën edhe në Indi dhe qëndruan atje gati 1000 vjet. Në sajë të fuqisë ushtarake që dispononin muslimanët e atëherësh mund ta kishin detyruar çdo indian jomusliman ta pranonte islamit me dhunë. Por kjo nuk ndodhi. Aktualisht në Indi 80% e popullsisë përbëhet nga ithtarë të feve të tjera. Të gjithë këta jomuslimanë janë dëshmi e fortë dhe e gjallë se Islami nuk është përhapur me dhunë.

GRINDJA DHE POLEMIKA MES MUSLIMANËVE.

Thotë Pejgamberi [salallahu alejhi ve selem]: *“Nuk ka humbur ndonjë popull pas udhëzimit që ka qenë në të, vetëm pasi janë dhënë pas dialogut e polemikës”* pastaj ka vijuar me leximin e këtij ajeti: **“Ata nuk ta thanë atë vetëm si polemikë, por ata janë njerëz ngatërrestarë”** (Zuhruf 58)

Imam Maliku thotë: “Polemika e ashpëron dhe forcon zemrën dhe bën që të lindin në të urrejtjet dhe inatet”. Ndërsa Ibni Rexhebi thotë: “Prej gjërave që i kanë përbuzur dijetarët e të parëve tanë është dialogu, kundërshtimet dhe gjithashtu polemika në çështjet e hallallit dhe të haramit. Një gjë e tillë nuk ka qenë rruga e prijësve, dijetarëve të islamit, por u shpikë më vonë pas tyre”. Disa

nga selefët kanë thënë: “Kur Allahu ia do të mirën një robi ia hap dyert e punës dhe ia mbyll derën e polemikës e kur Allahu s.t ia do një robi të keqen, ia mbyll dyert e punës dhe i hap atij derën e polemikës”. Sot fatkeqësisht



shohim se muslimanët janë dhënë me të madhe pas debatit. Çështjet si a të mbahet ora në dorë të djathtë apo në të majtë, a duhet të mbahen pantallonat e gjata a po tëshkurtohen etj janë bërë pothuajse primare te disa musliman.

Në këtë pikë do të cekim disa hadithe që keqinterpretohen si rezultat i grindjeve dhe polemikave në mes muslimanëve.

Hadithi i Pejgamberit [sal-lallahu alejhi ve selem]. ku thotë: *“Dallohuni nga idhujtarët*

lëshoni mjekrat dhe shkurtoni mustaqet!”Nga keqinterpretimi i këtij hadithi nxiret se lëshimi i mjekrës është e obliguar dhe ruajta e mjekrës është ndryshim i krijimit të Allahut, se ai i cili nuk ka mjekër nuk mund të hyjë në xhenet?!

Nëse shohim hadithet e Pejgamberit [sal-lallahu alejhi ve selem]. të kësaj natyre, si p.sh. *“dallohuni nga këta duke bërë këtë”*, kemi shumë hadithe, të cilat një herrit nuk janë të obligueshme edhe pse është i njëjti tekst, p.sh: *“Dallimi mes agjërimit tonë dhe agjërimit të ithtarëve të librit (Krishterët dhe Jehudët) është ngrënia e syfyrit.”* (Transmeton: Muslimi; 1096, Ebu Davudi; 2343, dhe Hakimi; 1\431) A thua në bazë të këtij hadithi ka ndonjë dijetar i cili thotë se të hash syfyri është obligim; agjërimi është obligim ndërsa syfyri është sunet. Pra nuk duhet hadithet të miren shablon dhe të nxiren dispozita pa u analizuar mirë.

Hadithi i Pejgamberit [sal-lallahu alejhi ve selem]: *“Bëni (o ju gra) tespih, tehllil dhe takdis dhe mos jini*

shpërfillëse qe ta harroni tevhidin! Dhe numëroni me gishtërinjtë tuaj, sepse do te pyeten (edhe gishtërinjtë) dhe ato do të përgjigjen!” (Transmeton: Ibn Ebi Shejbe, Ebu Davudi, Et-Tirmidhi dhe El-Hakimi)

Në bazë të këtij hadihti mundohet që të ndalohej përdorimi i tespiheve, ku disa injorant duke u bazuar në mendjen e tyre të kufizuar shkojnë deri në atë saqë i hedhin tespihet prej xhamive gjë e cila ngjall fitne në mesin e besimtarëve. Pejgamberi a.s plot njëzet e tre vjet thirri në islam dhe nuk urdhëroi që menjëherë të hiqen putat nga Qabja e cila ishte e mbushur me idhuj nga frika e fitnes. Ne mund të themi se ky hadith nuk është kuptuar sa duhet apo është nxjerr nga konotacioni i vet, ngase as ky hadith e as hadithet tjera të ngjajshme nuk argumenton se është e ndaluar të përdoren tespihet.

Kemi shumë transmetime që lejojnë përdorimin e tespiheve. Transmetohet se Ebu Safijjes, r.a. shërbëtorit të Dërguarit të Allahut, s.a.v.s., iu soll tepih nga lëkura dhe ene me gurrëz të imët me te cilët bëri tespih gjerë në drekë, dhe pastaj tespihet dhe enën ia hoqën. Ndërsa, kur Ebu Safijja, r.a., e fali namazin e iqindisë, përsëri ia kthyen ato dhe ai bëri tespihe me to gjerë në aksham. (El-Begavi, Mu'xhemu's-Sahabe; Ibn Asakir, Tarih.Ibn Ebi Shejbe në Musannafin e tij), nga shërbëtori i Sa'dit, transmeton se Sa'd ibn ebi Vekkas ka bërë tespih me guralecë ose me koci prej hurmave. Pra, një sahabij i madh dhe i famshëm bën tespih me guralecë!

Hadithi i Pejgamberit [sal-lallahu alejhi ve selem].: *“Tre personave nuk do tu flasë Allahu*

në Ditën e Gjykimit: Ai i cili jep lëmoshë dhe e përmend, shitësi i cili e lëvdon mallin e tij duke u betuar rrejshëm dhe ai që zgjat rrobat e tij”. Në një transmetim tjetër thuhet: *“Tre personave nuk do tu flet Allahu [xhele-shanuhu]. në Ditën e Gjykimit, nuk do ti shikoj, nuk do ti pastroj nga gabimet dhe për ta do të ketë dënim të madh.*

Këtë e përsëriti 3 herë. Ebu Dherri tha: Paskan humbur dhe qenkan shkatërruar! Po kush janë ata? I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve selem] tha: *Zgjatësi i rrobave, lëmosh dhënësi i cili e përmend atë, dhe shitësi i cili betohet rrejshëm gjatë tregtisë së tij”*

Edhe këta hadithe janë prej atyre të cilat kanë rrënë në duart e injorantëve dhe është keqinterpretuar. Këto hadithe miren që simbas disave, muslimanit nuk i lejohet ti mbaj rrobat e gjata nën zogun e këmbës.

Mirëpo e vërteta e këtij hadithi nuk është kjo, por e vërteta është se në këtë hadith bëjnë pjesë ata persona të cilët i lëshojnë rrobat e tyre nga mendjemadhësia. Në këtë kontekst kemi hadithin ku i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve selem]. ka thënë: *“Kush tërheq rrobat e tij zvarrë me mendjemadhësi, Allahu nuk do ta shikoj në Ditën e Gjykimit”*. Atëherë Ebu Bekri r.a. tha: Një pjesë e rrobës time zvarritet nëpër tokë përveç nëse i kushtoj kujdes të veçantë? Atëherë i tha: *“Ti nuk je nga ata që e bëjnë nga mendjemadhësia”*. Gjithashtu, transmeton Ebu Bekrete i cili tregon: *“U zu dielli përderisa ne ishim te Pejgamberi [sal-lallahu alejhi ve selem]. Ai u ngrit dhe nga të shpejtuarit e tërhiqte zvarrë rrobën e tij derisa arriti në xhami”*.

Këto janë vetëm disa hadithe në këtë temë të cilat keqinterpretohen dhe nxiren nga konotacioni i tyre.

KAPJA PËR NË IDE TJERA DHE JO PËR NË KURAN DHE SUNNET.

Kjo çështje është shumë e ndërlikuar por edhe e ndjeshme. Shumë njerëz musliman përçahen se u përkasin ideve të ndryshme dhe përfaqësojnë ideologji të ndryshme. Madje nga injoranca e tyre mund të përfaqësojnë dhe të mbrojnë edhe ide laike dhe anti fetare. Disa të tjerë janë të lidhur me individ të caktuar dhe besojnë se të gjithë njerëzimi duhet të lidhet me të dhe rreth tij. Kështu p.sh disa njerëz duke u thirrur në teoritë e filozofëve



që kanë për femrën ata këto teori ia mveshin edhe islamit duke e quajtur edhe si përkrahës i këtyre teorive bazuar në hadithin e Pejgamberit [sal-lallahu alejhi ve selem] ku thotë: *“Gratë janë me mendje dhe besim të mangët”* (Mutefekun Alejhi)

Hadithi është i vërtetë mirëpo mënyra se si është kuptuar ky hadith është gabim, pasi që ky hadith nuk ka për qëllim dobësinë e femrës dhe injorimin e saj, por ky hadith na tregon natyrshmërinë e gruas nga ana e krijimit. Gruaja nga natyra e sajë është krijesë që e mbizotërojnë emocionet, kjo nga shkakun se Zoti i ka ngarkuar gruas funksione dhe detyra të ndjeshme, si shtatzania, gjithënia, rritja dhe edukimi i fëmijëve, funksione të cilat nuk kryhen me anë të mendjes por me anë të emocioneve. Ndjenjat e saja mbizotërojnë logjikën e saj dhe ato janë më të shprehura se sa aktiviteti i saj mendor, ngase ajo është e formuar më shumë të bartë se sa të imponojë, më shumë pranon të nënshtrohet se sa të sundojë.


METODAT E KUPTIMIT DREJTË TË HADITHIT

Ai që do të punojë me hadithin e Pejgamberit [sal-lallahu alejhi ve selem] duhet të ketë parasysh që të hiqet prej shtrembimeve të gënjeshtarëve dhe interpretimet e të paditurve. Poashtu duhet ti përmbahet disa çështjeve që konsiderohen si parime themelore të kësaj shkence.

Detyrë e dijetarit është që gjatë argumentimit më një hadith të hulumtojë me qëllim që ta pastroj njohurin e tij nga hadithet e dobëta, me të cilat janë mbushur shumë libra fetare, pastaj dijetarin nuk guxon ta tërheq përhapja e një hadithi në mesin e njerëzve pasi që një hadith të jetë i njohur nuk do të thotë se është edhe i vërtetë. Dijetari e ka për detyrë që para se ta plasoj një hadith në mesin e njerëzve të thjeshtë, atë hadith ta analizojë mirë duke përdorur të gjitha disiplinat e

klasifikimit të hadithit siç janë: disiplina mbi kuptimin e fjalëve të panjohura të hadithit, disiplina rreth harmonizimit të haditheve që s’janë në pajtueshmëri në mes veti, harmonizimi i haditheve që kanë të bëjnë me një temë etj.

Përtë kuptuar hadithin në mënyrë sa më precize duhet të analizohen rrethanat në të



cilat është thënë hadithi.

Shohim se për të ardhur të kuptimi i një hadithi sa më mirë kërkohet punë dhe dituri. Është e vërtetë se të gjithë njerëzit nuk janë në një nivel të diturisë, prandaj ka nevojë që njerëzit të cilët nuk janë të thelluar në dituri, të ndjekin ata të cilët kanë studiuar rreth fesë, pasi ata më mirë i kuptojnë tekstet fetare, pasi edhe vetë urdhër i Allahut [xhele-shanuhu]. është: **“Pyetni dijetarët nëse ju nuk dini”** (Nahl; 43)

Në këtë drejtim ne duhet të kemi kujdes që të mos pyesim çdo njeri rrugës për fenë, e të marrim dispozita nga njerëz të

cilët diturinë e kanë të pa verifikuar, por do të pyesim njerëzit e ditur, do të ndjekim një shkollë juridike, pra, medhhebin të cilin e kanë përkrahur shumica e botës islame, pasi që nuk mund të thirret çdo njëri në marrjen e fesë direkt nga Kur`ani dhe hadithi, kjo është absurde, pasi çdo njeri i thjeshtë i cili ka lexuar ndonjë revistë me përmbajtje fetare nuk guxon

edhe hadithet e Pejgamberit [sal-lallahu alejhi ve selem] duke mos ua dhënë hakun dhe duke i nxjerr nga konteksti i tyre ashtu siç folëm deri tani janë bërë shkak për përçarje. Mu kjo është një prej shkaqeve që muslimanët sot i shohim duke u luftuar njëri me tjetrin, duke shpifur njëri tjetrin për mëkatar apo jobsimtar e gjithë kjo për shkak të dallimeve në mendime.

Si duket jemi duke jetuar në kohën për të cilën Muhammedi a. s. ka thënë: *“Pasardhësit e mi do të ndahen në shtatëdhjetë e tri degë, prej të cilave në mëshirën e Zotit do të jetë vetëm një, e kjo është ajo që do t’i mbahet drejtimit në të cilin jam unë dhe shokët e mi.”*

A thua është në rregull që e gjithë kjo përçarje të ndodhë vetëm për shkakun e disa mospajtimeve në çështjet dytësore?! As’habët r.a ka ndodhur nuk janë pajtuar në disa çështje, mirëpo në këtë nuk ka pasur kurrfarë dëmi për fenë as që ka ndikuar në unitetin ndër muslimanët, në të vërtetë manifestohej gjerësia e mendimit islam. Kështu ata llojlojshëm i kanë kuptuar disa ajete dhe hadithe, por për këtë shkak ndërmjet veti nuk janë grindur, nuk kanë polemizuar.

Për shembull, Ibn Umeri rrëfen se Muhammedi a. s., kur kthehej nga Ahzabi ka thënë: *“Askush mos ta falë ikindinë pos te fisi Kurejdhe.”* Por, disa ende ishin në rrugë kur hyri koha e ikindisë, e disa mendonin se nuk duhet falur deri në vendin e caktuar, kurse të tjerët se duhet dhe se kjo nuk do të jetë kurrfarë gabimi. Më vonë këtë rast ia rrëfyn Pejgamberit a. s., dhe ai askë nuk e qortoi. (Mutefekun Alejhi)

Besimtari i sinqertë duhet të ketë kujdes që mos të bëjë ndonjë vepër apo të thotë ndonjë ide e cila do të rezultojë me përçarje. Ibn Abbasi transmeton se Muhammedi a. s. ka thënë: *“Kush në obligimet (të drejtat) e veta sheh diç që personalisht nuk i përgjigjet le të durojë (e mos të bëjë përçarje), sepse kush largohet prej Bashkësisë vetëm për një pëllëmbë dhe në gjendjen e tillë vdes, ka vdekur me vdekjen e të pafeut.”* (Transmeton Muslimi)

t’i jap guxim vetes e të flas rreth fesë pa njohuri. Pejgamberi është kërcënuar rëndë duke thënë: *“Dhe kush bën shpifje ndaj meje (më bën gënjeshtar) vendqëndrimi i tij nështë zjarri”* (Mutefekun Alejhi)

PËRÇARJA E MYSLIMANËVE

Edhe përsëri asaj se thirrja për unitet dhe vëllazërim në mes të muslimanëve gjendet në shumë ajete kur’anore dhe hadithe të Pejgamberit [sal-lallahu alejhi ve selem], sot muslimanët i gjen në gjendje të mjerueshme. Fatkeqësisht

Modeli i kultivimit të vlerave fetaro Islame

Shaqir Fetahu

MORALI I PRIJËSIT FETAR-IMAMIT

Niveli i lartë i imamit është karakteristikë dhe vlerë mjaft me rëndësi për punë të suksesshme në xhemat dhe kudo që vepron ai, për arsye se vet detyra kërkon personalitet të kompletuar islam. Pra, secili imam nëse dëshiron sukses në punën e tij duhet të jetë shëmbëlltë për nga aspekti moral për njerëzit tjerë, që do të thotë: të bëjë vepra të mira të jetë i ndershëm, i drejtë dhe qëllim mirë ndaj çdo pjesëtari të një xhemati.

Nëse thellohemi në psikologjinë e xhematit do të shohim se xhemati i do dhe i çmon imamët të cilët janë të sinqertë, të ndershëm, të çiltër, të ndërgjegjshëm, modest, tolerues, etj. Ata, në mënyrë të veçantë çmojnë imamin që lufta për të mirën fillon nga vet ai. Të gjitha këto që i përmendëm janë cilësi të cilat sjellin në një lidhshmëri të fortë në mes të imamit dhe xhematit. Imamët e këtyllë kanë autoritet të pasohq dhe rezultate të mira në viset ku ata punojnë.

Në anën tjetër xhemati nuk e do atë imam i cili është i papërcaktuar me moral të dyfishtë, Imami që flet, e nuk vepron ashtu siç flet. Të këtyllëve imam çdo kush u largohet për arsye se te ai xhemati ndjen pasiguri, luhatshmëri dhe dyshim.

Sjellja e mirë e imamit tregon në besimin e thellë të tij. Ai duhet që në çdo sjellje t'u tregojë xhematit si dhe në çfarë mënyre jetohe në përputhshmëri me rregullat islame. Vetëm në këtë mënyrë ai mund të mendojë në sukses. Sa e sa herë këtë e kanë vërtetuar fjalët e urta të dijetarit të njohur Hasan el Basirut:

“Njeriu i sjellshëm ndikon në një mijë njerëz

“Juve u është shpallur në Librin (Kur'anin) që, kur të dëgjoni se po mohohet Kurani i All-llahut dhe se po bëhet tallje me të, mos rini me ata derisa të mos hyjnë në bisedë tjetër. Përndryshe ju do të jeni si ata...” (En Nisaë, 140)

më tepër se sa këshillat e njëmijë njerëzve në një njeri”.

Sa i përket aspektit moral, për çdo imam, Muahmedi a.s. duhet të jetë shëmbulli më i mirë, që do të thotë të njihet mirë Kur'ani Famëlartë dhe jeta e Muhamedit a.s., gjegjësisht mënyra e thirrjes së tij në Islam. Ta ndjekësh shëmbullin e Muhamedit a.s. do të thotë se në çdo moment dhe vend të sillësh ashtu siç lyp Kur'ani duke i mbetur besnik ndaj urdhrave të

tij. Jeta e Muhamedit a.s nuk ka qenë kurrëgjë tjetër përveç se Kur'an. Këtë e shohim nga fjalët e Aishe r.a. kur dikush e pyeti për sjelljen e Muhamedit a.s., e ajo u përgjigj: **“Moral i tij ishte Kur'ani”.**

Pra, për çdo imam Kur'ani dhe jeta e Muhamedit a.s. duhet të jetë bazë e jetës së tij, program i tij, lumturi dhe kënaqësi, duke i vënë në shërbim të fesë të gjitha mundësitë dhe aftësitë që i posedon ai. Për atë secili imam

duhet vullnetarisht dhe në mënyrë të ndërgjegjshme t'i hyjë kësaj detyre me qëllim që sa më mirë dhe sa më me sinqeritet ta kryejë këtë detyrë. Ai duhet ta ketë përmendur se të praktikuarit të asaj që flet është i vetmi kriter për ta provuar nderin dhe besnikërinë e vet. Nëse këtë nuk e bënë atëherë shihet se motivet e tija nuk kanë karakter islam. Në lidhje me këtë në shumë vende na flet edhe Kur'ani Famëlartë:

“O ju që besuat., pse po e thoni ate që nuk e punoni? Tek All-llahu është shumë e urrejtur ta thoni ate që nuk e punoni”. (Es Saf.2-3).

“A po i urdhëroni (thirrni) njerëzit për punë të mirë, e veten tuaj po e harroni? Ndërsa ju e lexoni librin, a nuk po mendoni?” / El-Bekaretu44/

Muhamedi a.s. thot:

“Këshillo vetveten e pastaj të tjerët-njerëzit”.

“Shëmbulli i atij që udhëzon njerëzit në të mirë-fe, por vetveten e harron është sikur kandili i cili të tjerëve ju bënë dritë, e vetveten e djeg”

Njerëzit e urtë kanë thënë:

“O ti që këshillon tashmë je bërë i paditur, sepse atë që e bënë të shëmtuar vet e punon”.

“O dijetarë të fesë! O kripa e njerëzisë! Kush e rregullon kripën kur ajo prishet!”

“Mos ndalo njerëzit nga punët që vetë i punon, është turp i madh për ty nëse ashtu vepron”.

DASHURIA NDAJ PROFESIONIT

Dashuria ndaj profesionit, e në veçanti ndaj detyrës së imamit është karakteristikë mjaft e rëndësishme për suksesin dhe fatin e vet imamit. Këtë karakteristikë duhet ta posedojë secili imam, për



ndryshe pa këtë cilësi asnjë imam nuk mund të llogarit në aktivitet të mirëfilltë dhe punë të suksesshme. Imami i cili e do dhe e çmon profesionin dhe detyrën e vet dhe i cili ndaj saj silltet me respekt të veçantë ose e kryen atë në emër të All-llahut xh.,sh., pastaj është mik i vërtetë i besimtarëve dhe thellë i ndien dobësitë e tyre, gëzohet me mirëqenien e tyre me siguri se do të ketë rezultate të mira kudo që vepron

All-llahu xh.sh. në Kur'anin Famëlartë thotë:

“Ju patjetër do të sprovoheni si në pasurinë tuaj, si në veten tuaj, madje do të dëgjoni ofendime të shumta prej atyre që u është dhënë libri para jush, e edhe prej idhujtarëve, po në qoftë se duroni dhe ruheni, ajo është gjëja më vendimtare.” /Ali Imran,185/

Pra, All-llahu xh.sh. paraprakisht bënë përgatitjen psikofizike të prijësit fetar si dhe shpjeguesit të misionit hyjnor duke i treguar atij se në këtë rrugë do të hasin në ata të cilët nga padija nuk do ta pranojnë porosinë e shenjtë dhe në këtë mënyrë do të sulmohen verbalisht me fjalë të ndyta dhe fizikisht me qëllim që te ata të mbjellin pesimizmin dhe më në fund për t'i kapluar demoralizimi dhe pikëllimi që dërgon drejt largimit nga shpjegimi dhe aplikimi i misionit hyjnor.

Mirëpo, të gjithë ata prijës fetar të cilët do ta kuptonin se misioni hyjnor vërtetë gjithmonë has në vështirësi dhe pengesa ata gjatë kryerjes së misionit të tyre janë:

- të interesuar dhe mjaft entuziastë dhe optimistë në punën e tyre që ndikon jashtëzakonisht që ata të gjenden mirë në situata të ndryshme dhe në të njëjtën kohë përdorin metoda më efikase dhe më të drejta në kontaktet e tyre me njerëz tjerë. Me optimizmin e tyre ndikojnë mjaft në kënaqjen dhe disponimin e të tjerëve duke qenë të afërt me miq dhe bashkëpunëtorë të zellshëm. Këtë optimizëm dhe interesim maksimalisht mundohen ta mbjellin edhe tek të tjerët duke mbjell tek ata besimin në vetvete si dhe shpresën për një të ardhme më të mirë;

- të disponuar dhe të gëzuar

gjatë kryerjes së detyrës, me çka tregojnë vetëdijen dhe bindjen e thellë se gjithmonë duhet të jenë në shërbim të kultivimit të së mirës dhe pozitives dhe se të gjithë këtë disponim mundohen ta përcjellin edhe tek njerëzit tjerë që edhe ata të ndihen në të njëjtën gjendje. Disponimi i këtillë e bënë ate të jetë gjithmonë i freskët, i gëzuar dhe i lumtur e cila gjendje psikologjike shndrit personalitetin e prijësit fetarë dhe po kjo gjendje reflektohet edhe tek njerëzit tjerë me çka edhe ata përgatiten që sa më lehtë t'i pranojnë obligimet dhe detyrat e parashtruara nga prijësi fetar – imami. E gjithë kjo formon një gjendje motivuese, bashkëpunuese, aktive, racionale, shpresëdhënëse dhe fuqi moralo shpirtërore për ta kuptuar porosinë sa më lehtë dhe sa më shpejtë.

- vigilenca në çdo situatë dhe moment për veprimet e veta si dhe gjendjen e përgjithshme të njerëzve duke qenë i vetëdijshëm për procesin e depërtimit të porosisë së tij tek njerëzit në përgjithësi. Kjo ka të bëjë me rikthimin e tij drejt vetvetes duke analizuar

veprimin e vet si dhe nivelin e depërtimit të porosisë së tij tek të tjerët.

Pra, imamët e këtillë të cilët me një nivel të lartë të dashurisë e kryejnë profesionin për të cilin janë përcaktuar janë të palodhshëm në punën e tyre duke e kryer atë në mënyrë adekuate dhe të përsosur dhe në këtë mënyrë ata ndiejnë qetësi e jo vështirësi, krenari e jo nënçmim, lumturi e jo pikëllim, optimizëm e jo pesimizëm, entuziazëm dhe ambiciozitet e jo neglizhencë e plogështi, etj.

Për të këtillët All-lahu xh.sh. thotë:

“E kush është në rrugë më të mirë se ai që thërret në rrugën e All-llahut xh.sh., që bënë vepra të mira dhe që thotë:”Unë jam musliman.”/Fusilet,33/

KUJDESI DHE VETË-DISIPLINA

Vetë-disiplina është veti mjaft e rëndësishme dhe faktor me peshë në jetën dhe aktivitetin e çdo individi, në veçanti në punën dhe aktivitetin

e prijësit fetar – imami. Nga fjala vetë-disiplinë nënkuptohet “rend”, “dëgjueshmëri”, “rregull”, kryerje e obligueshme dhe precize të detyrave të cilat i parasheh misioni i shenjtë. Përsosmëria e një bashkësie apo individi varet nga kujdesi dhe vetë-disiplina e vet udhëheqësit të asaj bashkësie.

Prijësi fetar – imami në punën të jetë në nivelin më të lartë të gatishmërisë për të kryer në përpikëri të gjitha obligimet që dalin nga detyra e tij si dhe specifikat tjera që i parasheh koha dhe vendi. Pa dyshim kjo do të ndodh nëse prijësi fetar ka bindje të thellë tek All-lahu xh.sh. e cila bindje jep tek ai ndjenjën dhe vetëdijen se All-llahu xh.sh. mbikëqyr atë dhe veprimin e tij të fshehtë dhe publik. Andaj, çdo devijim në këtë sferë tregon mosbesim të bindshëm tek All-llahu xh.sh. dhe kjo e bënë atë të paafte dhe të dobët në kryerjen e obligimeve të parapara dhe në të njëjtën kohë është thyerje e rregullit të All-llahut xh.sh. dhe mëkat i madh. All-lahu xh.sh. i drejtohet njeriut me këto fjalë:

“... e kush e përmbush amanetin e vet (është besnik) dhe ruhet nga



mëkatet, s'ka dyshim se All-llahu i do ata që ruhen. Ata që për një vlerë të paktë shesin besën e dhënë All-llahut, ndryshojnë edhe zotimet e tyre, të tillët nuk kanë pjesë (mëshirë në botën tjetër), dhe në ditën e kiametit All-llahu nuk u flet atyre, nuk i shikon ata dhe nuk i pastron (prej barës së gabimeve) ata kanë një dënim të dhim bshëm". (Ali Imran,76-77).

"E kush e thyen (zotimin), ai e thyen vetëm në dëm të vetin, e kush e zbaton atë që i është zotuar All-llahut, ai do t'i jap atij shpërblim të madh". (El Fet'h,10).

Pra, vetë-disiplina, përpikëria dhe kujdesi në kryerjen e obligimeve, imami tregon shëmbëlltoren e veprimit në jetën e përditshme si dhe aplikimin e fjalës në veprë. Me këtë jep shembull të lidhshmërisë së fjalës me veprën, teorinë me praktikën, shpirtëroren me materialen dhe në këtë mënyrë shton besimin tek të pranishmit si dhe tek besimtarët në përgjithësi. Me këtë jep në mënyrë konkrete

shembullin e mësimave islame duke futur tek besimtarët tjerë ndjenjën e besimit në parimet e Islamit, ngrit nivelin e vetëdijes, kujdesit, qetësisë, sigurisë shpirtërore dhe fizike, etj. Për këtë lirisht mund të themi se kujdesi ndaj obligimeve si dhe vetë-disiplina në punën e imamit është parakusht i etikës, kulturës, harmonisë, suksesit, përsosmërisë së imamit, xhematit, dhe besimtarëve në përgjithësi. Aty ku mungon kjo krijohet hapësirë për paraqitjen e labilitetit, dyshimit, shqetësimit, mosmarrëveshjet, disharmonia, pasiviteti, jo serioziteti dhe më në fund mossuksesit.

PEDANTERIA DHE PASTËRTIA SHPIRTËRORE DHE FIZIKE E IMAMIT

Islami në esencë është i pastër dhe i bukur dhe në këtë mënyrë dëshiron t'i rregullojë gjërat në natyrë dhe në punët e përditshme. Ai zbkuron sendet duke krijuar një harmoni e cila bëhet e këndshme dhe joshëse për çdo individ. Pra, edhe imami për të qenë shembull për të tjerët dhe joshës në punën e vet me përgjegjësi të madhe t'i kthehet vetvetes duke ngrit nivelin e pastërtisë, rregullsisë dhe pamjes së vet universale.

Për këtë All-llahu xh.sh. në Kuranin Famëlartë thotë:

"All-llahu i don ata që pendohen dhe ata që ruhen prej punëve të ndyta dhe të neveritshme". (El Bekaretu,222).

Ndërsa Muhamedi a.s. shpesh thoshte: **"Pastërtia është pjesë e imanit"**, apo: **"Vërtetë All-llahu është i bukur dhe i do të bukurit"**.

Pra, rregullsia, pastërtia dhe pedanteria e imamit është ndër kushtet mjaft me rëndësi në veprimin e tij. Me këtë ai në praktikë përfaqëson dhe prezanton misionin islam duke treguar se Islami është niveli më i lartë i pastërtisë fizike dhe shpirtërore. Që ta arrijë këtë, imami duhet të dallohet me veshmbathje të pastër dhe të mirë, uniformë të pastër dhe të bukur, parfymosje me erëra të mira, etj.. Me këtë imami formon autoritet të lartë duke hapur rrugën për ta ndjekur të

tjerët. Mirë thotë një fjalë e urtë franceze: "Forma mbron autoritetin".

Dukja e jashtme është shenjë dhe manifestim i asaj që është në brendinë e vet imamit. Pastërtia fizike dhe e jashtme tregon në pastërtinë e imamit për nga aspekti shpirtëror dhe me këtë jep shembull se dukja e jashtme e njeriut varet nga pastërtia e shpirtërore e vet njeriut dhe nisur nga kjo nuk ka pastërti dhe pamje të bukur nëse kjo pastërti dhe pamje nuk është në shpirtin dhe zemrën e njeriut.

KUJDESI I IMAMIT NË JETËN PUBLIKE

Misioni i personalitetit të imamit është angazhimi maksimal për të edukuar besimtarët në frymën e islamit duke i këshilluar ata në të mirë dhe duke i larguar ata nga e keqja dhe destruktiviteti. Këtë, ai duhet ta tregojë edhe me vet qenien e tij duke u sjellë në bazë të fjalëve që i lëshon në mesin e besimtarëve. Ajo që është me rëndësi të veçantë dhe që ka ndikim të madh në psikologjinë e besimtarëve është lëvizja dhe ndeja e imamit në jetën e përditshme. Nisur nga kjo imami duhet të sillet konform parimeve të Islamit dhe njëherit me kujdes të veçantë duhet t'u largohet vendeve të dyshimta dhe sjelljeve të këtitilla. Mjaft negativisht ndikon lëvizja dhe ndeja e imamit në vendet e dyshimta, sjellje kjo që do të ndikonte thellë në prishjen e mendimeve dhe sjelljeve të besimtarëve. Andaj, imami duhet të largohet nga vendet e prishet si vende ku konsumohet alkooli, shtëpitë publike-prostitucioni, kazinotë e ndryshme, kafenetë jo të pastra, etj.

Jo që nuk duhet të gjendet në këto vende, por në të njëjtën kohë imami duhet luftuar me të gjitha mjetet që posedon ndyrësitë e këtitilla dhe njëherit po të njëjtin disponim duhet ta krijojë të vet besimtarët dhe rrethi ku ai vepron.

Për këtë All-llahu xh.sh. në Kur'anin famëlartë thotë:

"Juve u është shpallur në Librin (Kur'anin) që, kur të dëgjoni se po mohohet Kurani i All-llahut dhe se po bëhet tallje me të, mos rini me

ata derisa të mos hyjnë në bisedë tjetër. Përndryshe ju do të jeni si ata..."(En Nisaë,140)

"A mos shkatërrohet kush, përpos popullit të shfrenuar?"

Ndërsa Muhamedi a.s. thotë:

"Kush beson All-llahun dhe ditën e gjykimit. le të mos gjendet ne vendet e dyshimta".

Personaliteti i imamit është shtyllë kryesore në zhvillimin dhe kultivimin e Islamit në vendin dhe kohën ku ai vepron. Niveli i zhvillimit dhe kultivimit të vlerave islame kryesisht varet nga aftësia, gjindshmëria dhe përgatitja profesionale dhe universale e imamit. Krahas zhvillimit të njerëzimit në sferat e ndryshme të aktivitetit të tyre duhet zhvilluar dhe përgatitur edhe imami. Ai duhet të njihet mirë me të gjitha vlerat bashkëkohore dhe përafërsisht t'i njeh të gjitha risitë të shkencave të ndryshme, por mbi të gjitha duhet të njihet me mënyrat bashkëkohore dhe metodat më efikase që zhvillohen sot në aktivitetet e thirrjeve dhe misioneve të ndryshme. Esenciale është gjetja e rrugëve për të komunikuar me njerëzit, për të depërtuar në shpirtin e tyre, për të mbjellë simpati tek ndjenjat e tij, për të gjetur atë që është në përputhshmëri me natyrën psikologjike dhe shpirtërore të tyre dhe më në fund aftësia për të përdorur mjetet dhe metodat më të përsosura dhe më efikase bashkëkohore që do të ishin në përputhshmëri me kohën, rrethanat, mentalitetin, dhe nivelin intelektual të vendit,kohës dhe popullit me të cilin vepron.

Andaj, të jesh sot imam është nder i madh, por njëkohësisht është edhe përgjegjësi e madhe që kërkon kujdes të veçantë në detyrën e besuar dhe misionin që duhet kryer. Mbi të gjitha është përgjegjësi e madhe se sa do të jetë në gjendje imami të aftësohet për të qenë në suaza të fjalëve të All-llahut xh.sh. i cili ka thënë:

"Ti (Muhammed) thirr për në rrugën e Zotit tënd me urtësi e këshillë të mirë dhe polemizo me ata (kundërshtarë) me atë mënyrë që është më e mira..." (En Nahl:125).

Autori është Myfti i Myftinisë së BFI-së, Gostivar



MBULESA (HIXHABI) VESHJE E ARDHMËRISË

“Plotësisht është e qartë se në shoqëritë ku mungon edukimi i shëndoshë moral i gjinisë femërore, mjerisht çdo ditë, nga ora në orë, apo thuaja çdo çast, dëgjojmë dhe jemi dëshmitar të rrëfimeve të tmerrshme për dhunime dhe abuzime të ndryshme seksuale ndaj grave.”

Ahmed R. Ramadani

Në periudhën e quajtur **“The Day After”** pas sulmit terrorist të së martës së zezë më 11 shtator të vitit 2001 në SHBA, feja islame sërish doli në epiqendër të vëmendjes dhe u bë objekt i analizave dhe kritikave nga më të ndryshmet. U zhvilluan debate të tëra, ku u përfshinë orientalistë, islamologë dhe intelektual të sferave të ndryshme anekënd rruzullit tokësor, e sidomos në Perëndim. Një debat tillë nuk mungoi madje edhe në vetë botën arabo-islame. Mësimet islame, parimet e tij si dhe vetë doktrina e tij - u bënë objekt hulumtimi, studimi dhe analize nga dijetarë të ndryshëm në qarqe dhe mjedise të caktuara. Në të gjitha këto debate **nada de senalar** nuk pati përkitazi me Islamin dhe mësimet e tij...pos ideve kaheerë të moçme që sërish filluan të dalin në pah

dhe të përfolën me të madhe... Njëra nga çështjet që më së shumti u rrah dhe diskutua, përkatësisht u bë objekt studimi dhe diskutimi-ishte institucioni i **hixhabit (mbulesës)** dhe sa ora debati i cili u përhap përkitazi me këtë çështje nuk mbeti pa e përshkuar edhe nënqiellin tonë.

Në mjediset tona kjo çështje (hixhabi) u prek nga **“grandsenorët”** tanë “intelektual” dhe debati sa kaq u ndez. Më pas vazhduan zërat *pro et contra* Islamit në përgjithësi dhe mësimet e tij në veçanti, e sidomos me theks të veçantë ndaj hixhabit- mbulesës... Meqë Islami është fe e dijes, paqes, kulturës dhe tolerancës, e pashë të arsyeshme se duhet t'i bëjë një shtjellim të shkurtër institucionit të hixhabit në Islam, gjithnjë me shpresë se sado-kudo ky shkrim imi modest do të ndikojë në prezantimin e drejtë të mësimetve islame dhe do të ulë

gjakrat e nxehur e veçanërisht do të bëjë që të ç'tensionohen shpirtat e trazuar...

Allahu i Madhërishëm në Kur'anin Fusnik thotë:

“O ti Pejgamber, thuaju grave tua, bijave tua dhe grave të besimtarëve le të venë shamitë (mbulojë) e veta mbi trupin e tyre, pse kjo është më afër që ato të njihen (se nuk janë rrugaçe) e të mos ofendohen. Allahu fal gabimet e kaluara, Ai është Mëshirues”. (El-Ahzabë, 59).

Ajo që bën dallimin mes njeriut dhe kafshës është veshja; Ajo (veshja) u ndihmon njerëzve që më lehtë t'u përshtaten karakteristikave kulturore të një grupi etnik, rajoni apo territori të caktuar... Synimi i të mbuluarit, teshave është i trefishtë: **1. Mbulimi i trupit;** **2. Pamja estetike;** dhe **3. Respektimi i qëndrimit të caktuar.** Mbulesa islame (hixhabi) - duke u nisur nga ajo

se është mbulojë për femrën, automatikisht vihet në mbrojtje të femrës nga shqetësimet dhe njëherit paraqet edhe shenjë identifikimi të kulturës islame, qoftë kjo në vendet islame apo ato jo-islame. Për femrën është i obliguar hixhabi, i cili e mbulon tërë trupin, me përjashtim të duarve, këmbëve nga poshtë nyjeve dhe fytyrës. D.m.th. hixhabi shërben si kriter për eliminimin e të këqijave dhe arritjen e përsosmërisë në shoqëri.

Pozita dhe roli i gruas në botën moderne

Hixhabi i kontribuon ndershmërisë së gruas dhe, njëkohësisht paraqet dhe është garanci e sigurisë së shoqërisë. Në mesin e elementeve të cilët e mbrojnë dhe ruajnë nderin, moralin, dinjitetin dhe rehatinë (qetësinë) e shoqërisë në përgjithësi, nuk ekziston mënyrë dhe mjet më efikas, me të cilin pjesëtarët e gjinisë femërore - në përputhje të plotë



me natyrën e tyre - do ta mbronin shoqërinë në çdo aspekt nga çdo devijim, se sa institucioni i hixhabit. Duke u nisur nga kjo, qartë shihet se hixhabi ka rëndësi dhe domethënie të jashtëzakonshme...

Mbulesa islame (hixhabi), është njëri nga mjetet që armiqtë e Islamit e përdorin më së shumti për udhëheqjen e fushatës së fëlliqur të krijimit të insuniatave dhe propagandës qëllimkeqe anti-islame, e që në thelb përmban sulm kundër normave dhe kulturës fisnike islame, d.m.th. atak ndaj vetë Islamit. Kjo fushatë **Noche sin luna** udhëhiqet nëpërmjet fjalës së shkruar, komenteve të ndryshme radio-televizive, rrjetit të internetit, diskriminimit të ndryshëm, mos-lejimit të ndjekjes së punës, apo të mësimet me hixhab (dukuri kjo që fatkeqësisht kohëve të fundit është prezentë në nënqiellin tonë), e që ka për qëllim dhe synim shtrembërimin dhe paraqitjen sa të jetë e mundur më zi të institucionit të mbulesës së gruas muslimane si sinonim të prapambetjes, me theks të veçuar gjoja në kthim prapa kah terri dhe injoranca (sic!), praktikisht shtrembërim i tërë konceptit të të mbuluarit, i cili është themeli i moralit dhe dinjitetit në shoqëri...

Me çfarëdo preteksti dhe forme që paraqiten, fushatat apo **los pajaros de la muerte** (se ndryshe s'ke si i quan) pikësynim ekskluziv dhe primar e kanë çuarjen ujë në mulli të armiqve të Islamit, përkatësisht kapitalizmit bashkëkohor gjakpirës - filozofisë materialiste të jetesës, idesë së përfitimit nga gjithçka, të cilët nuk ofrojnë asgjë tjetër pos "kulturë" nudo-lakuriqe dhe konsumuese, e që ka për qëllim që gruan ta shndërron në mjet profiti dhe instrument të industrisë së tij të fëlliqur propagandistike... Duke parë dhe vërejtur pasurinë dhe fuqinë (vitalitetin) e mësimave dhe kulturës islame, të cilat mësimet në mënyrë plotësisht bindëse dhe argumentuese, nëpërmjet logjikës së shëndoshë, u kundërvihen kulturave të huaja të ndryshme për vetë substancën e Islamit në përgjithësi dhe atyre që propagandojnë dhe lansojnë zhveshjen nudo-lakuriq të gruas në veçanti. Perëndimi nëpërmjet

propagandës dhe "intelektualëve" të tij, filloi fushatën e tij të egër anti-islame dhe anti-mbulesë (nga e cila propagandë nuk mbetën "imun" as edhe "intelektualët" e trojeve tona), duke pohuar se gjoja Islami e privon qenien femërore nga të drejtat e saja elementare - duke ia impomuar asaj hixhabin e që sipas botëkuptimit të mykur të tyre na qenka i huaj për femrën dhe natyrën e saj!!! Përveç kësaj ata shkojnë aq larg sa që madje pohojnë se hixhabi nuk është i urdhëruar nga Zoti, por është i motivuar nga shkaqet dhe faktorët shoqëror, psikologjik dhe ekonomik... Mirëpo, gjithë ky shtrembërim i fakteve dhe keq-interpretim i realitetit është tejet i dobët dhe meskin që ta eliminojë institucionin e hixhabit në Islam në përgjithësi dhe në mjedisin tonë në veçanti, ngase hixhabi me madhësinë dhe hijeshinë e tij jo rrallë herë i tërheq dhe josh madje-madje edhe gratë jo-muslimane...

Por e vërteta është se mbulesa islame (hixhabi) ashtu siç pamë edhe në fillim të tekstit, më sipër në Kur'anin Fisnik (El-Ahzabë, 59) është ligj i prerë i Allahut të Madhërishëm, d.m.th. rrënjët e veta i ka në urdhrin e Krijuesit, Allahut, Zotit të botërave. Allahu i Madhërishëm i Cili e njez dhe e din më së miri se kushdo qoftë tjetër natyrën e njeriut - krijesës së Tij - i ka urdhëruar besimtarët që të vënë shamitë në kokë. Urtësia në prapavijë e mbulesës islame (hixhabit) nuk është asgjë tjetër pos që femrës t'i ofrojë: siguri, nderë, dinjitet, pastërti dhe respekt, ndërsa shoqërisë qetësi dhe prosperitet.

Kur Kur'ani Fisnik kërkon ga gruaja që të mbulohet, njëkohësisht - bile në të njëjtë kohë ai lyp edhe nga burrat që t'i ndalin/frenojnë shikimet e tyre dhe t'i mbulojnë pjesët e turpshme, kështu që, në këtë mënyrë më sigurt t'i ikin sjelljes së padëshiruar dhe të pahijshme. Tërë kjo qartë dhe më së miri tregon se qëllimi i Kur'anit, përkatësisht Krijuesit të botërave - Allahut të Madhërishëm është formimi i shoqërisë së shëndoshë njerëzore, shoqëri kjo, ku nuk do të dominojnë sjelljet e turpshme e të pahijshme si dhe ekspozimi i lakuriqësisë-zhveshjes...

Fakti që grave u është ndaluar që ta ekspozojnë

zbukurimin e tyre karshi atyre që nuk janë në lidhje fisnore: (**"...përveç burrave të vet, baballarëve të vet ose baballarëve të burrave të vet, djemve të vet ose djemve të burrave të vet, vëllezërve të vet, apo djemve të motrave të veta, ose grave të tyre** (që u përmendën) **dhe robërshave, të cilat i kanë në pronësinë e tyre, ose shërbetorëve nga meshkujt të cilët nuk ndiejnë nevojë për femrat ose fëmijët që nuk kanë aritur pjekurinë për gra...**" Kur'ani; En-Nur, 31): qartë argumenton dhe tregon se synimi dhe ideali i mësimave islame është mbrojtja dhe evitimi nga përmbysja morale. Kjo në masë të madhe u vie në ndihmë burrave, të cilëve u bën mbrojtje nga sfidat e ndryshme, dhe në këtë mënyrë ata-burrat nuk arrijnë të pengohen nga kryerja e detyrimeve të tyre të përditshme shoqërore.

Gruaja, nënë dhe edukatore

Plotësisht është e qartë se në shoqëritë ku mungon edukimi i shëndoshë moral i gjinisë femërore, mjerisht çdo ditë, nga ora në orë, apo thuaja çdo çast, dëgjojmë dhe jemi dëshmitar të rrëfimeve të tmerrshme për dhunime dhe abuzime të ndryshme seksuale ndaj grave. Apo akoma edhe më keq, incestit, siç ishin p.sh. dy rastet që tronditën opinionin austriak dhe atë mbarë botëror: Historia e tmerrshme e austriakes Natasha Kampush, e cila kaloi plot tetë vjet e mbyllur nga i ati i saj në një bodrum dhe mundi të dilte që andej vetëm në 2006-ën; dhe ngjarja tjetër e tmerrshme e zhvilluar në një godinë normale dykatëshe, në qytetin industrial të Amstetenit, ku Elizabet Fricël, 42 vjeç, i kishte rrëfyer policisë se babai i saj, Jozef Fricël (73), e kishte mbyllur atë në qilarin e shtëpisë ku ata jetonin në 1984-ën, e kishte droguar dhe lidhur para se ta "burgoste" atje. Tre prej fëmijëve të saj, të moshës 19, 18 dhe 5 vjeç, qëndronin të mbyllur në qilar, që nga lindja, dhe nuk e kishin parë kurrë dritën e diellit, tha policia, duke ngritur kështu shqetësime për gjendjen e tyre fizike dhe mendore. Dy më të rinjtë janë djem, ndërsa më e madhja, është vajzë. Tre prej

fëmijëve, dy vajza dhe një djalë, ishin rritur ndërkohë, nga Jozefi dhe bashkëshortja e tij...

Në shoqëritë e tilla, gjinia femërore është shtypur dhe eksploatuar gjer në maksimum dhe *de facto* në këto shoqëri-gruaja është shndërruar thjesht në objekt përçmimi dhe instrument reklamimi... Kapitalizmi bashkëkohor perëndimor dhe filozofia e tij jetësore e ngritur mbi bazën e materializmit-dialektik, e nxit dhe propagandon me të madhe të ashtuquajturën "kulturë" të zhveshjes, ngase në të kundërtën produktet e tij nuk do të shiten nëse në to (produktet) nuk figurojnë fotografi të gruas që i përdor ato, apo të gruas plotësisht të zhveshur-lakuriq, e cila në mënyrë të paturpshme e ekspozon trupin e saj...

Plotësisht është e qartë se Perëndimi ky **le grand maitre en ironie** do të vihet në krye të fushatës kundër hixhabit, përkatësisht veshjes së hijshme të gruas, ngase pikërisht mu kjo (hixhabi) i privon ata-perëndimorët nga përfitimi i majmë dhe industria e seksit, të cilat në Perëndim janë shndërruar në "vlëra" dhe arterie frymëmarrëse të jetës!!

Së këndejmi, hixhabi është mënyrë islame që të veçohet dhe potencohet se gruaja është shumë më tepër se sa objekt nënçmimi dhe instrument për përfitimin e parave, përkundrazi ajo-gruaja patjetër duhet të respektohet, çmohet dhe nderohet, pikë së pari si nënë d.m.th. edukatore e brezit të ardhshëm dhe themeli bazë i strukturës së familjes së shëndoshë. Dhe kjo, në asnjë mënyrë nuk don të thotë se grave iu imponohen ndalesa, përkundrazi kjo e përparon, fisnikëron dhe... edhe më tepër e madhështon rolin e saj shoqëror, pedagogjik, psikologjik, kulturor, etik, ekonomik etj., që ajo e mbërrin në shoqëri...

Në fund, nga të gjitha debatet dhe diskutimet e shumta që u zhvilluan dhe po vazhdojnë të zhvillohen anekënd botës, si nga dijetarët muslimanë apo ato jo-muslimanë, një konkluzë e tyre është e përbashkët dhe pa marrë parasysh dallimet e ndryshme rreth çështjeve të ndryshme të Islamit, ata- të paktën pajtohen dhe...dhe janë në ujdi se megjithatë: **Mbulesa (hixhabi) është veshje e ardhmërisë!**

EDUKIMI MORAL I GJENERATAVE TË REJA DOMOSDOSHMËRI

Qufli OSMANI

Njeriu si qenie më e përsosur dhe qenie e cila ka marrë përsipër misionin prej mëkëmbësi në planetën e quajtur tokë, gjatë përditshmërisë së tij ballafaqohet me moralen dhe materialen; me vlerën dhe antivlerën, me të mirën dhe të keqën e veprimit të tij. Këto dy aspekte gjithnjë e sfidojnë njeriun, i cili me intelektin dhe mendjen e tij, duhet të jetë i kujdesshëm që të përcaktohet për vlera duke qenë shpirtërisht i lidhur me Krijuesin e tij.

S`ka dyshim se për të arritur njeriu aftësinë, me të cilën ai do të ishte i moralshëm në të gjitha veprimet e tij, më se i nevojshëm është edukimi, arsimimi i shoqërisë e sidomos arsimimi dhe edukimi i pjesës më të rëndësishme shoqërore – brezave të ri.

TË NDIQET UDHËZIMET FETARE

Sot e tërë bota është përfshirë në një krizë morale, krizë në të cilën, për fat të keq, gjithnjë vjenë në shprehje konstatimi se njeriu për njeriun është ujk. Pra, tjetërsohet roli i njeriut në raport me njeriun, prej rolit human, në atë johuman, jonjerëzor. Janë shkelur të gjitha standardet morale, kësh-tuqë respektimi i familjës në radhë të parë respektimi i prindërve ka humbur kuptimin e vet. Po ashtu, në raportet shoqërore, respektimi i të riut ndaj të moshuarit, i të shëndoshit ndaj invalidit, i të pasurit ndaj të varfërit, i nxënësit ndaj mësimitdhënësit, dita-ditës po zbehet.

Paralelisht me këtë gjithnjë po vijnë në shprehje veprimet dhe shprehitë antinjerëzore siç është prostitucioni, droga,

“Njerëzit që mbisundohen nga epshet nuk zgjedhin metoda për arritjen e qëllimeve të tyre edhe pse qëllimet e tilla janë në kundërshtim me etikën dhe moralin njerëzor.”

alkooli dhe kamata, të cilat prodhojnë apo nxisin plaçkitje, vrasje e vetëvrasje. Ç`është më e keq, këto shprehi dhe punë të shëmtuara ndodhin në vatrat e dijes, shkollat, vendi ku edukohen gjeneratat e reja.

Amoralizimi i shoqërisë është pasojë e mospërfilljes së udhëzimeve që Krijuesi i hartojë për krijesën e tij të mençur, njeriun. Pra, duke mos i praktikuar udhëzimet e në anë tjetër duke e ndjekur lakminë e egos së vet dhe paragjykimet, njeriu është futur në tunelin e errët të quajtur amoralitet. Këtë na e vërteton edhe një citat i Kur`anit famëlartë, ku Zoti xh.sh. thotë:

“Po ata nuk ndjekin tjetër vetëm se paragjykimet dhe çka duan vetë, megjithë që prej Zotit të tyre u pat ardhur udhëzimi.”

ROLI I PRINDËRVE NË EDUKIMIN E FËMIJËVE

Pra, shkaqet kryesore për çështjen e njeriut nga morali është ndjekja apo nënshtrimi i lakmisë ose epsheve të tij indi-



viduale. Epshi është një cilësi shumë e rrezikshme, Njerëzit që mbisundohen nga epshet nuk zgjedhin metoda për arritjen e qëllimeve të tyre edhe pse qëllimet e tilla janë në kundërshtim me etikën dhe moralin njerëzor. Njeriu i këtille gjithnjë është i ekspozuar rreziqeve dhe ai është i humbur si në këtë, ashtu edhe në botën e ardhshme.

Për të dalë nga kjo humnerë, për t'u shëruar nga kjo sëmundje kërkohet një intervenim apo terapi e quajtur edukim moral apo shpirtëror, në rradhë të parë të brezave të ri. Feja apo besimi në një Zot është medikamenti-ilaçi thelbësor i kësaj sëmundje. Përgjegjësia e kësaj terapie, në rradhë të parë i takon prindërve, ata duhet të jenë edukuesit më të mirë sepse janë edhe edukues të parë të njeriut që është duke i bërë hapat e parë në jetë. Pra, roli i prindërve në edukimin e fëmijëve është i pazëvendësueshëm, shumë i rëndësishëm dhe shumë i përgjegjshëm.

Po ashtu, institucionet edukativo-arsimore, shkollat, padyshim janë faktorët shumë të rëndësishëm për edukimin e gjeneratave të reja. Por mjerisht, në këto institucione ende nuk e kemi inkorporimin e lëndës së edukatës fetare, përmes së cilës më së miri bëhet edukimi shpirtëror dhe moral i njeriut. Për fat të keq, përgjegjësit për arsimimin dhe shkollimin e nxënësve tanë, të kapluar nga ndryshku i ish-sistemit, nuk janë në gjendje ta kuptojnë rëndësinë e edukimit shpirtëror dhe moral të gjeneratës së re.

“ANONIMËT” e BE-së dhe frika e Turqisë

“Turqia duhet të bëjë ndryshime kulturore “për të dëshmuar” vlerat që e lidhin me kontinentin Evropian”

Zhakë Shirak

Emine A. Vezaj

Dy figura minore, por kompetente, do të jenë në postin e presidentit dhe përfaqësuesit të lart të BE-së. Herman Van Romphuy kryeministër i Belgjikës për më pak se një vit dhe një teknokrat britanik, i cili kurrë nuk ka pasur post të zgjedhur nga votuesit. Përndryshe anëtar i Partisë Demokristiane belge. Catherine Ashton një laburiste e pëlqyer dhe bashkëpunëtore e afërt e kryeministrit britanik, laburistit Gordon Braun.

Suedia e cila është kryesuesja e radhës së BE-së propozon kryeministrin belg, Herman Van Romphuy's për kryetar të këshillit evropian dhe eurokomesarën britanike për tregti Catherine Ashton për përfaqësuese të lartë për politik të jashtme. Kryetari i parë i BE-së është lider i 27 vendeve anëtare të BE-së, ndërsa znj. Ashton, është përfaqësuesja e lartë për politikë të jashtme, respektivisht ministrja e parë e Punëve të Jashtme në BE.

Të dy këto personalitete sikurse edhe shumë të ngjashëm sikur të ishin në pozitën e tyre nuk do të kalonin ‘testin’ pa u analizuar personaliteti tyre edhe në parametra më të hollësishëm nga analistët e ndryshëm. Gazeta prestigjioze “The Economist”

ardhjen e Herman Van Romphuy'it dhe Catherine Ashton e sheh si me skepticizëm. Duke i quajtur si dy figura minore të dy personalitet në fjalë, gazeta e cituar bënë edhe një përmbledhje të karrierës së tyre duke i përmend si personalitete jo kompetente për pozitën që kanë. Gjithnjë sipas gazetës “The Economist” Van Romphuy, njihet si një shkrintar asket i stilit “haiku” dhe një katolik i devotshëm, por i pa përvojë në samitet e BE-së. Ka vite të tëra të trajnimit në menaxhimin e partnerëve grindavecë, falë shërbimit shumë vjeçar në qeveritë shumë gjuhësore koalicionet e Belgjikës. Bile edhe vet përkrahësit e tij pranojnë se ai ka shumë pak karizëm”. Në anën tjetër, Lady Ashton erdhi në Bruksel nga një karrierë e kaluar si e emëruar e Partisë Laburiste. E emëruar në Dhomën e Lordëve, ajo kishte pasur poste të vogla ministre para se të bëhej lider i dhomës së lart të parlamentit... ironikisht, njëri nga krimet më të mëdha në sytë e zotërinjve të saj politikë, ishte “udhëheqja” e Marrëveshjes së Lisbonës nëpër Dhomën e Lordëve. Përfundimisht ajo nuk ka përvojë në politikën e jashtme” përfundon përshtkrimin “The Economist”.

Sidoqoftë, kjo ishte vetëm një kronologji e gazetës “The Economist” rreth dy personaliteteve më “in” në politikën e BE-së, figura të cilat kanë



ngjallë dhe shuar aspirata të shumë shteteve të cilat mbajnë kokën nga Evropa.

Në shekullin tonë, tonin e debatit publik e japin ata që shqetësohen për risit. Nëse e hedhim vështrimin më tej, sado që për disa shtete si Francën Gjermanin e edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dy figurat kryesore të politikës së BE-së mund të jenë më meritoret për këto pozita, për disa shtete që janë në pritje tash e sa vite të futjes së tyre në familjen e madhe evropiane, janë figura që shihen me rezervë. Që në momentin kur shtetet e BE-së bënë publike Romphy'n dhe Ashtonin, mediat botërore në veçanti mediet turke bënë një tip kryqëzate mediale rreth këtyre personaliteteve. Gazetat turke figurën Romphy e shihnin si njeriun adekuat të politikës evropiane, por kundër aspiratave turke. Mesazhi i sjell nga Romphy për politikë në mes Turqisë dhe BE-së është i thjeshtë e megjithatë i fuqishëm. Logjika e tij për një politik kundër Turqisë ishte qysh atëherë kur Ramphy ishte Kryeministër belg. Mesazhi tij para pesë vitesh se "Turqia nuk është pjesë e Evropës dhe kurrë nuk do të jetë pjesë e saj... vlerat universale të cilat janë në forcat e Evropës, dhe të cilat janë çështje fundamentale të krishterimit, do

të humbin fuqinë me një shtet të hapur islam siç është Turqia" ngjalli komente dhe reagime te intelektualët turq.

Gazetat turke kishin vërsuar të premtën e kaluar me tituj skandaloz për figurën Ramphy duke e cilësuar si anti turk. Në një nga të përditshmet e Ankarasë në ballin shkruhej "Presidenti i parë i BE-së anti turk". "Është e vështirë të komentoj seleksionimin e tij në një rrugë të arsyeshme, por nuk e shoh që ka ndikim direkt në këtë kohë të shkurtër" u shpreh Suat Kiniklioglu deputet nga AK parti "Shpresoj që ai të rishikoj panoramën e tij në kohë të shkurtër. Por nuk mund të jem optimist" sa i përket znj. Ashton, Kiniklioglu komenton se ajo ka një pamje të mirë për Turqinë. Shikuar më tutje, profesori i Universitetit të Ankarasë për Marrëdhënie Ndërkombëtare me Lindjen e Mesme Hysein Bagci, Van Ramphy'n e sheh si; "kandidat kompromisi, i vënë në këtë pozitë me përkrahjen e Francës dhe Gjermanisë, por ky aspak një lajm i mirë për Turqinë".

Aversioni dhe pasqyrimi negativ për figurën Ramphy nga politikanë turq vije pikërisht nga shkakun se Ramphy është një demokristian i cili deklaratën e tij të bërë në dhjetor të 2004 nuk e kishte aspak të matur karshi

Turqisë e cila aspiron që në një të ardhme të afërt të jetë pjesë e familjes së madhe evropiane. Sidoqoftë, Ramphy pas marrjes së postit të liderit të BE-së duket se diçka ka "ndryshuar" në politikën e tij. I pyetur nëse ende është në pasqyrimin e parakohshëm për Turqinë, në konferencën e së premtes ai deklaroi se; "pasqyrimi i tij i më parshim është i "parëndësishëm" dhe në rolin e tij të ri do të përpiqet për më shumë konsensus sa më shumë që të jetë e mundur për pjesëmarrje shtetërore"

Retrospektivë:

Turqia ka filluar bisedimet për t'u bërë anëtare e BE-së që nga 3 tetori 2005. Në një konferencë mbi Marrëdhëniet e Komunitetit Evropian me Turqinë, të mbajtur në Stamboll në dhjetor 1989, fill pas rënies së Murit të Berlinit, përmban pesë argumente kryesore. Tre të fundit kanë më shumë domethënie sepse potencohet se; 1) Faktorët qytetrimorë dhe historikë dhe jo faktorët ekonomik do të jenë vendimtar gjatë procesit të marrjes në shqyrtim nga Komuniteti Evropian të kërkesës së Turqisë për anëtarësim të plotë, 2) Udhëheqësit evropian të cilët besojnë kokëfortësisht në një

epërsi qytetrimor euro – centrike nuk janë të gatshëm të shohin një vend mysliman në Evropë dhe 3) Ky iluzion egocentrik i njeriut perëndimor, ashtu siç është paraqitur nga Arnold Toynbee, është pengesa kryesore për një bashkëjetesë pluraliste në Evropë.

Turqia, ashtu edhe siç e ka cilësuar Presidenti Barack Obama, përkufizohet si "urë" mes Lindjes dhe Perëndimit ndërsa Ministri i Punëve të Jashtme i Turqisë Ahmet Davutogllu, parapëlqen shprehjen "shtet qendër" gjithnjë sipas këtij të fundit; "të qenët vend qendror në të njëjtën kohë e ngërthen në vete edhe të qenët urë. Turqia, shikuar nga këndi i koncepteve strategjike ndërkombëtare, është në qendër të Euroazisë, por mbi rrugët kalimtare Veri – Jug dhe Lindje – Perëndim. Pra, urë, por në një vend qendror. Domethënë, asgjë përreth Turqisë s'mund të kuptohet pa Turqinë".

Përfundimisht, le të shpresojmë se Turqia do të gjejë edhe një zgjidhje për Evropën. Për të përdorur një frazë shabllone nuk është e lehtë të gjesht zgjidhje. Në vitet e '40, ajo do të ishte e qartë: luftoni për liri dhe integritet, por në këtë shekull njerëzit janë të ngopur me luftëra dhe rruga e paqes është shpresa e së ardhmes.



Format e muzikës fetare (3)

Abaz jahja

Salâ ose salat në gjuhën shqipe do të thotë: lutje, ndërsa në terminologjinë e muzikës fetare quhen veprat të cilat janë të kompozuar me qëllim të përkujtimit të pejgamberit tonë Muhammedit a.s, ku bëhet lutje për të duke dëshiruar nga Allahu f.p (rahmet- mëshirë) dhe (salat-shpëtim) për të dërguarin.

Deri para disa viteve salati thirrej në mëngjes para thirrjes së ezanit të sabahut, ndërsa në drekë, ikindi dhe jaci thirrej pas ezanit. Viteve të fundit kjo traditë të humb efektin e vet dhe nëpër disa vende të shteteve Islame salati më së shumti thirret ditën e hënë dhe të pemten, si dhe në ditët dhe netët e mëdhaja sipas kalendarit hixhrij si dhe në raste të kur ndron jetë ndonjë besimtarë.

Sipas kësaj edhe salatet kanë emra sipas leximit të kohës:

1. SALATI I SABAHUT

Edhe pse ka disa mendime që këtë e ka kompozuar kompozitori i madh Buhurizade Mustafa Itri efendiu, përsëri të dhënat vërtetojnë se kompozitori i salatit të sabahut është Hatib Zakiri Hasan Efendiu.

Teksti i salatit të sabahut përbëhet prej 3 pjesëve

Essalatu veselamu alejk;
Ja sejjidena Ja resulal-lah;
Ja sejjidena Ja habibal-lah;
Ja sejjidena Ja nebijal-lah;
Ja sejjidena Ja hajrehalkil-lah;
Ja sejjidena Ja nure arshil-lah;
All-llah, All-llah, All-llah, Mevla Hu
Ky salat është i kompozuar në mekamin Dilkeshhaveran.

2. SALATI I XHUMASË DHE BAJRAMEVE

Kjo formë e salatit lexohej para namazit të xhumasë dhe para namazeve të Bajramit nga ana e muezinëve të cilët e lexonin në duet. Salati është i kompozuar poashtu nga ana e Hatib Zakiri Hasan efendiut edhe atë në mekamin BAJATI. Teksti i salatit të xhumasë dhe Bajrameve është si vijon:

Ja Mevla All-llah;
Lejsel Idu limen lebi'sel xhedid
In-nemel I'du limen hafe minel vei'd;
Ve Sali ve selem ala esadi ve eshrefi nuri
xhemiil enbiai vel murselin;
Velhamdulilahi rabble alemin

“

“Këtu në vendin tonë kjo traditë është ndërprerë në disa vende por në disa vende ende vazhdon që të jetoj, por leximi i salatit në kohën e sodit ka pësuar disa ndryshime nga ana e ekzekutimit. Me fjalë tjera nuk lexohet origjinali i salatit të cilin e ka kompozuar Hatib Zakiriu.”

Pjesa e parë lexohet bashkërisht në mënyrë korale nga ana e muezinëve;

Pjesa e dytë përbëhet prej pesë fjalëve, çdo fjali fillon me “ Ja Allah” dhe pastaj vazhdon përsëri një solist;

Pjesa e tretë lexohet nga ana e korit; dhe Pjesa e katërt përfundon salati.

3. SALATI I XHENAZES (TË VDEKURIT)

Pasi që merret lajmi për të vdekurin, salati që shërben për informimin e shoqërisë myslimane me rastin e vdekjes së një besimtari. Ky salat ndahet në dy lloje:

Salati i xhenazes që lexohet në minare;

Ky salat shërben për të treguar dhe informuar se kurë do të falet xhenazeja.

Sipas disa të dhënave mësojmë se kjo traditë për herë të parë është praktikuar në Egjipt në kohën e Fatimijëve. Në kohën e sodit ky salat lexohet dy tre orë më herët para kohës së rregullt të namazit për të treguar se kur do të falet namazi i xhenazes. Duhet të theksojmë se kjo prej vendit në vend ndryshon dhe mvarret sipas kushteve dhe rrethanave të vendit. Këtu në vendin tonë kjo traditë është ndërprerë në disa vende por në disa vende ende

vazhdon që të jetoj, por leximi i salatit në kohën e sodit ka pësuar disa ndryshime të interpretimit nga ana e ekzekutuesve. Me fjalë tjera nuk lexohet origjinali i salatit të cilin e ka kompozuar Hatib Zakiriu.

Salati i cili lexohej pas namazit të xhenazes;

Fillimi i përcjelljes së kufomës prej vendit ku kryhet falja e namazit të xhenazes e deri tek përcjellja te varezat. Kjo lexohej nga ana e tërë xhematit si një lloj zikri. Po ashtu edhe këtë e ka kompozuar i mirënjohuri kompozitor i muzikës fetare Hatib Zakiriu në mekamin HUSEJNI. Teksti është si vijon:

La ilahe il-la-llah vahdehu la sherikeleh

ve la nadhireleh, Muhammedun eminul-lahi hakkan ve sidka, Allahumme sal ala sejjidina Muhammedin ve ala;

Ve ala ali Muhammed;

Ve sal-li ve sel-lem ala esadi ve eshrefi nuri xhemi enbiai vel murselin;

Vel-hamdul-lahi rabble Alemin.

Pjesa e parë dhe e tretë lexohet nga një person(solo) ndërsa pjesa e dytë dhe e katërt në mënyrë korale. Kjo poashtu edhe një herë lexohej pas varrimit dhe pas kësaj njërezit largoheshin nga varrezat.

4. SALATI UMMIJE

Lexohet nëpër disa ceremoni fetare duke filluar prej xhamisë por edhe jasht xhamisë nëpër tubime dhe manifestime të ndryshme. Poashtu, lexohet në ditët dhe netët më me vlerë, e posaçërisht gjatë muajit të ramazanit gjatë faljes të namazit të Teravisë.

Kjo vepër tani që ne e kemi në dorë është vepër e kompozitorit të madhë Buhurizade Mustafa Itri Efendiu që është e kompozuar në mekamin SEGAAH. Duhet të theksojmë se kemi edhe disa slete të këtij lloji që lexohen nga ana e disa tarikateve të ndryshme.

Është karakteristike se ky salat është pranuar nga e tërë gjeografia Islame dhe sot e kësaj dite është duke u lexuar dhe praktikuar posaçërisht në ramazan gjatë faljes së namazit të Teravisë.

SEGAAH SALAT-I UMMIYE BESTE: HATIB ZAKIRI
HASAN EFENDI

Al la hum me sal li a la sey yi
si na ku han me di nin ne biy yi
un niy yi ve a la a li li
ve sah bi hi ve sel lin

Allahümme salli ala Seyyidina
Muhammedalin nebiyyi ummiyyi ve ala
Allahi ve sahbihii ve sellim.

Problemi i të ashtuquajturve të pandryshuara (konstante) dhe të ndryshuara (jokonstante) në Islam

Naser Ramadani

Nuk ka dyshim se shprehjet “të ndryshuara” dhe “të pandryshuara” janë prej termeve bashkëkohore që përdoren në këtë kohë, madje në vitet e fundit. Sado që të lexojmë ose të dëgjojmë prej të parëve tanë që janë marrë me analizimin e problemeve, nuk do të hasim askund se kanë përdorur këso shprehje. Po, këto lindën në këtë kohë, ndoshta për t’u shprehur rreth ndonjë problemi duke dëshiruar zgjidhje për të.

Edhe ne, do t’i përdorim këto shprehje në këtë mënyrë, që të ecim përpara e të shohim se sa përputhet me Islamin e vërtetë që është zbritur nga Allahu xh.sh.

Ne, kur tentojmë ta kuptojmë ato që quhen të ndryshuara dhe të pandryshuara në Islam, menjëherë paramendohet se Islami përmban dy lloje të të vërtetave:

Lloji i parë: Të vërteta stabile që nuk mund të ndërrohen ose të ndryshohen, në asnjë kohë e në asnjë vend.

Lloji i dytë: Të vërteta tjera që mund të ndërrohen ose të ndryshohen.

Nga ne kërkohet që të besojmë se që të dy llojet janë prej thelbit të Islamit.. Vallë a është çështja kështu në realitet?

Para se të zhytemi në kuptimin e tyre, është patjetër ta pastrojmë këtë çështje.

Islami është një grup i të vërtetave stabile, qofshin në besim ose në sjellje. Pastaj, ne nuk mundemi ta quajmë të vërtetën të vërtetë përpos nëse është stabile dhe e pandryshuar. Çdo gjë që i nënshtrohet ndryshimit e që nuk është stabil, nuk mund të quhet e vërtetë. Më parë kanë bërë dallimin ndërmjet të vërtetës dhe jo të vërtetës me



atë se e vërteta është ajo që nuk ndryshon, ndërsa jo e vërteta është ajo që nuk mbetet në një gjendje, por ndryshon.

Nëse është kështu, atëherë mund të kuptojmë se të ndryshueshmet nuk mund të hyjnë në grupin e të vërtetave islame.

Do të sjell disa shembuj për ta sqaruar këtë çështje:

Të gjithë e dimë se prej të vërtetave islame është edhe ajo se njeriu është rob i Allahut xh.sh. Ky njeri pra, cilësohet me plotëkuptimin e fjalës robërim ndaj Allahut. Padyshim se kjo është e vërtetë që nuk ndryshohet dhe se është stabile. Po ashtu pasojat e saj janë stabile, që do të thotë se puna e njeriut për të qenë rob i Allahut, me gjithë degët e tij, po ashtu duhet të jetë stabile.

Prej të vërtetave esenciale në Islam është se Allahu është Sundues i gjithë hapësirës në tërësi, duke përfshirë edhe pjesët më të vogla. Nëse kjo e vërtetë është stabile dhe nuk ndryshon, me ndryshimin e kohës dhe të vendit, nga kjo pason se edhe nënshtueshmëria e njeriut ndaj këtij Allahu si Zot dhe të vepruarit me programin që ia ka përgatitur Ai, poashtu është stabile dhe e pandryshueshme me ndryshimin e kohës dhe të vendit.

Sado që të zhytemi në botën e shkaqeve dhe pasojave që lindin nga to, dhe sa do që të hidhemi në ndikimin e materieve që duken, logjika e shëndoshë vendosë se ndikues i vërtetë është vetë Allahu xh.sh., sepse Ai është Krijues i shkaqeve. Pa marrë parasysh se në çfarë kohe ose çfarë vendi jemi, ne duhet të kemi parasysh këtë të vërtetë stabile. Pra, nënshtrimi i ynë ndaj kësaj të vërtete të amshueshme, (nënshtrimi ndaj Allahut), edhe ajo po

ashtu duhet të jetë e amshueshme.

Prej të vërtetave esenciale që marrin pjesë në grupin e rregullave të sjelljes është edhe ajo se drejtësia në bashkëpunim, është siguri i patjetërsueshëm për realizimin e interesave të njerëzve në mënyrë individuale ose shoqërore. Kjo është e vërtetë stabile dhe e pandryshuar gjatë tërë historisë. Pra, nënshtrimi jonë ndaj kësaj të vërtete, po ashtu duhet të jetë e vazhdueshme dhe stabile.

Islami, a është diç tjetër pos kësaj?..Besim që reflektohen nga të vërtetat stabile dhe ligje e dispozita që dalin nga drejtësia e cila gjithashtu është stabile dhe e pandryshuar. Po, ky është Islami.

Nëse është kështu mund të konkludojmë rreth një vendimi i cili thotë se Islami - duke përfshirë besimin dhe dispozitat- në tërësi është stabil dhe i pandryshuar.

Mirëpo, edhe pse ky realitet është i qartë, ekzistojnë disa persona që janë të vendosur se Islami përmbanë shtylla stabile, të pandryshuara dhe në të njëjtën kohë përmban degë jostabile, të ndryshuara. Ata persona, për dëshmi sjellin thëniet e dijetarëve, si: "Aty ku është interesi, aty është sheriat i Allahut", "Ndryshojnë dispozitat me ndryshimin e kohës".

Përgjigjemi duke e përsëritur atë që e thamë, se të vërtetat islame gjithnjë janë stabile dhe të vazhdueshme. Mirëpo, këto të vërteta janë të lidhura me mënyra të ndryshme të praktikës në sjelljet tona të jetës. Këto sjellje praktike absolutisht nuk marrin pjesë në atë që i quajmë të vërteta islame. Këto të vërteta stabile na udhëzojnë se si të përdorim këto sjellje të jetës dhe këto aktivitete civilizuese në përputhshmëri të plotë me ndikimin e këtyre të vërtetave, do të thotë në përputhshmëri të plotë me robërimin e njeriut ndaj Allahut xh.sh. dhe me ecjen në programin e drejtësisë që e ka përgatitur Allahu xh.sh. Kjo na mundëson të kuptojmë se këto aktivitete jetësore të ndryshme, nuk marrin pjesë në të vërtetat stabile të Islamit, por këto të vërteta mbisundojnë ndaj këtyre

aktiviteteve të ndryshme, që do të thotë se nuk mund të lëvizin përpos nën ndikimin e këtyre të vërtetave stabile.

Themi ndryshe: Të gjitha të vërtetat islame janë stabile që nuk pranojnë ndryshim dhe evoluim, ato i nxisin muslimanët që t'i zhvillojnë aktivitetet e tyre, duke ecur përpara, në përputhshmëri të plotë me interesat e tyre që ua ka caktuar Islami. Këto aktivitete ose interesa asnjëherë nuk kanë marrë pjesë në të vërtetat islame. Është dallim i madh mes asaj se Islami evoluohet (zhvillohet) duke iu nënshtruar përmirësimeve dhe reformave (ky është gabim i hatashëm) dhe mes asaj se Islami është stabil dhe i pandryshuar në të gjitha të vërtetat dhe dispozitat e tij, mirëpo i nxitë muslimanët që të bëjnë reforma në jetën e tyre që është në përputhshmëri të plotë me projektin e caktuar (ky është realitet që nuk dyshohet).

Sikur të mendonin pak ata të cilët thonë se Islami evoluohet dhe zhvillohet, do ta dinin se ajo fe e cila zhvillohet me kohë, zhduket. Ndërsa, ajo fe e cila i nxitë ithtarët e saj që

të bëjnë reforma e të zhvillohen brenda përbrenda parimeve stabile dhe të pandryshuara, është stabile sepse parimet, shtyllat dhe dispozitat e saj janë stabile.

Kështu ishte sjellja e muslimanëve me islamin e tyre gjatë tre shekujve të parë të hixhretit. Ata nuk kanë ndryshuar asgjë prej dispozitave të tij mirëpo, në të njëjtën kohë e kanë reformuar veten e tyre nën udhëzimin e kësaj feje, më shumë se sa e kanë reformuar ata muslimanë që kanë ardhur pas tyre deri më sot.

Le të sjellim disa shembuj për sqarimin e kësaj të vërtete:


1. Prej të vërtetave stabile dhe të pandryshuara të islamit është kryerja e obligimit të da'ves për në rrugë të Allahut, duke i njoftuar njerëzit me Islam, e mandej duke i urdhëruar kah të mirat dhe duke i ndaluar prej të këqijave. Kjo është një ndër çështjet esenciale në Islam ku dëshmon edhe ajeti kur'anor: **"Ti thirr për në rrugën e Zotit tënd me urtësi e këshillë të mirë."** En-Nahl: 125. Pra, ky është vendim stabil që nuk

pranon ndryshim.

Mirëpo, ky vendim ka lidhje me aktivitete të llojllojshme në jetën tonë të përditshme, ka lidhje me ndërtimin e universiteteve, ndërtimin e institucioneve edukativo-arsimore, punën e palodhshme rreth nxjerrjes së veprave shkencore që shërbejnë për këtë vendim, poashtu ka lidhje me themelimin e shtëpive botuese, mjeteve të informimit, krijimin e ambientit të përshtatshëm për diskutime etj. E gjithë kjo i nënshtrohet zhvillimit dhe evoluimit, nën ndikimin e ndryshimeve të vendit dhe kohës, ndryshimit të mjeteve sipas përparimit ose prapambeturisë civilizuese.

Vendimi i cili ka lidhje me këtë aktivitet, krahas stabilitetit të tij vazhdimisht, ai i nxitë muslimanët që t'i zhvillojnë këto aktivitete shërbyese sa të munden dhe t'i ringjallin në çdo periudhë kohore, në mënyrë që siguron vazhdimësinë e këtij vendimi.

2. Prej të vërtetave stabile në Islam është edhe ajo se njeriu ka të drejtë që të kënaqet me të gjitha gjërat që ia ka lejuar Allahu xh.sh.



Mirëpo, në të njëjtën kohë e ka për obligim që të lejuarat mos t'i bëjë mjet për të rënë në haram dhe atë me anë të lavdit, mendjemadhësisë, israfit (harxhim i tepërt) etj. Kjo është një ndër parimet që kanë bazë në Kur'anin Famëlartë, si p.sh. ajetet kur'anore:

“Thuaj: Kush i ndaloi bukuritë dhe ushqimet e mira që Allahu i krijoi për robtë e vet” El-A'raf: 32. **“Hani dhe pini e mos teproni”** El-A'raf: 31,

“Hani nga begatitë e Zotit dhe falenderonju Atij. Qytet i mirë dhe Zot mëkatfalës” Sebe': 15.

Ky vendim me të gjitha kriteret e tij, është një ndër vendimet stabile që nuk ndryshojnë asnjëherë. Mirëpo, ky aktivitet mbisundon në shumë aktivitete të llojllojshme në jetën tonë dhe hapë horizonte të pakufizuara të zhvillimit jetësor, brenda hapësirës së këtij vendimi. Unë p.sh. kam mundësi nën ndikimin e këtij vendimi të zgjedh prej llojeve të rrobeve çka të dua, do të thotë të veshi xhybe ose takëm (pallto e pantallona), mandej, e drejta ime është që t'i kam të gjata deri te zogu i këmbës ose të shkutëra deri nën gjunjë, poashtu kam të drejtë të veshi çfarë kualiteti të rrobeve dua. E drejta ime është që ta veshi (shtrijë) shtëpinë në mënyrën që përputhet me dëshirën time, me kusht që t'i përmbahet kushteve dhe kriterëve që kanë të bëjnë me vendimin sheriatik të asaj çështje. Ky vendim që i përmbahet kriterëve dhe kushteve të caktuara është stabil dhe i pandryshuar.

Mendjemadhësia në rrobën që e veshë, ose ushqimin që e hanë, ose mënyrën e shtrijës që ia bënë shtëpisë, gjithmonë është haram.

Kur arabët në fillim të Islamit, zgjatjen e rrobeve dhe shtrirjen e tyre për toke e bënë për mendjemadhësi, atëherë ishte haram për arsye se bëhej për qëllim të ndaluar. Po sikur tradita të shndërrohet në të kundërtën, që do të thotë se shkurtimi i rrobeve të bëhet për mendjemadhësi, atëherë ajo do të bëhet haram.

Pra, më duket se është e qartë se vendimi që ndalon kryelartësinë dhe mendjemadhësinë është stabil



dhe i pandryshuar, ku gjitha adetet dhe traditat sillen përreth tij. Poashtu mund të vëresh gabimin e atyre që i vendosin adetet e ndryshuara (jostabile) në vend të gjërave të pandryshuara (stabile) e në bazë të saj mendojnë se vendimet islame zhvillohen dhe ndryshohen. Sikur të mendonin, kanë pasur mundësi që ta kuptojnë se praktikimet e vendimit janë ato që zhvillohen e ndryshohen e jo vendimi elementar, siç është mendjemadhësia në të gjitha rastet.

Këtë e vërteton edhe hadithi i Muhamedit a.s. ku thotë: *“Kush i ngre rrobat me mendjemadhësi, Allahu nuk e shikon atë ditën e gjykimit”*.) Këtë e sqaron ose e përkufizon edhe ajo se Ebu Bekri r.a. kur dëgjoi këtë hadith u frikësua se ndoshta mbajtja e tyre që e kishte bërë një herë, mos është shkaktar që të jetë në mesin e atyre që do t'i përfshijë ky dënim. Erdhi te Muhamedi a.s. dhe e pyeti, ndërsa ai e qetësoi

duke i thënë: *“Por ti nuk i mbanë për mendjemadhësi”*.

3. Prej vendimeve dhe parimeve stabile dhe të pandryshuara në Islam është edhe ajo se: *“Kush i përngjanë një popullit është prej tyre”*.) Disa prej njerëzve mendojnë se ky vendim ndryshon me kohë mirëpo, sikur të mendonin, do të dinin se ajo që ndryshon është praktikimi i këtij vendimi e jo vetë vendimi.

Rrobot që i veshin shumica jonë sot, kanë ardhur te ne një ditë prej ditëve me qëllim të ngjashmërisë dhe imitimit asokohe. Pa dyshim, se bartja e tyre në atë kohë me atë qëllim ka qenë haram. Mirëpo, sot pasi që qëllimi është shkrirë për shkak të kohës së gjatë, ndalimi është larguar dhe ka hyrë në grupin e gjërave të lejuara. Është e qartë se ajo që ka ndryshuar, është se bartësi a ka për qëllim imitimin dhe ngjashmërinë ose jo, ndërsa vendimi është stabil dhe i pandryshuar. Sa

herë që të gjendet qëllimi i ngjashmërisë dhe imitimit, bëhet haram. Atëherë kur të largohet ky qëllim largohet edhe ndalimi i tij.

Të ngjashme me rrobot në këtë vendim janë edhe mënyrat e ndryshme në ndërtimin e banesave, prodhimin e mjeteve transferuese, shfrytëzimi i gjërave më të bukura dhe më të rehatshme për rregullimin dhe veshjen e shtëpisë, etj., që marrin pjesë në grupin e gjërave civilizuese të lejuara. E gjithë kjo merr pjesë në ajetin kur'anor: **“Thuaj: Kush i ndaloi bukuritë dhe ushqimet e mira që Allahu i krijoi për robtë e vet”** El-A'raf: 32. Sikur në të gjitha këto gjëra të kihet për qëllim ngjashmëria dhe imitimi i mosbesimtarëve, ose të kihet për qëllim mendjemadhësia ndaj të tjerëve, atëherë është e ndaluar-haram.

Ende, sot e kësaj dite shohim dialogë të pafrytshme në disa vende rreth mbulesës së femrës; se a duhet të jetë me xhakët dhe fund ose me mantel dhe se cila prej tyre përputhet me vendimin e sheriatit. Ky dialog është rritur aq shumë mes burrave dhe grave derisa janë kacafytur dhe kanë urrejtur njëri-tjetrin. Me këtë, që të dyja palët kanë rënë në atë që është haram, sipas gjithë dijetarëve, pa vërejtur asnjëra prej palëve diskutuese.

Sikur të gjithë të mendonin në vendimin e sheriatit, do të gjenin se vendimi stabil dhe i pandryshuar në sheriat është që femra të vishet me rrobe që e mbulon tërë trupin e saj, me kusht që të mos jetë më e shkurtë se deri te zogu i këmbës. Pas kësaj, e drejta jote është që këto rrobe t'i emërtosh si të duash, sepse ndryshimi i emrit nuk ndryshon vendimin.

4. Një shembull tjetër për ta sqaruar këtë të vërtetë, se të gjitha parimet dhe vendimet islame janë stabile dhe të pandryshueshme. Besimtari ka për obligim ta dijë se Allahu xh.sh. është larg ngjashmërisë me krijesat e Tij. Sa do që të zhvillohen mendimet tona ose të zgjerohen dituritë tona, ky besim ngelë bazë stabile dhe e pandryshuar prej bazave të Islamit. Burim i këtij besimi është ajeti i qartë kur'anor:

“Asnjë send nuk është si Ai; Ai është dëgjuesi, shikuesi” Esh-Shura: 11. Poashtu ajeti kur’anor: **“Dhe Atij askush nuk i është i barabartë”**. El-Ihlas: 4.

Nëse ky besim është plotësuar te ti, atëherë para teje gjendet një hapësirë e madhe ku mund njeriu të përdorë ixhtihadin e tij, sepse ixhtihadi që bëhet rreth këtyre gjërave nuk konsiderohet prej esencës së fesë. Do të thotë, nëse e lexon ajetin kur’anor: **“...se dora e Allahut është mbi duart e tyre...”** El-Fet-h: 10, ke të drejtë të marësh mendimin e atyre që thonë se Allahu ka dorë, që përputhet me cilësitë e Tij, duke mos pranuar në asnjë mënyrë ngjashmëri ose të mendosh sikur që thonë ata që bëjnë te’vil e të komentosh fjalën “dorë” me fuqi. E gjithë kjo për arsye se prej gjërave esenciale dhe bazave të kësaj feje që kanë të bëjnë me këtë ajet dhe ajetet e ngjashme me të, është të besosh se Allahu ka dorë, sikur që ka thënë për vete dhe në të njëjtën kohë është larg çdo ngjashmërie me krijesat e veta. Ndërsa pas kësaj, qoftë besim ashtu siç ka thënë duke e lënë realitetin në diturinë e Allahut, ose komentimin e tij në ndonjë aspekt të pranuar gjuhësisht, ato janë mendime të muxhtehidëve që u lejohet atyre të lëvizin në këtë hapësirë duke u bazuar në rrethanat aktuale dhe në të dhënat gjuhësore. E gjithë kjo nuk merr pjesë në parimet esenciale e të pandryshuara të besimit.

Ky është mendimi më i saktë dhe mesatar rreth ajeteve dhe haditheve të paqarta (muteshabih). Këtë të vërtetë e tregon edhe imam El-Hattabiu i cili në bazë të studimeve të shumta që i ka bërë, ka arritur që të formojë një urë shkencore të besimit që lidhë mes dy periudhave: asaj selefë dhe asaj halefe, sepse vetë imam El-Hattabiu ka qenë prej dijetarëve më të njohur të shekullit të katërt të hixhretit, që konsiderohet si ndarje mes dy periudhave.

Mirëpo, disa njerëz sot gjërat që marrin pjesë në hapësirën e ixhtihadit i konsiderojnë si bazë që nuk ndryshohen dhe iu kanë përzier gjërat që janë bazë me

ato që konsiderohen si degë, duke u larguar me këtë nga vetë programi i selefëve edhe pse flasin në emër të tyre.

Shih këtë shembull që e sqaron këtë që po e them:

Njëri prej atyre njerëzve i thotë shokut të tij: Ku është Allahu? I pyeturi për të kaluar në këtë provim të rëndë dhe për të mos u akuzuar me kufr, duhet të përgjigjet: Lart..! Është e preferuar që të sinjalizojë me gishtin e tij drejt qiellit. Sikur i pyeturi t’i thoshte: Mirëpo, lart, posht, para, mbrapa, që të gjitha janë relative e në bazë të saj edhe vet ana përmban kuptim relativ, sepse ajo që në veri është lartë, në jug është posht, atëherë ky do të akuzohet me bid’at të rrezikshëm. Ku janë marrë selefët me kësilloj gjërash anësore që nuk ka treguar për to as Kur’ani e as sunneti i Muhamedit a.s.? Në cilin ajet kur’anor, Allahu xh.sh. e ka kufizuar veten e Tij në ndonjë anë?

Esenca e besimit është të bindesh në fjalën e Allahut xh.sh.: **“Ai është mbizotërues ndaj robëve të Tij”** El-En’am: 18. Me anë të këtij ajeti duhet të besosh se Allahu është lart mirëpo, e drejta jote është që të bësh ixhtihad se çka ka për qëllim me këtë lartësi, brenda kufijve të këtij besimi esencial dhe duke u bazuar në rregullat e komentimit të ajeteve.

Tash, le të kthehemi në esencën e bisedës tonë: Islami me të gjitha gjërat që i ndërthhen -qofshin: rregulla të

besimit ose parime ose vendime- është stabil dhe i pandryshueshëm. Ato janë gjëra të vërteta, e të vërtetat - logjikisht- nuk pranojnë ndryshim dhe zhvillim. Mirëpo, puna e këtyre të vërtetave stabile është që njeriu musliman ta nxisin gjithnjë që jetën e tij mendore, civilizuese etj. ta zhvillojë në mënyrë të re, në përputhshmëri me sistemin e caktuar që e rregullojnë ato të vërteta stabile.

Kuptuam më parë se ndryshimet mendore, ndërtimore dhe civilizuese nuk marrin pjesë në grupin e të vërtetave islame por ato janë frutet e tij.

Prej urtësive të Allahut është se Islami nuk do të kishte mundësi që t’i nxisë muslimanët që ta përtërijnë jetën e tyre në vazhdimësi përpos atëherë kur vet ai është stabil e i pandryshuar, që nuk pranon zhvillim e as ndryshim.

Muhamedi a.s. thotë: **“Allahu në fillim të çdo shekulli, këtij ummeti i dërgon person që ia përtërinë fenë”**.) Muhamedi a.s. me fjalën: **“Ia përtërinë atij fenë”** ka për qëllim largimin e pluhurit, risive dhe tepricave që kanë lindur brenda asaj periudhe, e të kthehet përsëri në origjinën e tij të pastërt. Në asnjë mënyrë nuk duhet të kuptohet fjala e Muhamedit a.s. se ka për qëllim përtrirjen me anë të reformimit dhe zhvillimit siç dëshirojnë disa njerëz.

Shprehja **“reforma fetare”**, e huazuar nga perëndimi që t’i

mvishet Islamit, nuk ka vend në të vërtetat islame, bile fjala **“të vërtetat”** largon çdo mundësi për reformim, sepse mes fjalës **“e vërtetë”** dhe **“reformë”** ka kundërshti të qartë që e kupton çdo i mençur. Perëndimi me anë të reformave fetare deshti që t’i drejtojë gjërat e shtrembëruara e jo që ta përmirësojë të vërtetën, sepse e vërteta nuk ka nevojë për përmirësim.

Kur disa njerëz një ditë prej ditëve tentuan që ta zhvillojnë veten me anë të zhvillimit të Islamit në njërin nga vendet islame arabe, mandej filluan zbatimin e saj nën mbykqirjen e Britanisë së Madhe. Me anë të kësaj nuk arritën gjë, përpos që e nxorrën veten prej mbrojtjes së Islamit dhe u hudhën në një prapambeturi të madhe.

Kush e di, ndoshta ndonjë dëm ndonjëherë sjell dobi, ndoshta me anë të dëmit mund të dallohet miku prej armikut.

Bazë e çdo gjëje është bindja e plotë se Allahu është më i mëshirshëm për njeriun se sa vet njeriu për veten e tij.

O Allah, na e shto bindjen në mëshirën Tënde që të kapemi edhe më shumë për udhëzimin Tënd dhe të jemi më vegjilent ndaj çdo dore që dëshiron që të na tradhtojë.

Artikull i nxjerrë nga libri: **“Ve hadhihi mushkilatuna”**, faq. 25-38, të autorit Muhamed Said Ramadan El-Buti. Botimi i tretë, 1414 h./1994, Damask.





Para një pune të rëndë

(Zejd ibn Thabit, as'hab)

Muhammed Ismail Sieni

Religjionet e mëdha botërore posedojnë librat e tyre fetarë, edhe islami nuk bën përjashtim, por në fakt islami është ndryshe nga religjionet tjera, sepse libri i islamit posedon cilësi për të cilat muslimanët besojnë se janë karakteristikë vetëm për ta. Midis këtyre cilësive të posaçme të librit të islamit, respektivisht Kurani fisnik mund të përmendim:

Çdo fjalë i është shpallur në mënyrë të drejtëpërdrejtë të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. dhe me të drejtë mund ta quajmë “fjalë e Zotit” në plotëkuptimin e fjalës.

Në islam dallimi është i qartë mes Kur'anit (fjalës së Zotit të shpallur përmes të Dërguarit) në njërin anë dhe hadithit (falëve dhe veprave të Dërguarit s.a.v.s) në anën tjetër. Kjo është diçka që nuk është karakteristikë e teksteve religjioze të fetëve tjera. Këtë mund ta shohim p.sh. kur ajetet që fillojnë me fjalën “kul” (thuj) në fakt ashtu edhe lexohen me shprehjen “kul”.

Kur'ani është i vetmi libër që është ruajtur në tërësi, si në

“I Dërguari i Allahut e dëgjoji leximin e Zejdit, dhe vërejtë se lexonte shumë pastër dhe në mënyrë precize, ashtu që tregoi një talent të rrallë lingvistik. Atëherë e urdhëroi ta mësoj gjuhën hebraishte, që të jetë në gjendje të komunikoj me hebretët.”

aspektin gojorë ashtu edhe në aspektin e të shkruarit. Sepse:

Mijëra e mijëra njerëz e kanë mësuar përmendsh Kur'anin që nga koha e Muhammedit a.s. dhe deri në ditët e sodit. Shumë nga këta njerëz edhe nuk flasin gjuhën arabe. Pra, edhe këtë duhet ta marrim parasysh, kur e dimë se Kurani përbëhet prej gjashtë mijë citateve (ajeteve).

Kur'ani është shkruar qysh në kohën e Muhammedit a.s. nën mbikëqyrjen dhe udhëzimet e tij, kjo është diçka që nuk ekziston në librat fetarë të feve tjera.

Kur'ani është libër i vetëm fetarë që ka shërbyer si kushtetutë e shumë shteteve gjatë historisë së islamit.

Këto janë vetëm disa nga karakteristikat që librit të islamit i japin vend të posaçëm.

Në mesin e atyre që muslimanët i janë falënderues

për shkrimin e Kur'anit është edhe Zejd ibn Thabit, një nga sekretarët e të Dërguarit s.a.v.s. Zejd ibn Thabit është i njohur sipas asaj se iu dha përgjegësia e tubimit të Kuranit në një libër të vetëm i quajtur Mushaf.

**RËFIMI MBI
ROLIN E ZEJDIT
TREGOHET KËSHTU:**

En-Neveer, nëna e Zejdit u tha disa prej kushërinjve të saj nga meshkujt që t'ia përmendin Muhammedit a.s. dëshirën e djalit të saj që të jetë afër tij çdo herë. Ata shkuan tek i Dërguari i Allahut s.a.v.s dhe i thanë: “O i Dërguari i Allahut ky djali jonë i ka mësuar përmendsh 17 sure nga shpallja, dhe i lexon ashtu siç të janë shpallur, ai është shumë i shkathët në lexim dhe shkrim. Dëshiron të jetë afër teje, dëgjoje nëse dëshiron.”

I Dërguari i Allahut e dëgjoji

leximin e Zejdit, dhe vërejtë se lexonte shumë pastër dhe në mënyrë precize, ashtu që tregoi një talent të rrallë lingvistik. Atëherë e urdhëroi ta mësoj gjuhën hebraishte, që të jetë në gjendje të komunikoj me hebretët.

Pas kësaj Zejdi mësoi edhe gjuhën siriane, dhe kështu bëhet përkthyesi kryesorë i të Dërguarit të Allahut s.a.v.s.

Dhe në fund heroi ynë bëhet njëri nga sekretarët kryesorë të Dërguarit s.a.v.s. që ishin të angazhuar me shkrimin e shpalljes.

Kjo i mundësoi Zejdit inteligjent që më për së afërmi të vështroj rrethanat e shpalljes së Kur'anit, kështu ishte referenca më e mirë mbi çështjet e Kur'anit pas vdekjes së të Dërguarit s.a.v.s.

Njohuria e thellë mbi Kur'anin kishte bërë që për të edhe ashabët më të njohur të kenë respekt të madh edhe pse ishte shumë më i ri se shumica e tyre (kishte vetëm 22 kur i Dërguari i Allahut u shpërngul në ahiret)

Historia na tregon se

Abdullah ibn Abbasi që njihet për diturinë e madhe në çështjet e fesë, njëherë e kishte parë Zejdin si e shalon kafshën, dhe iu afrua që ti ndihmoj. Zejdi nga respekti për të i tha: Mos u mundo, o kushëri i të Dërguarit të Allahut. Kurse në këtë Abdullahu ia ktheu: Kështu na kanë mësuar të sillemi me dijetarët tanë.

Nuk është çudi që pas luftës së Jemames, në kohën e halifes së parë, Zejdi u zgjodh si njeriu që do ta tuboj kuranin në një vend, i ndihmuar nga Omer ibn Hattabi.

Gjatë luftës në Jemame, u vranë një numër i madh i hafizëve, atëherë Omer ibn Hattabi filloi të brengoset për shkak se nëse vazhdon kështu gjatë luftimeve mund të vriten shumë hafiz dhe mund të ndodh që disa ajete, të njohur vetëm nga disa sahab mund të humbin me vdekjen e tyre. Kështu që i propozoi Ebu Bekrit që Kur'anin të tubohet në një libër të vetëm.

Në fillim Ebu Bekri nuk pranoi duke thënë: "Kjo është diçka që nuk e ka bërë Muhammedi a.s., por më vonë u bind që kjo ishte shumë e rëndësishme, sepse në kohën kur i Dërguari i Allahut ishte në këtë botë nuk kishte nevojë për një gjë të tillë, sepse burimi dhe transmetuesi i shpalljes ishte në mesin e tyre.

Halifja e dinte se Zejdi ishte njeriu më prioritarë për këtë punë. Dhe kështu i tha Zejdit: *Ti je djali i ri, i mençur dhe i besueshëm. Ke qenë edhe sekretarë i të Dërguarit s.a.v.s., dhe për këtë je zgjedhur ta tubosh kuranin.*

Zejdi tha: *Betohem në Allahun se më lehtë për mua do të ishte që të lëviz malet se sa kjo punë që më obliguan.*

Pas tubimit, Kur'anin u ruajt te halifja Ebu Bekri dhe pasuesi i tij Omeri r.a., i cili më vonë ia dha vajzës së tij, nënës së besimtarëve, e cila gjithashtu njiheshte për diturinë e thellë mbi Kur'anin, krahas asaj që ishte edhe nga të paktat që dinin lexim dhe shkrim në atë shoqëri.

Para se të hijmë në detalet e tubimit të Kuranit, është me rëndësi të potencojmë se Kurani është mësuar përmendsh nga shumë ashab të Dërguarit të Allahut s.a.v.s duke qenë ai gjallë. Gjithashtu është shkruar edhe nga ana e

sekretarëve të tij, prej të cilëve më i njohuri ishte Zejd ibn Thabit. Por me kalimin e kohës shumë nga këta sahab binin dëshmorë gjatë luftërave të muslimanëve me murtedët dhe pabesimtarët (në periudhën e hilafetit të Ebu Bekrit)

Ky ishte shkaku kryesorë që Omer ibn Hattabi i propozoi Ebu Bekrit tubimin e tekstit të Kur'anit. Kjo detyrë iu dha Zejdi ibn Thabitit, dhe kjo punë nënkuptonte tubimin e Kur'anit nga të gjitha tekstet që gjendeshin tek sahab të ndryshëm, vërtetimin e autenticitetit të tyre, renditjen e ajeteve dhe sureve sipas udhëzimeve të Dërguarit, Muhamedit a.s.

Edhe pse si shumica e sahabëve, Zejdi e dinte Kur'anin përmendsh, ai kujdesej që procedura e tubimit të shkoj sipas planit. Në pika të shkurtra procedura dukej kështu:

Secili që dinte ndonjë pjesë

përmendsh, vinte e lexonte, kurse nga ana e komisionit shkruheshe pjesa e lexuar. Por prapë se prapë nuk pranohej, nëse teksti nuk ishte dëgjuar drejtpërsëdrejti prej gojës së të Dërguarit të Allahut dhe, nëse ai teksti nuk ishte vërtetuar nga ana e tij në vitin e fundit të jetës së tij.

Ajetet dhe suret (kaptinat) janë shkruar sipas radhitjes së caktuar nga ana e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s.

Në mënyrë që të sigurohet autenticiteti, asnjë tekst nuk pranohej deri sa personi që vinte me tekstin me vete nuk i kishte edhe dy dëshmitarë që kishin qenë prezent në momentin kur personi e kishte dëgjuar nga i Dërguari i Allahut s.a.v.s.

Nëpërmjet kësaj procedure precize, komisioni i udhëhequr nga ana e Zejdit dhe i ndihmuar nga Omer ibn Hattabi, e tuboi tërë Kur'anin, i cili më pas është ruajtur tek halifja Ebu

Bekri r.a.

Pas tij është ruajtur tek Omeri si halife pasardhës, i cili më vonë ia dërgoi vajzës së tij Hafsës, nënës së besimtarëve (gruaja e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s.)

Kopjimi dhe dërgimi i Kuranit të tubuar nëpër qendrat islame ishte diçka që i pëlqente shumë halifes së tretë Othman ibn Afanit. Përsëri këtë detyrë e bëri heroji ynë, Zejd ibn Thabit, i ndihmuar nga ana e shumë ashabëve të të Dërguarit s.a.v.s.

Gjatë historisë kemi lexuar se i Dërguari i Allahut s.a.v.s ashabëve të tij u lejoi që ta lexojnë kuranin në dialektet e tyre, por pasi që shteti islam u përhap shumë ashabët u gjendën në vende të ndryshme. Secili lexonte Kur'anin sipas dialektit të tij.

Kjo shkaktoi huti në mesin e muslimanëve. Sidomos tek ata që sa kishin pranuar islam, dhe të cilët nuk dinin të bënin dallimin në shqiptim. Sa që vinin në konflikt rreth asaj se cili e lexon drejt.

Për t'i ikur hutesës dhe çrregullimit, halifja Othman ibn Affani u këshillua me ashabët, dhe mori vendimin historik mbi "versionin standard" të Kuranit ku secili obligohet ti përmbahet. I dërgoi njerëzit t'i sjellin tekstin që ishte tubuar në kohën e Ebu Bekrit, që ruhej te Hafsa, e veja e të Dërguarit s.a.v.s., dhe e urdhëroi komisionin në të cilin ishte edhe Zejdi, që ta kopjoj tekstin dhe ta dërgoj në të gjitha qendrat kryesore të shtetit islam.

Në atë moment kur u kopjua Kurani, halifja urdhëroi të shkatërrohen të gjitha kopjet tjera, përveç atyre që i kopjoi komisioni në krye me Zejd ibn Thabitin, duke siguruar në këtë mënyrë leximin të njëjtë të Kuranit, dhe në të njëjtën kohë duke mbrojtur atë nga devijimi dhe përleshjet mes muslimanëve për shkak të dallimeve në lexim.

Në kohën e sodit çdo herë kur hapim kopjen e Kuranit, mund ta gjejmë shprehjen "sipas Othmanit" si udhëzim në ato kopjet standarde të bëra në kohën e halifes së tretë Othman ibn Affani, nga Zejd ibn Thabit, i ndihmuar nga ashab të shumtë të Dërguarit të Allahut s.a.v.s.

Shqipëroi Arsim Dauti



Njerëzorja e Jezus Krishtit (Isaut a.s.)

“Do ta njihni të vërtetën dhe e vërteta do t’ju bëjë njerëz të lirë”. (Gjoni 8:32)

Senad Maku - Ulqin

Me që jemi në prag të festës së Krishtlindjeve, festa e të krishterëve, do të kufizohem sadopak që të hedh pakëz dritë në personalitetin e Jezu Krishtit (Isas a.s.) që sipas doktrinës krishtere Jezusi është Zot.

Kurse muslimanët për shekuj të tërë kanë mbajtur besimin se Jezusi ishte njeri dhe njëri ndër shumë të dërguarit që All-llahu xh.sh. i dërgoi njerëzimit për ta udhëzuar atë drejt vullnetit të Tij.

Kush është Jezu Krishti: Zot apo Njeri, rob i Zotit. Ku qëndron e vërteta prapa personit të mbuluar me mite, paragjykime dhe keqinterpretime...?


Këtu do të shtjellojmë këtë çështje duke u argumentuar atyre nga vet libri i tyre Bibla, për njerëzoren e Jezu Krishtit (Isaut a.s.).

Një fjalë e urtë latine thotë: “Ma jep argumentin të jap të drejtën të flasësh”.

Bibla, edhe pse me shtesa e ndryshime të shumta, e tregon qartë se Jezusi ishte njeri i aprovuar nga Perëndia për një mision të caktuar tek populli i tij, tek kopeja e humbur e Izraelit. Nga fillimi deri në fund Ungjijtë e tregojnë qartë njerëzoren e Jezusit, e cila është krejt ndryshe nga natyra hyjnore e Zotit.

Citimet biblike, për të vërtetuar se Jezusi nuk mund të jetë Zoti!

Për të kthjelltësuar të vërtetën e natyrës së Krishtit, së pari duhet të dimë se kush është Zoti, që do të thotë ta njohim natyrën e Tij, respektivisht atributet që e bëjnë atë të quhet Zot. Duke lexuar biblen, hasim në



përshkrimin e shumë cilësive të Zotit. Do të cekim vetëm disa citate nga vet bible ku thotë:

“Unë jam Perëndia i plotfuqishëm” (Zanafilla 17:1)

“Perëndi i plotfuqishëm” (Ekzodi 6:3)

“...askush nuk është si Zoti, Perëndia ynë” (Ekzodi 8:10)

“Perëndia ynë, është një i vetëm” (Deuteronomi 6:4)

“Zoti është Perëndi dhe që nuk ka asnjë tjetër veç tij” (Deuteronomi 4:35)

“Unë jam i pari dhe jam i fundit, dhe përveç meje nuk ka Perëndi” (Isaia 44:6)

“Para meje asnjë Perëndi nuk u formua dhe pas meje nuk do të ketë asnjë tjetër” (Isaia 43:11)

“(Zoti) Ati juaj i di gjërat për të cilat keni nevojë, para se

ju t’i kërkoni” (Mateu 6:8)

“O Zot, Perëndia i Izraelit, nuk ka asnjë Perëndi të ngjashëm me ty as atje lart në qiell, as këtu poshtë në tokë” (1 Mbretërit 8:23)

“Dëgjo, o Izrael: Zoti, Perëndia ynë, është i vetmi Zot” (Marku 12:29)

“Në fakt një është Perëndia, dhe një i vetëm është ndërmjetësi midis Perëndisë dhe njerëzve: Krishti Jezus njeri” (1 Timoteu 2:4)

“Ja, ai (Perëndia) që mbron Izraelin nuk dremit dhe nuk fle” (Psalmi 121:4)

Këto janë disa nga citatat biblike, që tregojnë për disa cilësi të Zotit po ashtu edhe tregojnë se Zoti është Një dhe nuk ka Perëndi tjetër pos Tij.

Tani le të lexojmë edhe disa nga citimet biblike, për të vërtetuar logjikisht se Jezusi nuk mund të jetë Zoti, sepse këto cilësi apo veti që do t’i cekim janë të njeriut dhe jo të vet Zotit (i pastër qoftë nga ato që ia veshin).

Prejardhja e Jezusit:

“Pasardhës i mbretit David” (Romakëve 1:3), “Pasardhës i Davidit dhe Abrahamit” (Mateu 11:19).

Jezusi bir i njeriut:

“Erdhi Biri i njeriut, që ha dhe pi...” (Mateu 11:19), “Biri i njeriut do t’u dorëzohet në duart e njerëzve” (Mateu 17:22), “Me të vërtetë ky njeri ishte i drejtë!” (Lluka 23:47).

Lindja e Jezusit:

“Dhe ajo lindi djalin e saj të

parë lindur, e mbështolli me pelena dhe e vendosi në një grazhd" (Lluka 2:7), "ju do të gjeni një fëmijë të mbështjellë me pelena, të shtrirë në një grazhd" (Lluka 2:12)

Synetimi i Jezusit:

"Dhe kur kaluan të tetë ditët, pas të cilave ai duhej rrethprerë, ia vunë emrin Jezus" (Lluka 2:21)

Gjinia e Jezusit:

"Dhe ajo do të lindë një djalë..." (Mateu 1:21)

Familja e Jezusit:

"A nuk është ky i biri i marangozit? Nuk quhet nëna e tij Mari, dhe vëllezërit e tij Jakob, Iose, Simon dhe Juda?" (Mateu 13:55)

Babai i Jezusit:

"Jezusin nga Nazareti, të birin e Jozefit!" (Gjoni 1:45), "Bir, pse na e bëre këtë? Ja, yt atë dhe unë, në ankth, po të kërkoni!" (Lluka 2:48)

Zhvillimi i Jezusit:

"Ndërkaq fëmija rritej dhe forcohej", "kur ai i mbushi dymbëdhjetë vjeç", "Dhe Jezusi rritej në dituri, në shtat" (Lluka 2:40/42/52)

Pofisioni i Jezusit:

"A nuk është ky i biri i marangozit" (Mateu 13:55)

Nga citatet kuptojmë se Jezusi është i lindur, ka prejardhje, është bir i njeriut, ka gjini, ka familje, është bërë synnet, ka baba, zhvillohet, është zdrukthëtar etj.... Vallë a mund ti ketë Zoti këto cilësi apo veti, siç pretendojnë se Jezusi është Zot. Si mund të jetë Jezusi Zot kur është i lindur. Vallë a lind Zoti?! A ka logjikë kjo?! A mundet të lind Zoti? çdo njeri që lind dhe vdes. A vdes Zoti? Në qoftë se lind dhe vdes, atëherë nuk meriton të llogaritet për Zot. A meriton Zoti të jetë foshnje e mbështjellë me pelena dhe i vendosur në grazhd?! Jezusi mësonte, zhvillohej trupërisht siç zhvillohen fëmijët e tjerë, të gjitha këto janë veti njerëzore e jo të Zotit, sepse Zoti nuk rritet, nuk i nënshtrohet askujt, nuk i shtohet gjatësia trupore etj.!!!

Jezusi i pamësuar:

"Jezusi u ngjit në tempull dhe mësonte" (Gjoni 7:14)

Jezusi i dërguar veç te një popull:

"Unë nuk jam dërguar gjetiu, përveç te delet e humbura të shtëpisë së Izraelit" (Mateu 15:24)

Jezusi profet:

"Ky është Jezusi, profeti nga Nazareti i Galilese" (Mateu 21:11), "Atëherë njerëzit, kur panë shenjën që bëri Jezusi, thanë: Me të vërtetë ky është profeti, që duhet të vijë në botë" (Gjoni 6:14), "Midis nesh doli një profet i madh" (Lluka 7:16), "Çështjen e Jezusit nga Nazareti, që ishte një profet i fuqishëm në vepra" (Lluka 24:19)

Jezusi qanë:

"Jezusi qau" (Gjoni 11:35)

Jezusi i pafuqishëm:

"Unë s'mund të bëj asgjë nga vetja ime" (Gjoni 5:30)

Jezusi i uritur:

"Dhe, mbasi agjëroi dyzet ditë e dyzet net, në fund e mori uria" (Mateu 4:2), "Në mëngjes,

kur po kthehej në qytet e mori uria" (Mateu 21:18), "A keni këtu diçka për të ngrënë?" (24:41)

Jezusi i etshëm:

"Kam etje!" (Gjoni 19:28)

Jezusi i lodhur:

"Dhe Jezusi, i lodhur nga udhëtimi" (Gjoni 4:6)

Jezusi ften:

"por ai flinte" (Mateu 8:24)

Jezusi i dobët:

"Atëherë iu shfaq një engjëll nga qie-lli për t'i dhënë force" (Lluka 22:43)

Jezusi trishtohet:

"dhe filloi të ndjeje trishtim dhe ankth të madh....Shpirti im është thellësisht i trishtuar" (Mateu 26:37-38)

Jezusi frikësohet:

"filloi ta zërë frika dhe ankthi" (Marku 14:33), "Që nga ajo ditë, pra, ata vendosën ta vrasin. Për këtë arsye Jezusi nuk ecte më haptazi midis Judenjve, por u tërhoq në një krahinë afër shkretëtirës..." (Gjoni 11:53-54)

Jezusi i tronditur:

"Jezusi, përsëri i tronditur" (Gjoni 11:38)

Jezusi tundohet:

"Atëherë Fryma e çoi Jezusin në shkretëtirë, që djalli ta tundonte" (Mateu 4:1), "qëndroi në shkretëtirë dyzet ditë, i tunduar nga Satanai" (Marku 1:13)

Jezusin e poshtërojnë:

"Atëherë e pështynë në fytyrë, e goditën me shuplaka; dhe disa të tjerë i ranë me grushta" (Mateu 26:67)

Jezusi lutej:

"ndërsa po lutej, qielli u hap", "Por ai tërhoqej në vende të vetmuara dhe lutej", "Jezusi po lutej në vetmi", "dhe ra në gjunjë dhe lutej", "shkoi në mal për t'u lutur, dhe e kaloi natën duke iu lutur Perëndisë" (Lluka 3:21/ 5:16/ 9:18/ 22:41/ 6:12), "Dhe, si shkoi pak përpara, ra me fytyrë për tokë dhe lutej" (Mateu 26:39)

Jezusi nuk i di stinët:

"Dhe, duke parë nga larg një fik që kishte gjethe, shkoi për të parë në se mund të gjente diçka atje; por, kur iu afrua, s'gjeti asgjë përveç gjetheve, sepse nuk ishte koha e fijeve" (Marku 11:13)

Jezusi pa dijeni për të ardhmen:

"Sa për atë ditë dhe atë orë, askush nuk e di, as engjëjt në qiell, as Biri, por vetëm Ati" (Marku 13:32)-(Mateu 24:36)

Jezusi kërkon gomarë:

"Shkoni në fshatin që ndodhet përballë jush; aty do të gjeni menjëherë një gomare të lidhur dhe një pulishtë me të; zgjidhni dhe m'i sillni!" (Mateu 21:2), "Dhe Jezusi gjeti një kërraç dhe hipi në të" (Gjoni 12:14)

Varfëria e Jezusit:

"Dhe Jezusi i tha: "Dhelprat i kanë strofkat, dhe zogjtë e qiellit i kanë çerdhet, por Biri i njeriut nuk ka as ku të mbështetë kokën" (Mateu 8:20)

Jezusi pagëzohet:

"Atëherë erdhi Jezusi nga Galileja në Jordan te Gjoni për t'u pagëzuar prej tij" (Mateu 3:13)

Jezusi vdiq:

"Por Jezusi, si lëshoi një



britmë të madhe, dha frymën (vdiq)” (Marku 15:37), “kur erdhën te Jezusi, dhe si panë se ai tashmë kishte vdekur” (Gjoni 19:33)

Jezusi, rob dhe i dërguar i Allahut

Këto citate tregojnë qartazi dhe pa dhënë kurrfarë komenti që Jezusi është rob i Allahut xh.sh. dhe i dërguar i Tij. Po të merren këto cilësi si të Zotit, a thua Zoti vihet në sprovë, frikësohet, lodhet, i pafuqishëm, i padijshëm për të ardhmen, për stinët etj. Të gjitha këto janë veti të njeriut. Zoti kalëron mbi gomar, çfarë absurditeti! Nevoja e Jezusit për gomar hedh poshtë hyjninë e tij. Jezusi lutej. Kujt i lutej? Zotit. Lutja e tij është argument për natyrën e tij njerëzore. A i lutet Zoti, Zotit? D.m.th. Jezusi nuk është Zot, por është njeri dhe rob i cili i nënshtrohet Zotit.

Pagëzimi i Jezusit, si mund të jetë misioni i tij “shpëtimtarë i mëkateve” apo si mund të quhet ai “I pamëkate” kur edhe vetë u pastru nga mëkatet në lumin Jordan?

Ka edhe me dhjetëra e dhjetëra citate biblike ku e hedhin poshtë hyjninë e Jezusit. Pra, si përfundim me këto citate që i cekëm logjikoni vet me arsyen tuaj, a i ka hije Zoti të jetë me këto cilësi të mangëta, kur dihet se krijesat e Tij kanë veti më të mira se këto. Jo, por kjo dëshmon se Jezusi ishte vetëm se njeri i thjeshtë, profet i dërguar nga Zoti.

Në të vërtetë para 2000 vjetëve Jezusi profetizoi se njerëzit do ta adhuronin më kot dhe do ta besonin në doktrina të krijuara nga njerëzit dhe jo nga Perëndia:

“Por në padobi ata më adhurojnë mua, duke mësuar urdhëresa të shpikura nga njerëzit”. (Mateu 15:9)

MBI DUKURITË NEGATIVE



SI T'I DALLOJMË NARKOMANËT?

“Qëllimet e narkomanëve janë që të rekrutojnë sa më shumë persona në radhët e tyre, duke u shpjeguar të tjerëve për “kënaqësitë” që sjell përdorimi i narkotikëve, duke zbuluar çastet e përjetuara e duke zgjuar te bashkëbiseduesit kureshtje që edhe ata ta provojnë. Në këtë drejtim, më së shumti sukses kanë femrat narkomane dhe vërtetohet që një narkomane mesatarisht i shtyn të konsumojnë narkotikë nga gjashtë persona të tjerë.”

Dr. Mair Iseini

Qëllimi i këtij shkrimi është që t'u mundësojmë të rinjve tanë që të mund më lehtë t'i dallojnë dhe zbulojnë narkomanët e varur dhe të mos bien në kthetrat e tyre. Kjo dukuri në mesin tonë nuk duhet anashkaluar, sepse në të ardhmen do të na hakmerret. Si karakteristikë e narkomanëve në të shumtën e

rasteve është se ata dallohen me ate se janë persona emocionalë, jostabilë, të paafte për t'u përshtatur në rrethana të ndryshme. Narkomanët që përdorin narkotikë, kryesisht janë qyqarë, të vetmuar, nuk i pranojnë autoritetet, ndihen të paafte për t'u ballafaquar me kërkesat reale të botës që i rrethon. Ata nuk mund ta gjejnë vendin e vet në rrethin dhe në botën që i rrethon. Për çdo gjë ndihen të

pasigurt dhe të frikësuar. Nëse u krijohen kushte dhe mundësi të caktuara dhe nëse u jepet rasti të konsumojnë narkotikë, ata këtë e bëjnë pa menduar fare, në mënyrë që ta ndiejnë veten më të sigurt, sepse vetëm narkotikët u mundësojnë që në mënyrë pasive të plogësht të arrijnë atë që dëshirojnë.

VARSHMËRIA PSIKIKE DHE FIZIKE TË NARKOMANIT NGA PIJET NARKOTIKE

Ngjashëm me alkoolistët, edhe narkomanët për vete mendojnë më së miri, kanë besim në aftësitë e veta, janë "llafazanë" dhe shumë "trima". Substancat narkotike ndikojnë në shkatërrimin e shëndetit të tyre, në shkatërrimin moral dhe mental, në zvogëlimin e vetëdijes dhe të vëmendjes së personit që bëhet i varur nga narkotikët. Këta persona, për shkak të përdorimit të narkotikëve, humbin shumë aftësi, orientimin, perceptimin e rrethit ku jetojnë etj.

Narkomanët kanë pamje të shëmtuar fizike, janë të zbehtë, më të dobët fizikisht, të plogësht e të mpirë, lënë pas dore higjienën personale, ngacmohen shpejt, përllahen dhe fjalosen me familjarët, me shokët, shoqet e shkollës, humbin interesin për jetë, tregojnë mosinteresim për mësim, ikin nga shkolla dhe realiteti jetësor, ditën flejnë natën rrinë zgjuar, zakonisht mbajnë syza dielli të zeza, veshin këmisha me mëngë të gjata edhe verës dhe i fshehin gjurmët e marrjes së narkotikut me anë të

injeksionit, e zgjerojnë rrethin e shokëve narkomanë, me të cilët e kalojnë kohën, vjedhin gjësende dhe i shesin me çmim të lirë për ta blerë dozën ditore.

Doza ditore narkomanit i nevojitet si buka e përditshme, njëherit i bëhet shprehi dhe nuk mundet pa të, sepse ajo e disponon dhe e qetëson. Narkomani i varur i cili bie në "krizë", këtë e manifeston me qarje, shkundje të hundëve, gogësimë, dridhje të muskujve, shtangim të muskujve etj. Simptomat e "krizës" janë pasojë e varshmërisë psikike dhe fizike të organizimit të narkomanit nga pijet narkotike.

PASOJAT QË REFLEKTOHEN NË SHOQËRI

Qëllimet e narkomanëve janë që të rekrutojnë sa më shumë persona në radhët e tyre, duke u shpjeguar të tjerëve për "kënaqësitë" që sjell përdorimi i narkotikëve, duke zbukuruar çastet e përjetuara e duke zgjuar te bashkëbiseduesit kureshtje që edhe ata ta provojnë. Në këtë drejtim, më së shumti sukses kanë femrat narkomane dhe vërtetohet që një narkomane mesatarisht i shtyn të konsumojnë narkotikë nga gjashtë persona të tjerë. Sjelljet e narkomanëve të rinj, të cilët shprehin përbuzje ndaj punës dhe mënyrës së zakonshme të jetës, kanë disa elemente të kthimit në mënyrën e mëparshme të jetës, që ka ardhur në shprehje të plotë në kuadër të hipilëvizjeve dhe kolonive të hipikëve të formuara sidomos në muajt e verës, brendin nëpër

shumë vende të fshehta, ndërtesa në ndërtim e sipër, vende të ndryshme ku nuk bien në sy të qytetarëve etj. Grupet e reja që i nënshtrohen futjes dhe përdorimit të narkotikëve, zakonisht i takojnë shtresave të ulëta të shoqërisë me vendbanime në periferi të qyteteve, por cilësohen si shumë të depërtueshëm dhe të shoqërueshëm.

Dilerët vishen bukur me gardërobë të shtrenjtë, shoqërohen me të gjithë, janë të qetë të buzëqeshur, përshëndesin gjoja se çdo kalimtar gjatë bisedës me dikë, vendqëndrimi i tyre është zakonisht nëpër kafeteri, ku i kanë edhe kallauzët e tyre, qofshin femra apo meshkuj, me të cilët gjoja se kanë raporte të posaçme. Pas këtyre veprimeve të dilerëve dhe kallauzëve të tyre vjen faza e dytë, ajo më e rënda, kur shijuesi i narkotikut do të interesohet që vetë të takohet me dilerin dhe të shoqërohet me të. Mjerisht, kjo veprimtari e rrezikshme viteve të fundit vërehet edhe te ne, në mesin tonë, por edhe te fëmijët e bashkëvendësve tanë që jetojnë dhe punojnë në perëndim. Në qoftë se duam t'u largohemi këtyre situatave, para se të bëhet vonë duhet t'i këshillojmë fëmijët tanë me këshilla elementare si duket narkomani, kush mund të jenë kallauzët e dilerëve, çfarë mund të ndodhë, po qese shpesh organizojnë ndeja të ndryshme etj, dhe cilat mund të jenë pësimet nga këto ndeja të tipit të mbyllur në lokale apo banesa të ndryshme.

**Autori është:
Spec. i mjekësisë së
përgjithshme**





